Rruga e Arbërit



Market KEN
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 4 (108). PRILL 2015. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

REPORTAZH

Në vend të librave nxjerrin krom për bukën e gojës

FAQE 12

VEPRIMTARI

"Nderi i Kombit" për fshatin Bllişe

Një gjest fisnik, bujar e largpamës.
Nga fshat 'reaksionar' në 'Nderi i Kombit'

FAQE 16,17

INTERVISTË / Dhurata Thanasi Daneri

Nga gatimet dibrane "nuk di kë të zësh e kë të lësh"

FAQE 13



RRUGA E ARBRIT, KUVENDI I HAP RRUGËN NËNSHKRIMIT TË KONTRATËS ME KOMPANINË KINEZE

60 ditë afat për nënshkrimin e koncensionit



Kuvendi i Shqipërisë më 16 prill, me 89 vota "Pro", asnjë kundër dhe asnjë abstenim, i hapi rrugën fillimit të një procedure të veçantë për negocimin e kontratës koncensionare me shoqërinë kineze "China State Construction Company". Opozita voton projektligjin, por hedh dyshime për veprime në lidhje me procedurat e koncensionit. Nuk ka një shifër të saktë për koston e rrugës dhe mungon finalizimi i marrëveshjeve me Maqedoninë për vazhdimin e ndërtimit në shtetin fqinj. Qeveria nuk ka vendosur akoma nëse rruga do të jetë me pagesë apo kredia do të përballohet nga buxheti i shtetit. Qeveria premton standard të lartë të rrugës. Pas negociatave, Parlamenti do të miratojë edhe njëherë kontratën e nënshkruar mes qeverisë dhe shoqërisë kineze që do të ndërtojë rrugën. Rruga e Arbërit me standarde dhe cilësi, vetëm kështu ajo do t'u vlejë shqiptarëve dhe do të ndikojë në një zhvillim të dukshëm ekonomik të vendit.

INTERVISTË EKSKLUZIVE
ME DEPUTETIN KOÇO KOKËDHIMA

Qeveria shqiptare ka vendosur që ta kryejë Rrugën e Arbrit

LEXONI NË FAQEN 4-5

LETËR DEPUTETËVE TË DIBRËS

Përshëndesim vendimin për t'i hapur rrugë një marrëveshje të posaçme për ndërtimin e Rrugës

Peticioni do të ngelet i njëjtë deri në mbylljen e tij, kur të përfundojë me standarde Rruga e Arbrit.

Nga **GËZIM ALPION**

FAQE 5

■ SHEREFEDIN SHEHU: "Një ditë mund të jepni llogari për këto kredi të fshehta" ■ ULSI MANJA: Rruga e shpresës së madhe ■ RAKIP SULI: Rruga e Arbrit sot është me afër së kurrë të bërit realitet ■ ROLAND KETA: Politika e ka detyrim dhe duhej ta kishte përfunduar Rrugën e Arbrit ■ PËRPARIM SPAHIU: Punimet fillojnë në 2016-ën ■ ARBEN: AHMETAJ: Rruga e Arbrit me kosto më të ulët se në 2007 ■ EDMOND HAXHINASTO: Procesi për Rrugën e Arbrit është plotësisht transparent ■ SHKËLQIM CANI: Dibranët të gëzojnë rrugën! Kjo është e gjitha! ■ Radika, Rruga e Arbrit dhe roli i shoqërisë civile

SPECIALE NË FAQEN 2-9

Zgjedhjet lokale / Mati, Klosi, Bulqiza dhe Dibra

Ja kush janë kandidatët për kryetarë bashkie

SPECIALE NË FAQEN 10-11

cyan magenta yelloë black 1

Kuvendi i Shqipërisë më 16 prill, me 89 vota "Pro", asnjë kundër dhe asnjë abstenim, i hapi rrugën fillimit të një procedure të veçantë për negocimin e kontratës koncensionare me shoqërinë kineze "China State Construction Company".

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 4 (108). 1 - 30 Prill 2015

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Korrespondentë të përhershëm:
Hysen LIKDISHA
Sashenka NDREKA
Abdurahim ASHIKU

Kontribuan për këtë numër:
Gëzim Alpion
Agron TUFA
Eva GJURA
Rexhep TORTE
Miran TAFA
Shpëtim CAMI
Edmond HASANI
Arjeta TAFÇIU
Ilmi DERVISHI
Islam CANI
Dionis XHAFA
Hysen REPA
Mentor HOXHA
Sulejman TOMÇINI
Majlinda Hoxha

Arkivi i gazetës është ME pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL90202112190000004700036640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Rruga e Arbrit, Kuvendi i hap rrugën nënshkrimit të kontratës me kompaninë kineze

Nga **BUJAR KAROSHI**



Qafa e Tujanit. © Foto: B.Karoshi

Opozita voton projektligjin, por hedh dyshime për veprime në lidhje me procedurat e koncensionit. Nuk ka një shifër të saktë për koston e rrugës dhe mungon finalizimi i marrëveshjeve me Maqedoninë për vazhdimin e ndërtimit në shtetin fqinj. Qeveria nuk ka vendosur akoma nëse rruga do të jetë me pagesë apo kredia do të përballohet nga buxheti i shtetit. Qeveria premton standard të lartë të rrugës. Pas negociatave, Parlamenti do të miratojë edhe njëherë kontratën e nënshkruar mes qeverisë dhe shoqërisë kineze që do të ndërtojë rrugën.

Kuvendi i Shqipërisë më 16 prill, me 89 vota "Pro", asnjë kundër dhe asnjë abstenim, i hapi rrugën fillimit të një procedure të veçantë për negocimin e kontratës koncensionare me shoqërinë kineze "China State Construction Company".

Votimi në seancën plenare ishte parashikuar të ishte i ashpër, madje pati edhe shenja se opozita nuk do ta votonte, por në fillim të diskutimit, ishte ish kryeministri Sali Berisha që tha se "ligji do të miratohej, pavarësisht paqartësive që e shoqëronin".

"Nuk jam dakord me mungesën e transparencës që tregon qeveria, megjithëse do ta votoj plotësisht. Është një kontratë që e kemi ofruar ne, e kemi miratuar plotësisht, filluam negociatat, por kostoja është shumë e lartë", tha Berisha. Më pas të gjithë deputetët e opozitës dhanë mbështetje mbi ligjin, pavarësisht kundërshtive të tyre që lidheshin me aspektet financiare, mënyrën e dhënies me koncension pa një tender publik si afatet e fillimit dhe mbarimit të rrugës.

Diskutimi në Parlament nga deputetët dhe ministrat u trajtua në disa aspekte, teknik dhe financiar, por më shumë në aspektin politik: nëse partitë dinë t'i mbajnë premtimet apo jo. Por pavarësisht kësaj, shumë çështje mbi rrugën mbeten të paqarta, argumentet janë të ndryshme, madje edhe mes ministrave, paqartësi dhe dyshime, të cilat po i trajtojmë më poshtë.

DEBATI MBI KOSTOT: SA KUSHTON RRUGA E ARBËRIT?

Pyetja se sa kushton kjo rrugë nuk ka marrë akoma përgjigje. Ish kryeministri Berisha tha në seancën e 16 prillit se "në të gjitha përllogaritjet, mund të kalojë edhe 1 miliardë, por përsëri fizibiliteti është kombëtar".

Koço Kokëdhima, deputet i PS, në një intervistë ekskluzive për gazetën "Rruga e Arbërit" tha se "kushtet e huasë që parashikoheshin në bisedimet e qeverisë së mëparshme ishin shumë të shtrenjta për Shqipërinë. Huaja parashikohej me interes 9.5 % dhe koeficienti i kthimit të investimit, ishte 14.5%, pra, të dyja bashkë 24%". Kokëdhima theksoi se "marrëveshja e parashikuar pas negociatave të qeverisë parashikon një interes 3% dhe koeficienti i kthimit 5%, të dyja së bashku në 8%, shumë më e ulët se ajo e qeverisë së kaluar".

Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Edmond Haxhinasto, tha në Kuvend se "26.9 kilometra është segmenti që po diskutojmë sot dhe kushton rreth 200 milionë dollarë". Ai tha se 21 milionë dollarë ka kushtuar segmenti Bulqizë - Ura e Çerenesit si dhe 60 milionë dollarë kushtojnë segmentet Ura e Vashës - Qafa e Buallit dhe Tiranë - Qafa e Tujanit. Gjithashtu, Haxhinasto theksoi se segmenti akoma i pafilluar prej 6.4 km, që do të lidhë rrugën me Maqedoninë kushton 46,6 milionë dollarë. Po të mbledhim milionat që tha Haxhinasto, kjo rrugë nga Tirana deri në kufirin e Maqedonisë do të kushtojë rreth 327.6 milionë dollarë, shumë më tepër se sa është deklaruar deri më tani.

"Unë jam për të mbështetur përfundimin e Rrugës së Arbrit, pavarësisht kostos së saj, por edhe për t'i kërkuar qeverisë që të mënjanojë një sërë kostosh të fshehta, të cilat do të bien në kurriz të qytetarëve, ashtu siç është paraqitur këtu", tha në diskutimin e tij deputeti tjetër i Dibrës Sherefedin Shehu.

"Në projektin e hartuar nga qeveria e Partisë Demokratike, vlera e projektit shkonte deri në 180 milionë euro, ndërsa në këtë qeveri kjo vlerë ka shkuar në 240 milionë euro. Pra, kemi një rritje të kostos në 60 milionë euro, shumë e cila, me shumë gjasa, do të përfundojë në xhepat e kësaj qeverie", akuzoi deputeti tjetër i Dibrës, Bedri Hoxha.

Ish ministri i Financave, Ridvan Bode, tha se kostoja e këtij segmenti është e lartë: 10 milionë euro për kilometër. Duke bërë krahasimin me rrugën e Elbasanit, e cila ka kushtuar përafërsisht 8 milionë euro për km, Rruga e Arbërit do të kushtojë 2 milion euro më shtrenjtë. Gjithashtu, duke theksuar se rruga e Elbasanit do të jetë me katër korsi, ndërsa ajo e Arbrit me dy korsi, kosto sipas tij është shumë më e shtrenjtë.

Në Komisionin e Ekonomisë, gjatë diskutimit të projektligjit në fjalë, ministri Haxhinasto kishte deklaruar se "Autoriteti Rrugor Shqiptar e kishte llogaritur vlerën e projektit 28.8 miliardë lekë (përafërsisht 206 milionë euro - llogaritje B.K) ndërsa kompania kineze ka sjellë një ofertë prej 21 miliardë lekë (përafërsisht 150 milionë euro - llogaritje B.K).

Dhe gjithë këto shifra bëjnë fjalë për një rrugë me 10.5 metra gjerësi, ku përfshihen katër tunele, më i gjati ai i Qafës së Murrizës me gjatësi 2600 metra.

Ministri Arben Ahmetaj rreth aspektit financiar theksoi në Kuvend se "projekti do të negociohej". "Parlamenti, sipas tij, do të votojë sot vetëm procesin e hapjes së negociatave, ndërsa sa do të jetë kostoja, sa transparente do të jetë, ky Parlament dhe institucionet e tjera kanë mundësi ta ndjekin gjatë procedurës së negociatës".

Pavarësisht debatit mbi kostot, ajo nuk është e qartë akoma për publikun se sa do të kushtojë, pasi negociatat vazhdojnë dhe akoma nuk janë miratuar. Ndërsa deputetët kujdesen që me anë të shifrave më shumë të sulmojnë kundërshtarin se sa të tregojnë të vërtetën.

PSE PO ANASHKALOHET TENDERI PUBLIK PËR KONCENSIONIN?

Që rruga do të jetë me koncension, shumë pak veta e besojnë, pasi edhe vetë titulli i ligjit thotë "negocimin e kontratës koncensionare". Por deputetët e mazhorancës dhe opozitës nuk bien dakord as në këtë pikë. Mazhoranca thekson se kjo procedurë do ta përshpejtojë punën për fillimin e punimeve, ndërsa opozita pretendon se kjo mënyrë e anashkalimit të tenderit publik shton dyshimet për korrupsion.

Ish kryeministri tha se kjo "kontratë, që kur ka ardhur në fillim, ka qenë pa garanci sovrane. Kredi e Bankës Kineze për Zhvillim për kompaninë kineze pa asnjë garanci sovrane: s'ka pasur as skadim, as mosskadim".

Deputeti i Dibrës, Ulsi Manja, theksoi se kjo "kontratë ndërmjet shtetit shqiptar dhe kompanisë kineze "China State Construction Company", përfshin jo thjesht ndërtimin, por operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Rrugës së Arbrit".

Nga ana tjetër, deputeti tjetër i Dibrës, Sherefedin Shehu tha se "qeveria po përdor Kuvendin për të anashkaluar ligjin e koncesioneve. Vetë titulli i ligjit është "Për një procedurë të veçantë". Më e keqja është se rruga është në letër, ndërsa qeveria nxiton ta paraqesë sikur po miraton ndërtimin e saj. Prandaj unë kam frikë se ky është një projekt elektoral".

"Ligji miraton procedurën e veçantë, jo ligjore, për negocimin dhe lidhjen e kontratës së koncesionit pa asnjë kusht apo terma specifikë të përcaktuar në ligj, siç mund të ishin: fondi limit, kostoja për kilometër, periudha e koncesionit etj.," theksoi Shehu.

Më tej ai akuzoi se "nëpërmjet kësaj marrëveshjeje ne nuk miratojmë një koncesion, por një prokurim të drejtpërdrejtë, ku do të caktojmë kompaninë ndërtuese, ndonëse paratë do të paguhen prej shqiptarëve dhe nuk do të pasqyrohen si kredi".

Koço Kokëdhima, në një intervistë për gazetën, tha se "ashtu siç Shqipëria nuk lëshonte dot garanci sovrane, ashtu edhe pala kineze, sipas legjislacionit të saj, nuk i lejonte bankat kineze të jepnin huara në drejtim të një vendi që nuk ofron garanci sovrane. Dhe për ta kapërcyer këtë çështje, qeveria jonë ndërtoi një model të partneritetit publik-privat me këtë kompani, ku vetë si qeveri ofron tokën e rrugës dhe kompania vendos investimin".

"Duhet të jemi të gjithë të qartë se financimet e huaja janë të gjitha financime me kushtëzime. Kështu ndodh edhe me financimet e huaja që vijnë nga vendet perëndimore. Kur shtetet japin financime, kushtëzojnë edhe kompanitë të cilat do të konkurrojnë për këto financime. Bankat kineze nuk japin para që ta bëjnë këtë punë kompanitë europiane, as kompanitë e vendeve të tjera, por i kushtëzojnë financimet e tyre me kompanitë e tyre".

kryesore

Rruga e Arbërit me standarde dhe cilësi, vetëm kështu ajo do t'u vlejë shqiptarëve dhe do të ndikojë në një zhvillim të dukshëm ekonomik të vendit.

60 ditë afat për nënshkrimin e koncensionit

Roland Keta, deputeti i Dibrës, tha se "vetëm Bulqiza i ka dhënë buxhetit të shtetit miliona dollarë dhe po të bëjmë një analizë ekonomike, vetëm nga të ardhurat e aktivitetit mineral do të ishte ndërtuar Rruga e Arbrit. E keni detyrim kushtetues dhe ligjor ndërtimin e kësaj vepre. Pse nuk jepen me koncesion rrugët e Vlorës dhe Gjirokastrës?".

"Koncesioni i Rrugës së Arbrit, theksoi Keta, ka prapaskenat e tij, paligjshmërinë, nuk ka transparencë, nuk ka konkurrencë. Zgjidhet një kompani kineze, pra një koncesionar i paramenduar, një prokurim i pabarabartë, kur qeveria e ka detyrim ligjor të hapë një proces konkurrimi".

Ridvan Bode, ish ministër i Financave tha se "ne i japim qeverisë me ligj të drejtën që të mos u nënshtrohet rregullave normale të koncesionimit publik, me partneritetin publik-privat. Dhe kjo nuk është një gjë që s'ka filluar. Ne sot, le të themi, po legjitimojmë negociatat, bisedat, hesapet që ka bërë deri më sot me qeverinë shqiptare kompania kineze.

Por Bode pranon, ashtu si Kokëdhima, se "kjo është një kredi me terma të butë, nga Banka për Nxitjen e Eksporteve e Kinës, e cila ia jep një kompanie po kineze, sipas rregullave të tyre, kundrejt një plani apo programi investimi".

Shkëlqim Cani, ministër i Financave, njëkohësisht edhe deputet i Dibrës, theksoi në fjalën e tij në Kuvend se "jam i detyruar të garantoj këdo, cilindo shqiptar, natyrshëm edhe deputetët, që në tavanet e buxhetit dhe të borxhit është përfshirë gjithçka, ekstremisht, për ndërtimin e kësaj rruge dhe nuk ka as më të voglin problem. Mbetet vetëm qartësimi i negociatave. Për transparencë, është vendosur që të vijmë edhe një herë këtu, në mënyrë që për këtë çështje të jepet mendimi dhe vlerësimi edhe nga Parlamenti".

A DO TË JETË RRUGA ME PAGESË? SA DO KUSHTOJË?

Ministrat Haxhinasto, Ahmetaj dhe Cani nuk e kanë deklaruar qartë nëse rruga do të jetë me pagesë apo jo.

Gjatë diskutimeve në Komisionin e Ekonomisë, Haxhinasto tha se nuk është vendosur përfundimisht nëse do të jetë me pagesë nga qytetarët apo do të financohet direkt nga buxheti.

Ministri i Financave, Shkëlqim Cani, tha se me shumë gjasa do të jetë versioni i pagesës nga buxheti.

"Kjo rrugë do të jetë me pagesë, sepse kështu është konceptuar edhe vetë projekti', thotë Koço Kokëdhima. Ai argumenton se për të kapërcyer problemin e mungesës e garancisë sovrane, "qeveria ndërtoi një model të partneritetit publik-privat me këtë kompani, ku vetë si qeveri ofron tokën e rrugës dhe kompania vendos investimin që do të bëhet, për të marrë një vepër funksionale, e cila do të faturojë ata klientë që do ta shfrytëzojnë këtë vepër".

"Formula inovative bën të mundur që shuma që do të investohet në këtë partneritet publik

shqiptar, në këtë vepër të madhe, të mos jetë pjesë e borxhit publik, të mos kërkojë garanci sovrane, por të paguhet në mënyrë konstante, vit pas viti, në 15 apo 17 vjetët që

vijnë, në varësi të negociatës që do të bëjmë, tha ministri Ahmetaj. Patjetër që parimi kryesor në këto partneritete publik - privat në infrastrukturë, ajo që quhet risku i volumit të trafikut, apo trafiku i munguar, patjetër që do të kompensohet".

Ndërsa Partia Demokratike është shprehur plotësisht kundër taksimit në rrugë.

"Shpresojmë që të mos jetë ajo taksë, sepse ne jemi kundër saj, pasi dibranët, bulqizakët dhe matjanët meritojnë të përfitojnë nga fondet publike dhe investimet publike, ashtu si të gjithë shqiptarët", kundërshtoi taksimin e rrugës deputeti Sherefedin Shehu.

"Në kemi dhënë garanci për trafikun, tha ministri i Transportit në seancën plenare. Në



Qafa e Tujanit. © Foto: B.Karoshi

rastin konkret, e kemi parashikuare në buxhet pagesën. Të garantosh trafikun, do të thotë ta taksosh, gjë të cilën ne nuk e kemi bërë dhe nuk e kemi parashikuar", theksoi ai.

"Me sa di unë, thotë Koço Kokëdhima, makinat që do të kalojnë në këtë rrugë do të faturohen me një tarife mesatare, në mos gaboj, rreth 5 euro. Qeveria jonë do të japë garanci për trafikun e munguar, sipas plan biznesit për 15 vitet e ardhshme, kur kjo vepër do të jetë në funksionim".

KUR DO TË FILLOJNË PUNIMET?

"Fillimi i ndërtimit të këtij aksi rrugor është menduar të nisë në vitin 2016, nëse gjithçka shkon sipas parashikimeve, dhe të përfundojë në vitin 2019", - tha në seancë deputeti i Dibrës, Përparim Spahiu.

Të njëjtën gjë përsëriti edhe ministri Haxhinasto gjatë mbrojtjes së ligjit në komisionet parlamentare, por ata nuk përcaktuan muajin se kur do të fillonte puna.

Më herët, deputetë dhe zyrtarë të qeverisë, në biseda private kanë thënë se nga dita e nisjes së punimeve, do të duhen 18 muaj për të përfunduar segmenti më i vështirë prej 26.8 km, Qafa e Tujanit - Ura e Vashës. Brenda kësaj periudhe parashikohej edhe ndërtimi i Urës së Vashës dhe Tunelit të Murrizit, çka do të thoshte se në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017, kryetarët e dy partive të mëdha politike do të shkonin më shpesh në Dibër për fushatë nga Rruga e Arbrit. Deklaratat e ministrit Haxhinasto, pavarësisht lajmit për përshpejtimin e negociatave me shoqërinë kineze, shprehnin pesimizëm për fillimin dhe mbarimin e punimeve.

Gjatë një bisede telefonike me deputetin tjetër të Dibrës, Ulsi Manja, ai tha për gazetën se pritet që punimet të fillojnë shumë më shpejt. Duke marrë parasysh periudhën normale të negociatave, 60 ditë kohë për negocimin dhe 30 ditë kohë për rimiratimin e marrëveshjes në parlament, ai theksoi se punimet pritet të fillojnë diku nga fundi i këtij viti dhe se ato do të mbarojnë shumë kohë më parë se është folur deri më tani".

Manja la të kuptohej se punimet mund të fillonin edhe më shpejt, në qoftë se negociatat do të ecin mirë.

STANDARDET E RRUGËS: DEBATI I MUNGUAR I SEANCËS PLENARE

Që kur është folur për ardhjen e kompanisë kineze, njëra nga katër më të mirat në botë, shoqëria civile është angazhuar së tepërmi që qeveria, gjatë procesit të negociatave, të ketë parasysh që rruga të ndërtohet me standarde dhe e parë në perspektivën rajonale dhe europiane të vendit.

"Rruga është në favor të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, si dhe për ta kthyer Shqipërinë nënjë qendër logjistike. Trevat e Dibrës sot fizikisht janë larg Tiranës.

Në qoftë se ne flasim për ndërlidhjen në kuadër rajonal me BE-në është detyrë po e vendimmarrësve, qoftë majtas dhe djathtas, është detyrë e qeverisë së Shqipërisë të mendojnë për të afruar, në radhë të parë, trevat shqiptare brenda kufijve të Shqipërisë me njëra-tjetrën: Dibra me Tiranën, Dibra me Durrësin, njësitë ekonomike në Dibër me njësitë ekonomike në Tiranë dhe në Durrës, me Portin e Durrësit", tha ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Arben Ahmetaj.

Por a do ta kryejë kjo rrugë atë që thekson ministri Ahmetaj, në qoftë se rruga do të jetë pa standarde dhe me shpejtësi lëvizje 50-60 km në orë?

"Për sa i përket çështjes së standardit, nëse dikush ka vërejtje për gjerësinë apo për tiparet tekno-fizike të rrugës, ky është projekti dhe jemi të detyruar të vazhdojmë me këtë projekt. Ka filluar në vitin 2007, është financuar në vetëm 50%, por jemi të detyruar të ecim me këtë projekt. Jemi të detyruar t'i bëjmë ndryshime dhe përmirësime teknike projektit të kësaj vepre, pasi përballemi me një fakt të përgjithshëm, ku cilësia e projekteve lë shumë për të dëshiruar. Cilësia e projekteve na ka sjellë situata për rritje të madhe të kostove, jo vetëm për mirëmbajtjen, por edhe të përfundimit të veprës, pasi gjithë veprat kanë problematika të jashtëzakonshme, veçanërisht me studimet gjeologjike, ku ndodhin rrëshqitje masive, bllokohen punimet, shtohen kostot dhe kjo vjen si rezultat i defekteve të mëdha në konceptimin e veprave dhe në projektimin e tyre", tha Haxhinasto.

Deputetët që folën në seancën plenare, nuk i kushtuan rëndësi aspekteve teknike dhe kështu t'i kërkonin qeverisë që gjatë procesit të negociatave, të diskutoheshin këto detaje. Një rrugë me dy korsi dhe me shpejtësi lëvizje 50-60 km në orë, do të jetë me pasoja nesër, duke marrë parasysh se në këtë rrugë, së paku, do të lëvizin kamionët e kromit të Bulqizës. Dhe nuk besoj se makinat e vogla do të qëndronin pas kamionëve me këtë shpejtësi, duke u bërë kështu një mundësi për aksidente të padëshiruara. Më herët, gjatë fazës së studimit të fizibilitetit, është thënë se shpejtësia mesatare e lëvizjes do të jetë 80 -120 km / orë.

"Në dijeninë time, thotë për gazetën Koço Kokëdhima, Kryeministri vazhdimisht ka insistuar që Rruga e Arbrit të jetë një model për nga cilësia dhe standardet e punimeve rrugore. Dhe unë besoj, se ajo do të jetë një vepër e ndërtuar me shumë cilësi të lartë.

Nuk mund të them që ajo do të jetë një autostradë me shumë korsi, sepse kjo është diçka që nuk është thelbësore për cilësinë e rrugës. Numri i korsive është thelbësore për t'i dhënë zgjidhje një trafiku të madh, por ajo që është e rëndësishme për kalimin në rrugë me komoditet, me ato parametra të sigurisë, të pjerrtësisë së rrugës, shpejtësisë së lëvizjes, do të jetë një rrugë që do të bëhet model. Ndoshta nga veprat me cilësi më të lartë në Shqipëri".

NEGOCIATAT ME MAQEDONINË

Kjo është rruga e Dytë e Kombit, është dëgjuar ta thonë shpesh politikanët.

Ministri Ahmetaj është shumë i qartë dhe i saktë kur theksoi se "kjo është rruga më fizible që konkurron pamundësinë e Korridorit 8. Nuk është më sekret që Korridori 8 është kthyer në një vështirësi, për 1 milion arsye gjeopolitike dhe jo financiare. U takon vendimmarrësve shqiptarë të gjejnë një damar të dytë komunikimi me trevat shqiptare apo për të lidhur Durrësin me Shkupin dhe Sofjen, në aspektin ekonomik dhe lëvizjen e lirë të njerëzve".

"Ky është një projekt që jo vetëm duhet mbështetur, por duhet, gjithashtu, të shtyhet edhe më tej, për të kapur patjetër kufirin me Maqedoninë, për të dalë karshi Tetovës dhe për të kapur unazën Sofje-Shkup-Ohër, në mënyrë që Sofje-Shkup-Durrës të mos bëhet si sot për shtatë orë, por maksimumi për tri orë", tha ministri i Ekonomisë.

Ndërsa ministri i Transportit, duke folur për të njëjtën çështje tha se "Kemi kërkuar në mënyrë të vazhdueshme, vazhdojmë ta kërkojmë, por ende nuk kemi një angazhim të mirëfilltë nga pala maqedonase, që të paktën një standard i tillë rruge të ndërtohet edhe në anën tjetër të kufirit, që të realizojmë objektivin kryesor të veprës për të shkurtuar kohën e lidhjes midis Tiranës dhe Shkupit".

Shoqëria civile, në një takim të mbajtur në 13 prill në Dibër të Madhe, e vuri theksin në domosdoshmërinë për të ndikuar pranë të dy qeverive që ta shohin këtë projekt si një projekt të përbashkët. Maqedonia nuk i ka kushtuar rëndësi kësaj rruge, me idenë se Shqipëria nuk ka ndërmend ta ndërtojë. Nga ana tjetër, Shqipëria nuk e ka parë projektin seriozisht si lidhje të Shkupit me Tiranën, duke projektuar dhe investuar në një rrugë që vetëm do lidhë Tiranën me Dibrën.

Tani është koha që dy qeveritë duhet të punojnë së bashku dhe ta shohin rrugën si një mundësi të madhe shkëmbimesh ekonomike në të ardhmen, aq më tepër kur dy vendet theksojnë se aspirata europiane e tyre është e palëkundur.

***

Çështja e ndërtimit të Rrugës së Arbrit duket se është drejt finalizimit. Në këtë fazë, pavarësisht kundërshtive politike, ekziston vullneti i përbashkët për ta nisur dhe përfunduar rrugën. Dhe debati në këtë kohë, për ta ndërtuar me cilësi dhe me standarde është debati i duhur. Pasi rrugën do ta paguajnë qytetarët, pavarësisht nëse financohet nga buxheti apo taksat e kalimit të makinave. Tirana, Dibra, Mati dhe shqiptarët e Maqedonisë e duan Rrugën e Arbërit me standarde dhe cilësi: sepse vetëm kështu ajo do t'u vlejë shqiptareve dhe do të ndikojë në një zhvillim të dukshëm ekonomik të vendit.

Më shumë nga diskutimet në Parlament lexoni në faqet 4-8

Rruga e Arbërit nr. 108

Intervistë ekskluzive
me deputetin Koço Kokëdhima

intervistë

Qeveria *shqiptare* ka vendosur *që* ta kryejë Rrugën e Arbrit

Koço Kokëdhima nuk është deputet i Dibrës, por si një ndër deputetët që vjen nga bota e biznesit, si dhe duke pasur parasysh se është kryetar i Grupit Parlamentar të Miqësisë Shqipëri – Kinë, ka informacion për gjithçka që ka të bëjë me negocimin e marrëveshjes me qeverinë dhe firmën "China State Construction Company" për ndërtimin e Rrugës së Arbrit. Gjatë seancës së miratimit të ligjit të posaçëm për dhënien e lejes për nënshkrimin e kontratës me firmën kineze, Kokëdhima përmendi punën e lavdërueshme të qeverisë shqiptare, për të bërë të mundur në arritjen e një marrëveshje të dobishme jo vetëm për fillimin sa më shpejt të punimeve, por edhe për të nënshkruar një marrëveshje me interes për qeverinë shqiptare.

Ne u takuam me zotin Kokëdhima dhe biseduam me të për disa nga problematikat që kanë të bëjnë jo vetëm me finalizimin e marrëveshjes, por edhe për disa çështje të tjera që kanë të bëjnë me standardin e rrugës.

Pyetjes së çfarë pune ka bërë qeveria shqiptare deri në fazën e tanishme të negocimit me firmën dhe qeverinë kineze, ai iu përgjigj:

Koço Kokëdhima: Rruga e Arbrit është promovuar vite më parë nga qeveritë e kaluara, të cilat kanë miratuar projektin e fizibilitetit dhe disa segmente të kësaj rruge i kanë kontraktuar me ndërtues të ndryshëm. Por disa nga këto segmente rrugore nuk janë mbyllur, sepse ato kontrata u bënë, siç ishin bërë edhe shumë të tjera të ngjashme, pa pasur paratë. Pra, janë bërë kontratat, por nuk janë çelur fondet. Kështu që, kompanitë filluan të punonin, i kanë bërë disa punime me fondet e tyre, por i kanë lënë pa përfunduar. Pjesa më kryesore dhe më e kushtueshme e kësaj gjurme është pjesa e urave dhe tuneleve, prej 26 km, e cila është jo vetëm e vështirësisë së lartë teknike, por është edhe mjaft e kushtueshme. Ajo pjesë e rrugës kushton gati 200 milionë euro.

Ky segment nuk kishte filluar, madje as ishte kontraktuar dhe as ishin gjendur financimet në kohën e qeverisë së kaluar. Kishte një propozim nga një kompani kineze për ta bërë këtë punë. Propozimi kishte nisur të negociohej, por nuk ishte finalizuar. Ai propozim i kishte termat relativisht të kushtueshme për Shqipërinë. Unë do të përmend dy tregues, që i thashë edhe në seancën parlamentare, që vlejnë për llogaritjen e planit të biznesit dhe që janë thelbësore për sa i përket propozimit të palës kineze. Ato dy tregues janë niveli i interesit te kredisë që kompania kineze duhet të huante nga bankat për ta financuar projektin. Kompania do të huazonte 70 për qind të fondeve të nevojshme për ndërtimin e rrugës, ndërsa 30 për qind do ta financonte nga buxheti i vet.

Për 70 për qind të buxhetit ata parashikonin një kredi komerciale 8.5 + 1 për qind, që relativisht ishte një kredi e shtrenjtë. Ndërsa një tregues tjetër, që është IRR, ose ndryshe Koeficienti i Rikthimit të Investimit, parashikohej 14.5 për qind, që gjithashtu ishte një tregues i lartë.

Në këto kushte, qeveria jonë sapo filloi punën, filloi ta rivlerësojë këtë situatë.

Duhet theksuar se qeveria shqiptare ka vendosur që ta kryejë Rrugën e Arbrit. Kjo është gjëja më e rëndësishme që duhet të ndajmë me qytetarët. Qeveria jonë, pavarësisht se investimet e kryera në këtë projekt janë gati – gati të papërfillshme në raport me vlerën e projektit, ka vendosur ta kryejë këtë vepër, sepse ajo ka rëndësi shumë të madhe për popullsinë e zonës së Dibrës, Matit dhe për pjesën matanë kufirit, që janë gjithashtu territore të banuara nga popullsi shqiptare.

Kjo vepër do t'i zhvillojë këto zona, do të realizojë një lidhje shumë të afërt të këtyre territoreve me kryeqytetin e Shqipërisë. Rruga do ta sjellë Shkupin 100 km me afër me Tiranën. Kjo u intereson shumë edhe vete pjesës maqedonase, sepse me këtë rrugë Shkupi do të ishte një atraksion turistik shumë i mirë për banorët e Shqipërisë, Tiranës e Durrësit. Nëpërmjet kësaj rrugë ekonomia e Maqedonisë do të gjeneronte të ardhura jo vetëm nga turizmi, por edhe nga fusha të tjera të shkëmbimeve tregtare.

Pra, kjo rrugë ka shumë përfitime të rëndësishme politike, strategjike, ekonomike dhe sociale dhe për këtë shkak qeveria jonë është shumë e vendosur që ta kryejë këtë investim deri në fund dhe sa më parë të mundet.



Qeveria jonë, pavarësisht se investimet e kryera në këtë projekt janë gati – gati të papërfillshme në raport me vlerën e projektit, ka vendosur ta kryejë këtë vepër, sepse ajo ka rëndësi shumë të madhe për popullsinë e zonës së Dibrës, Matit dhe për pjesën matanë kufirit, që janë gjithashtu territore të banuara nga popullsi shqiptare.

Nuk mund të them që ajo do të jetë një autostrade me shumë korsi, sepse kjo është diçka që nuk është thelbësore për cilësinë e rrugës. Numri i korsive është thelbësore për t'i dhënë zgjidhje një trafiku të madh, por ajo që është e rëndësishme për kalimin në rrugë me komoditet, me ato parametra të sigurisë, të pjerrtësisë së rrugës, shpejtësisë së lëvizjes, do të jetë një rrugë që do të bëhet model. Ndoshta nga veprat me cilësi më të lartë në Shqipëri. Unë besoj se do të jetë kështu.

Por nga ana tjetër, unë jam në dijeni se qeveria po negocion edhe lote të tjera të Rrugës së Arbrit, me qëllim që këto lote të ndërtohen me të njëjtat standarde të larta si ky segment, dhe të financohen paralelisht, sepse sot që flasim bashkë, në këto lote nuk punohet. Ato punë që janë bërë, sot janë nën mëshirën e agjentëve atmosferike.

- Rruga e Arbrit ka nisur si një kërkesë e shoqërisë civile. Politika e ka përdorur këtë çështje për qëllime elektorale, por pavarësisht qëllimeve të mira, disa segmente që konsiderohen të mbyllura ose janë në punime e sipër, nuk respektojnë disa standard bashkëkohore të ndërtimit. Në këto kushte, shoqëria civile ka ngritur zërin vazhdimisht që të kihen parasysh këto standarde, sidomos në segmentin që po flasim prej 26 km. A janë pasur parasysh këto standarde gjatë negociatave?

K.Kokëdhima: Kompania kineze që do të bëjë Rrugën e Arbrit është një kompani shumë serioze. Është ndër më të mëdhatë në botë në këtë industri dhe unë kam besim që ata do të bëjnë një punë shumë të mirë.

Mund t'ju them me shumë përgjegjësi dhe shumë seriozitet se qeveria jonë dhe Kryeministri kanë qenë jashtëzakonisht shumë të vëmendshëm në gjithë procesin e diskutimit dhe negocimit të kësaj vepre. Në dijeninë time Kryeministri vazhdimisht ka insistuar që Rruga e Arbrit të jetë një model për nga cilësia dhe standardet e punimeve rrugore. Dhe unë besoj, se ajo do të jetë një vepër e ndërtuar me shumë cilësi të lartë.

Nuk mund të them që ajo do të jetë një autostrade me shumë korsi, sepse kjo është diçka që nuk është thelbësore për cilësinë e rrugës. Numri i korsive është thelbësore për t'i dhënë zgjidhje një trafiku të madh, por ajo që është e rëndësishme për kalimin në rrugë me komoditet, me ato parametra të sigurisë, të pjerrtësisë së rrugës, shpejtësisë së lëvizjes, do të jetë një rrugë që do të bëhet model. Ndoshta nga veprat me cilësi më të lartë në Shqipëri. Unë besoj se do të jetë kështu.

- Pas miratimit të ligjit, si parashikohet të ecin negociatat? Kur mund të mbyllen ato dhe kur pritet të fillojnë punimet?

K.Kokëdhima: Për të qenë korrekt me lexuesin tuaj, dua të them që për Rrugën e Arbrit ka pasur një interesim konstant nga deputetët e Dibrës. Ata kanë qenë shumë të interesuar. Edhe Ministri ynë i Financave vazhdimisht ka qenë i merakosur dhe i interesuar për t'i dhënë sa më shumë mbështetje kryerjes së kësaj vepre.

Të gjitha këto interesime e kanë shpejtuar procesin e kryerjes së kësaj vepre, por në këtë fazë diskutimi përfshihet vetëm segmenti prej 26 km. Parlamenti ka miratuar procedurën e miratimit të kontratës me kompaninë kineze "China State Construction Company" për segmentin që thamë më sipër, e cila është pjesa më e vështirë e rrugës.

Por nga ana tjetër, unë jam në dijeni se qeveria po negocion edhe lote të tjera të Rrugës së Arbrit, me qëllim që këto lote të ndërtohen me të njëjtat standarde të larta si ky segment, dhe të financohen paralelisht, sepse sot që flasim bashkë, në këto lote nuk punohet. Ato punë që janë bërë, sot janë nën mëshirën e agjentëve atmosferike.

Siç unë jam në dijeni, qeveria po punon intensivisht për të financuar dhe për të kontraktuar edhe segmentet e tjera.

Ajo që mbetet çështje e hapur për këtë rrugë është pjesa matanë kufirit shqiptar, ku nuk ka diçka të sigurt. Ka diskutime, janë ngritur çështjet me qeverinë maqedonase, dikasteret homologe të ministrive përkatëse janë në komunikim të vazhdueshëm. Besoj se edhe kjo do të gjejë një zgjidhje shumë shpejt, gjë e cila do ta bënte rrugën funksionale dhe fizibile brenda një kohe të shkurtër.

- Kur flasim për partneritet publik-privat, e kemi fjalën se rruga do të jetë me pagesë? Në qoftë se do të jetë me pagesë, sa mendohet të jetë kjo pagesë?

K.Kokëdhima: Kjo do të jetë një rrugë me pagesë, sepse rrugë alternative ka për ato zona, pavarësisht se janë rrugë të vështira. Kjo rrugë do të jetë me pagesë, sepse kështu është konceptuar edhe vetë projekti. Shqipëria nuk ka garanci sovrane dhe nuk mund të marrë hua për këtë rrugë. Nuk është çështje vullneti, por Shqipëria i ka huatë e limituara, sepse e ka kaluar tavanin e limituar të borxhit dhe në këto kushte nuk lëshon dot më garanci sovrane, i cili është dokumenti që garanton huadhënësit e rinj.

Kjo ishte edhe një nga arsyet që kjo rrugë nuk mund të financohej me lehtësi për Shqipërinë. Prandaj, edhe Shqipëria duhej të gjente një zgjidhje me palën kineze. Ashtu siç Shqipëria nuk lëshonte dot garanci sovrane, ashtu edhe pala kineze, sipas legjislacionit të saj, nuk i lejonte bankat kineze të jepnin huara në drejtim të një vendi që nuk ofron garanci sovrane.

Dhe për ta kapërcyer këtë çështje, qeveria jonë ndërtoi një model të partneritetit publik-privat me këtë kompani, ku vetë si qeveri ofron tokën e rrugës dhe kompania vendos investimin që do të bëhet, për të marrë një vepër funksionale, e cila do të faturojë ata klientë që do ta shfrytëzojnë këtë vepër.

Makinat që do të kalojnë në këtë rrugë do të faturohen me një tarife mesatare, në mos gaboj, rreth 5 Euro. Në qoftë se kjo vepër do të funksionojë edhe në krahun tjetër, d.m.th. në Maqedoni, janë të gjitha shanset që kjo vepër ta shlyejë investimin. Qeveria jonë do të japë garanci për trafikun e munguar, sipas plan biznesit për 15 vitet e ardhshme, kur kjo vepër do të jetë në funksionim.

- Opozita, pavarësisht se e miratoi ligjin në Parlament, ka shprehur rezerva në këtë proces, duke theksuar se është e pajustifikuar bërja e një ligji të posaçëm për përjashtimin e Rrugës së Arbrit nga një garë e hapur tenderimi. Si e justifikon qeveria këtë shqetësim të opozitës?

K.Kokëdhima: Duhet të jemi të gjithë të qartë se financimet e huaja janë të gjitha financime me kushtëzime. Kështu ndodh edhe me financimet e huaja që vijnë nga vendet perëndimore. Kur shtetet japin financime, kushtëzojnë edhe kompanitë të cilat do të konkurrojnë për këto financime. Nuk jep, p.sh. Europa financime dhe pastaj të konkurrojnë kompani nga Azia, Afrika, Amerika e kështu me radhë. Ajo i kushtëzon këto financime dhe lejon që në konkurrim të marrin pjesë vetëm kompani europiane. Kështu funksionon.

Për ta bërë këtë punë, për një kontratë të tipit PPP që ishte e mundshme për Shqipërinë, zgjidhja u gjet me mbështetjen e kësaj kompanie kineze, e interesuar për këtë projekt. Qeveria e ka negociuar kontratën, propozimin me saktë, dhe e ka sjelle në kushte shumë të favorshme për vendin tonë.

Siç e thashë në fillim, propozimi i mëparshëm i kompanisë kineze, mbi të cilat kishte filluar negocimin qeveria e z. Berisha, e kishte interesin e huasë 8.5 + 1 për qind, dhe IRR 14.5 për qind. Të dyja së bashku 24 për qind.

Ndërsa në gjithë procesin e negocimit të këtij propozimi, i cili u trajtua nga qeveria jonë në shumë nivele dhe shumë institucione, u arrit që kjo kredi që do të financohej kompania, të merrej me 3 për qind interesa.

(vijon në faqen 5)

opinion

Unë jam për të mbështetur përfundimin e Rrugës së Arbrit, pavarësisht kostos së saj, por edhe për t'i kërkuar qeverisë që të mënjanojë një sërë kostosh të fshehta, të cilat do të bien në kurriz të qytetarëve, ashtu siç është paraqitur këtu.

"Një ditë mund të jepni llogari për këto kredi të fshehta"



Nga
SHEREFEDIN SHEHU *

Unë jam për të mbështetur përfundimin e Rrugës së Arbrit, pavarësisht kostos së saj, por edhe për t'i kërkuar qeverisë që të mënjanojë një sërë kostosh të fshehta, të cilat do të bien në kurriz të qytetarëve, ashtu siç është paraqitur këtu.

Është realitet që, tashmë pas dy vjetësh, qeveria kujtohet ta përmendë Rrugën historike të Arbrit, ndonëse kishte premtuar që për dy vjet do ta përfundonte këtë rrugë. Të gjithë e dinë, sidomos ne dibranët, se kjo është një rrugë, e cila do të hapë një perspektivë zhvillimi për zonën e Dibrës, ku do të përfitojnë dibranët, bulqizakët dhe matjanët. Por ky është edhe një projekt i rëndësishëm kombëtar, pasi do të përfitojnë, pavarësisht nga neglizhenca e qeverisë maqedonase, edhe shqiptarët e Maqedonisë që banojnë matanë kufirit.

Më duhet të them se qeveria e kishte harruar këtë projekt, por e nxori sot në skenë, të shpresojmë që nuk e ka nxjerrë për një manipulim të ri zgjedhor, sepse jemi në prag të fushatës elektorale. E them këtë, sepse dy vjet më parë qeveria e përdori këtë projekt pikërisht për të vjedhur votat, sidomos në zonën Bulqizë-Maqellarë.

Qeveria mburret se po ndërton rrugën, ku, në fakt, duhet ta kishte përfunduar. Rruga e Arbrit u bë realitet në vitin 2008. Në vitin 2013 ka pasur një grup, i cili ka negociuar vlerësimin teknik të projektit të qeverisë kineze, një vlerësim realist. Ka një të vërtetë: në planin kombëtar të rrugëve, Rruga e Arbrit nuk është listuar si një projekt prioritar. Po ashtu ka edhe një realitet tjetër të hidhur: në të dyja buxhetet e kësaj qeverie nuk është miratuar asnjë lek për Rrugën e Arbrit.

Unë nuk di të gënjej, zoti Ministër. Më sillni një tenderim që keni bërë për Rrugën e Arbrit në këto dy vjet. Ku e keni vazhdimin e punimeve? Publikisht nuk ka asnjë lek të miratuar në listën e ndarjes së fondeve të Ministrisë së Punëve Publike, nuk ka asnjë tenderim të ri dhe nuk ka asnjë alokim për Rrugën e Arbrit. Qeveria sot ka sjellë një akt, por nëpërmjet tij po shtyn përsëri ose po justifikon shtyrjen e ndërtimit të këtij projekti.

Ne sot, siç e tha edhe vetë ministri, nuk po miratojmë ndërtimin e Rrugës së Arbrit, por procedurat e dhënies me koncesion të ndërtimit dhe të mirëmbajtjes së kësaj rruge. Problemi është se qeveria po përdor Kuvendin për të anashkaluar ligjin e koncesioneve. Vetë titulli i ligjit është "Për një procedurë të veçantë". Më e keqja është se rruga është në letër, ndërsa qeveria nxiton ta paraqesë sikur po miraton ndërtimin e saj. Prandaj unë kam frikë se ky është një projekt elektoral.

Ligji miraton procedurën e veçantë, jo ligjore, për negocimin dhe lidhjen e kontratës së koncesionit pa asnjë kusht apo terma specifikë të përcaktuar në ligj, siç mund të ishin: fondi limit, kostoja për kilometër, periudha e koncesionit etj. Pavarësisht nga këto, unë dhe kolegët e mi do ta mbështesim ndërtimin e Rrugës së Arbrit, por asnjëherë taksat e fshehta. Pavarësisht nga ajo që tha ministri, në relacionin e tij thuhet: "Qeveria merr përsipër riskun nëse nuk do të realizohet trafiku i planifikuar apo trafiku, që është pjesë e studimit të fizibilitetit". Shpresojmë që të mos jetë ajo taksë, sepse ne jemi kundër saj, pasi dibranët, bulqizakët dhe matjanët meritojnë të përfitojnë nga fondet publike dhe investimet publike, ashtu si të gjithë shqiptarët. Nuk duhet që ata të paguajnë taksën vetëm për faktin se nuk votojnë për PS-në.

Kjo do të ishte një taksë mbi taksë, sepse sot shqiptarët paguajnë 325 lekë për një liter karburant. Kjo është taksa e destinuar për mirëmbajtjen e rrugëve, pavarësisht se asnjë lek nga kjo taksë nuk shkon për këtë qëllim. Shqiptarët do të paguajnë 30 milionë euro në vit për mirëmbajtjen e kësaj rruge.

Ne e mbështesim ndërtimin e Rrugës së Arbrit, por procedura që prezantohet këtu ka të bëjë me një kredi të fshehtë. Këtu u pretendua si arritje mënjanimi i sovranitetit të financimit. Në fakt, ne do ta miratojmë dy herë në Kuvend ligjin e sotëm dhe marrëveshjen nesërme. Kështu që kjo kredi, ky financim dhe ky projekt ka sovranitet të dyfishtë, sepse sovraniteti nuk është asgjë tjetër veçse miratimi i marrëveshjes, e cila do të vijë për miratim në parlament. Pra, qytetarët dhe buxheti i shtetit do të paguajnë 30 milionë euro në vit për mirëmbajtjen e kësaj rruge. Kjo, duke mos u ratifikuar dhe regjistruar si kredi, në fakt, përfaqëson një kredi të modelit grek, sepse me ligjin që miratojmë sot dhe atë që do të miratojmë nesër ne garantojmë detyrimet e ardhshme që merr përsipër shteti. Për kredinë që merr kompania ndryshon puna, por dhe për mirëmbajtjen e rrugës. Pra, ne marrim një kredi që nuk e shkruajmë dhe nuk e raportojmë si kredi. Pra, nëpërmjet heqjes së sovranitetit, që shitet si arritje, ne në fakt kemi fshehur marrjen e një kredie Kjo është përgjegjësi e qeveritarëve.

Ndërkohë, përgjimet telefonike në Maqedoni tregojnë që koncensionari ka paguar atje 25 milionë euro ryshfet, por dyshimi shtohet akoma më shumë kur krushku, ose kryenegociatori i Rrugës së Arbrit, del Koço Kokëdhima, pra në të gjitha dyshimet që tashmë janë bërë realitet dhe u përgëzua do të thosha me të padrejtë nga deputetët e LSI-së dhe të Partisë Socialiste në Kuvend duke ia dhënë meritat edhe për këtë Koço Kokëdhimës, se në fakt vetëm këtu kishte ngelur pa hyrë Koçoja. Dhe për këtë unë mendoj që nuk duhet të heshtë as Fondi Monetar Ndërkombëtar, as Banka Botërore dhe Bashkimi Europian, sidomos për aspektin dhe mekanizmat e fshehtë që mund të përdoren me pasqyrimin në marrëveshje të këtij projekti.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje ne nuk miratojmë një koncesion, por një prokurim të drejtpërdrejtë ku do të caktojmë kompaninë ndërtuese, ndonëse paratë do të paguhen prej shqiptarëve dhe nuk do të pasqyrohen si kredi.

Natyrisht që garantojmë koncesionin e një rruge për mirëmbajtjen e saj kur akoma nuk është ndërtuar rruga. Pra, janë vënë në radhë gabim. Prandaj më parë duhet të na kishin sjellë marrëveshjen për të ndërtuar rrugën dhe pastaj të kishit sjellë marrëveshje për dhënien e saj me koncesion. Natyrisht që ne këtë tender e bëjmë dhe sovran, sepse sot dhe në marrëveshjen e nesërme do ta miratojmë këtu në Kuvend dhe jo pak, por garantojmë kthimin e 900 milionë eurove mbrapsht, sepse janë 30 milionë në vit. E vërteta është se qeveria e ka harruar Dibrën dhe u kujtua sot për t'i vënë një taksë. Fermerët dhe blegtorët dibranë në 2 vjet nuk kanë marrë asnjë lek. Ka 2 vjet që Dibra i ka harruar investimet e qeverisë, kur në kohën e PD-së jepej të paktën një projekt për këtë komunë. Fondet e zhvillimit të rajoneve 80% ka shkuar në bashkitë socialiste dhe 70% e tyre në Jug të Shqipërisë. Më flagrant është vendimi i gushtit të vitit të kaluar kur Fondi i Zhvillimit të Rajoneve kanë çuar në Komunën Gjebrës, 7,7 milionë, në Bashkinë e Çorovodës 75 milionë, në Bashkinë e Korçës 260 milionë, në Komunën Udënisht, që ka bllokuar dhe rrugën, ka prishur dhe pronat e qytetarëve, 30 milionë. Fondit Shqiptar të Zhvillimit i janë dhënë 91 milionë lekë për të asfaltuar sheshin e Partisë Socialiste dhe të Ministrisë së Brendshme, me paratë e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve. Fondit Shqiptar të Zhvillimit i janë dhënë dhe 121 milionë lekë për të mbjellë pemë dhe shkurre në rrugën kombëtare Durrës-Vlorë. Këto janë të shkruara. Mos t'ju vijë keq.

Përfundimisht, po ta keni seriozisht, zoti Ministër, nuk keni nevojë të bëni kësi manipulimesh. Tregjet janë në ditën më të mire për huamarrësit, kostot janë shumë të lira. Merreni kredinë dhe ndërtojeni rrugën në një vit. Ne, pavarësisht na dëgjoni apo jo, ne do ta miratojmë projektin, por mos harroni që një ditë mund të jepni llogari për këto kredi të fshehta.

** Deputet i Dibrës (PD)*

QEVERIA SHQIPTARE KA VENDOSUR QË TA KRYEJË RRUGËN E ARBRIT

(vijon nga faqja 4)

Dhe IRR të jetë 3 + 5 për qind, pra 8 për qind , që e sjell këtë propozim të palës kineze dhe ato garancitë që ne si shtet dhe qeveri duhet të japim për këtë investim, në nivele shumë të arsyeshme dhe shumë konkurruese, në kushtet e sotme të ekonomisë botërore.

Prandaj, ky ligj është shumë i përligjur. Bankat kineze nuk japin para që ta bëjnë këtë punë kompanitë europiane, as kompanitë e vendeve të tjera, por i kushtëzojnë financimet e tyre me kompanitë e tyre. Qeveria jonë, siguruisht që ka treguar gjithë vëmendjen e duhur dhe ka negociuar shumë, shumë me këmbëngulje dhe me shumë seriozitet, me shumë përgjegjshmëri dhe ka arritur një negociatë, për mua, nga më të mirat e arritura deri më sot në negocimin e interesave të këtyre marrëdhënieve me kompani në shtetet e huaja.

- Pas nënshkrimit të kontratës, pas sa kohësh parashikohet fillimi i punimeve?

Në kohën e qeverisë së kaluar, kishte një propozim nga një kompani kineze për ta bërë këtë punë. Propozimi kishte nisur të negociohej, por nuk ishte finalizuar. Ai propozim i kishte termat relativisht të kushtueshme për Shqipërinë. Kompania do të huazonte 70 për qind të fondeve të nevojshme për ndërtimin e rrugës, ndërsa 30 për qind do ta financonte nga buxheti i vet. Për 70 për qind të buxhetit ata parashikonin një kredi komerciale 8.5 + 1 për qind, që relativisht ishte një kredi e shtrenjtë. Ndërsa Koeficienti i Rikthimit të Investimit, parashikohej 14.5 për qind, që gjithashtu ishte një tregues i lartë.

- Besoj se brenda tre muajve nga nënshkrimi i kontratës punimet duhet të fillojnë. Ndoshta edhe më shpejt. Ajo është një punë që është vënë në vijë dhe nuk duhet të ketë njeri shqetësim për këtë pjesë të problemit.

Tani janë dy pjesë të tjera të problemit, financimi dhe rikontraktimi i segmenteve të lëna në mes, për të cilat besoj se edhe për to do të ketë një zgjidhje të shpejtë, me qëllim që të ndërtohen edhe ato me të njëjtat standard dhe cilësi.

Pastaj mbetet edhe vazhdimi i pjesës së rrugës në territorin e Maqedonisë. Mbetet mjaft punë për të bërë, por kam besimin se shumë shpejt do të gjejnë zgjidhje, për ta bërë Rrugën e Arbrit një aks të rëndësishëm të komunikimit mes dy shteteve.

***Bisedoi*: BUJAR KAROSHI**

LETËR DEPUTETËVE TË DIBRËS

Përshëndesim vendimin për t'i hapur rrugë një marrëveshje të posaçme për ndërtimin e Rrugës



Nga
GËZIM ALPION

Ne mendojmë se është në dobi të Rrugës së Arbërit dhe të Qeverisë aktuale që z. Rama të na presë në një kohë të përshtatshme në mënyrë që t'i dorëzojmë formalisht peticionin, i cili tani është përkrahur nga më se 10,000 nënshkrues online dhe në formularë.

Po bëhet një vit që nga Tryeza e Rrumbullakët që organizuam në Tiranë për Rrugën e Arbërit ku, katër nga ju dhe një deputet me origjinë dibrane, patët mirësinë ta ndiqni dhe të kontribuoni në diskutime.

Që nga ajo kohë ne nuk kemi pushuar së lobuari për Rrugën. Megjithëse jo gjithmonë nga burime qeveritare, ne vazhdojmë të jemi të mirëinformuar për çështjen e fondeve.

Në mungesë të një marrëveshje përfundimtare me palën kineze, ngurrimi i deritanishëm i Kryeministrit Edi Rama për të na pritur, pavarësisht reagimeve negative që ka ngjallur, deri tani ka qenë deri diku i kuptueshëm nga ana jonë.

Ne i përshëndesim përpjekjet e Qeverisë dhe të z. Shkëlqim Cani, në postin e Ministrit të Financave, për vazhdimin me sukses të negociateve me palën kineze, si dhe vendimin e Kuvendit të Shqipërisë për t'i hapur rrugën një marrëveshje të posaçme për vazhdimin e ndërtimit të Rrugës së Arbërit.

Në këto kushte, ne mendojmë se është në dobi të Rrugës së Arbërit dhe të Qeverisë aktuale që z. Rama të na presë në një kohë të përshtatshme në mënyrë që t'i dorëzojmë formalisht peticionin, i cili tani është përkrahur nga më se 10,000 nënshkrues online dhe në formularë. Peticioni ynë, në një formë, e ka bërë efektin e tij, aq më tepër që ky është peticioni më i gjatë në historinë e Shqipërisë që ka qëndruar larg influencave politike. Në këtë drejtim, peticioni do të ngelet i njëjtë deri në mbylljen e tij, kur të përfundojë me standarde Rruga e Arbërit.

Këtë radhë po ju shkruaj në emër të intelektualëve dibranë, që e kanë mbështetur pa rezerva këtë peticion mbarë popullor, si dhe të të gjithë përkrahësve të shumtë, që ju të ndërmjetësoni një takim me z. Rama. Përveç dorëzimit formal të peticionit, takimi me z. Rama do të jetë një rast shumë i mirë për të ndarë me të disa shqetësime në këtë fazë të finalizimit të marrëveshjes. Ne jemi të gatshëm të kthehemi në Tiranë kurdo që të jetë e përshtatshme për z. Rama deri në fund të vitit në vazhdim.

Ne jemi të hapur për të ndarë mendimet tona edhe me palën kineze po qe se shtrohet nevoja.

Shprehim bindjen se në këtë moment kaq të rëndësishëm, ju do të ngriheni mbi gjithçka që ju ndan politikisht, për të dëshmuar para elektoratit dibran se jeni në lartësinë e duhur për të përmbushur detyrimin tuaj me integritet dhe vendosmëri.

Për ne do të ishte kënaqësi dhe privilegj që në takimin që po kërkojmë të ndërmjetësoni me Kryeministrin të merrni pjesë të gjithë ju Deputetët e Dibrës.

Manja: Unë dua t'iu them sot të gjithë mbështetësve të projektit se Rruga e Arbrit do të ndërtohet me të gjitha standardet bashkëkohore dhe do të ketë të gjithë transparencën në mbikëqyrjen e financimit dhe realizimin e punimeve nga kompania ndërtuese

Rruga e shpresës së madhe



Nga
ULSI MANJA*

Vepra më e rëndësishme dhe që pritet me padurim nga komuniteti i Dibrës dhe më gjerë është ndërtimi i Rrugës së Dibrës, quajtur ndryshe "Rruga e Arbrit", rrugë të cilën komuniteti dibran ka të paktën 20 vjet që e ka kërkuar dhe që sot duhet të ishte ndërtuar.

Rruga e Arbrit është përdorur në çdo fushatë elektorale si një premtim i gënjeshtërt, një premtim sa për të marrë votën. Do të ndërtojmë "Rrugën e Arbrit"- ky ka qenë refreni elektoral i çdo fushate që partitë politike bënin në Dibër e rruga ndër vite mbeti aty ku e linin në të ikur fushatëmashtruesit.

Edhe Partia Socialiste e premtoi këtë rrugë në fushatën elektorale të qershorit 2013, por e premtoi për ta mbajtur e jo për të thithur votat.

U premtua kjo rrugë bazuar mbi kërkesat e njëzëshme dhe të njerëzishme në çdo cep të qarkut dhe falë bindjes së konsoliduar se kjo rrugë është domosdoshmëri.

Pyetjes së qytetarëve Dibranë më 17 Mars 2013 në Pallatin e Kulturës Peshkopi teksa PS shpaloste programin e saj politik: Po ju z. Rama nëse fitoni zgjedhjet a do ta ndërtoni Rrugën e Arbrit apo do të na gënjeni si të tjerët, do ti përgjigjej: "PO, është një përgjegjësi shumë e madhe për mua, për të gjithë ne, për të gjitha zotimet që kemi marrë për Dibrën dhe që do ti bëjmë realitet duke filluar nga Rruga e Arbrit, të bindur se kjo rrugë është domosdoshmëri jetike për më shumë se një rreth, rajon apo qark. Ne e kemi angazhim, zotim, tonin për ta ndërtuar dhe për t'i dhënë fund përdorimit të Rrugës së Arbrit si një mjet për të tërhequr prej hunde gjithë Dibrën".

Kam përshtypjen se në atë kohë shumë pak vetë e besuan pasi po premtonte ndërtimin e një rruge që për vite me rradhë u kishte mbajtur peng dibranëve votën, lirinë dhe mundësinë për tu afruar me kryeqendrën e tyre Tiranën.

Por sot e konsideroj veten me fat si shumë kolegë të mi deputetë nga Dibra, që të përcjell për të gjithë zgjedhësit e mi, mbështetësit e forcës time politike, të koalicionit tonë europian por edhe për të gjithë banorët e Qarkut të Dibrës, lajmin e shumëpritur: atë të finalizimit të kuadrit të duhur ligjor që do ti hapë rrugë përfundimisht jetësimit real të projektit të ndërtimit të Rrugës së Arbrit, për të cilën kemi shpresuar, punuar dhe lobuar të gjithë së bashku në këto 25 vjet.

Dhe është pikërisht kjo mazhorancë që po e bën realitet ndërtimin e kësaj rruge, duke sjellë sot për diskutim dhe miratim paketën ligjore me objekt përcaktimin e procedurës së veçantë, për negocimin dhe lidhjen e kontratës, ndërmjet shtetit shqiptar dhe kompanisë kineze "China State Construction Company" e cila përfshin jo thjeshtë ndërtimin, por operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Rrugës së Arbrit

Po cila është historia politike e kësaj rruge që do të duhet ta dinë banorët e Peshkopisë, Bulqizës, Klosit dhe Matit përgjatë këtyre 25 viteve të tranzicionit?

Faktet janë të tilla:

Qeveria e parë e PD, 1992-1996, zyrtarisht në lidhje me këtë rrugë arriti të ngrinte vetëm grupin e punës për studimin e rrugës dhe asgjë më tepër (tetor 1996).

Qeveria socialiste në mandatin e parë 1997-2001 nuk u mor fare me Rrugën e Arbrit pasi dihet botërisht se mor me ringritjen e shtetit dhe institucioneve të rrënuara nga prag lufta civile e vitit 1997 -1998.

Ndërsa në mandatin e dytë 2001-2005, Qeveria e PS ndërmori dy hapa të rëndësishëm në drejtim të ndërtimit të rrugës së Arbrit: në tetor të vitit 2003 përfundoi studimin e fizibilitetit të rrugës me një fond prej prej 11 milionë lekësh dhe në vitin 2005 me një fond prej 25 milionë lekësh u ngulën kazmat e para në Fushë Bulqizë dhe pastaj ia dorëzoi përsëri pushtetin PD por këtë radhë jo me fishekë e zjarr siç ja la PD në 1997, por me projekte infrastrukturore të nisura dhe më inventar zyrtar.

PD e pati rrugën e Arbrit kryefjalë të fushatës së saj në 2005 dhe premtoi që do mbaronte në 2009, por siç duket kishte premtuar gjurmën e jo rrugën.

E premtoi përsëri në mandatin e dytë 2009-2013 madje duke u përbetuar se në 2011 do ti pritej shiriti duke u justifikuar para Dibranëve se "nuk kishte patur mundësi ti financonte njëkohësisht të dyja Rrugët, edhe rrugën Durrës –Kukës edhe rrugën e Arbrit", kur në fakt ky segment i Rrugës së Arbrit kushtonte më pak se 250 ml eurot që vodhi Lulzim Basha në rrugën Durrës-Kukës dhe që i shpëtoi drejtësisë me procedurë. Po të mos ishin vjedhur ato miliona euro nga z. Basha ndoshta dibranët sot do të lëviznin në rrugën e Arbrit por nuk e patën atë fat sepse si thonë fjalës "hajdutit i ka borxh mbreti" e jo më dibranët.

Berisha "shpon male për kombin e për bashkimin e shqiptarëve" e nuk qenka tu ndërtuar Rrugën e Arbrit 72.6 km !!.- u bilbilonin dibranëve kandidatët për deputetë të PD në 2009 dhe dibranët i dhanë 4 mandate deputetësh PD, por Rruga e Arbrit as në 2013 s'dukej gjëkundi dhe ato 8 km rrugë të segmentit ekzistues Bulqizë –Ura e Çerenecit vinin e ngushtoheshin tek Qafa e Buallit tamam si një shteg dhish dhe duke i lënë qeverisë tonë dy lote të tenderuara por të pa mbështetura me financim.

Në fushatën e 2013 Berisha tentoi ti mashtronte përsëri dibranët me Rrugën e Arbrit duke u thënë se "nuk e mbaruam dot se na doli një problem me rëshqitjen në Tunelin e Murrizit" por dibranët e kishin kuptuar tashmë me kohë që " Berisha shponte male vetëm për vota e për të mbush xhepa e jo për zhvillim e bashkim të shqiptarëve" dhe për një grusht vota mazhoranca e majtë nuk e mori dot deputetin e 4 në Dibër.

Si duket dibranët e kishin kuptuar dibrançe Edi Ramën në mitingun përmbyllës të fushatës elektorale teksa u drejtohej atyre me shprehjen "Kush e voton Saliun, këtu në Dibër, për Rrugën e Arbrit duhet të presë dhe 50 vjet minimum".

Natyrisht studimi i fizibilitetit ka përcaktuar përparësitë e ndërtimit të kësaj rruge, por më lejoni që të parashtroj disa prej përparësive kryesore të bëra publike në vijimësi nga specialistë dibranë, organet e qeverisjes vendore dhe nga shoqata "Nisma Dibrane", nga persona e personalitete që kanë punuar e këmbëngulur ndër vite për ndërtimin e kësaj rruge:

- Ndërtimi i kësaj rruge ka rëndësi të jashtëzakonshme ekonomike, kulturore e kombëtare, për qarkun e Dibrës dhe më tej, i hapet drita jeshile për integrim mbarëkombëtar dhe prosperitet të gjithanshëm.

- Ndërtimi i kësaj rruge do ta nxirrte Dibrën nga izolimi i sotëm e konsiderimi si "një xhep" anësor i Shqipërisë.

- Nga ndërtimi i kësaj rruge vetëm në qarkun e Dibrës (Dibër, Bulqizë, Klos e Mat) përfitojnë rreth 200 mijë banorë, rreth 400 mijë shqiptarë të tjerë në Maqedoninë Perëndimore, përfiton gjithë Ballkani Qendror.

- Ndërtimi i kësaj rruge "i heq nga shpina" Dibrës 83 km rrugë të tepërt, të cilën e ka pasur "barrë" për mbi 50 vjet. Qytetet Burrel e Bulqizë kthehen në lagje të Tiranës me largësi nga qendra e saj respektivisht 52 dhe 51 km (nga 98 km dhe 131 km që janë sot), largësia Peshkopi – Tiranë mbetet vetëm 100 km, Dibra e Madhe mbetet larg Tiranës vetëm 83 km nga 162 km që është sot, Gostivari 141 km nga 228 km që është sot apo 242 km që duhet të bëjë nga Qafë Thana, Tetova mbetet 175 km nga 262 km që është sot, apo 274 km nga Qafë Thana.

- Me ndërtimin e kësaj rruge shteti shqiptar vihet në zotërim të plotë të Luginës së Drinit të Zi, lugina më e madhe dhe më e rëndësishme e Shqipërisë qëndrore, ku janë të përqëndruara resurse të mëdha kromi (mbi 300 milionë ton), mermeri, gipsi, ujëra termale etj.

- Rrit shkëmbimin ekonomik e kulturor, qarkullimin e njerëzve, shkëmbimin e mallrave brenda e jashtë vendit.

- Ndikimi pozitiv në zhvillimin e biznesit është në përmasa të pallogaritshme.

- Ndërtimi i kësaj rruge do të ndalojë migrimin e pakontrolluar, të pamotivuar e të pavend te qytetarëve dibranë, bulqizakë e matjanë drejt qyteteve të tjera.

- Është faktor i rëndësishëm për rritjen e investimeve të huaja e të brendëshme si dhe për zhvillimin e turizmit, për të cilin resurset në qarkun e Dibrës janë të mrekullueshme.

- Me ndërtimin e kësaj rruge Dibra nuk do të zvarritet më drejt progresit, por e ndërton vetë progresin e saj.

Pjesa e Rrugës për të cilën diskutohet nuk do të jetë si simotrat e saj, pjesë të përfunduara, në të cilat asfalti ka dalë e muret mbajtëse janë shembur me të rënë një vesë shiu por do të jetë rrugë e parametrave evropiane për një popull që e meriton rrugën, që meriton të jetë i vlerësuar, meriton të ketë një jetë më të lumtur.

Këtu nuk po flasim për projektet e laptopëve 100 dollarësh nëpër shkolla, që nuk u realizuan asnjëherë; as për akte të pështira servilizmi ndaj Pekinit si ato që u ka shitur për propagandë bajate shqiptarëve Sali Berisha se "gjuha kineze do të jetë gjuha e dytë zyrtare" në shkollat tona.

Por jemi këtu për ti hapur rrugën një projekti strategjik, për të ndërtuar një praktikë moderne të funksionimit të ekonomisë përmes një partneriteti publik – privat dhe për të shënuar një kapitull të ri bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Kinës.

Financimi i Rrugës së Arbrit nga EXIM Bank Kina shënon mbështetjen e projektit të parë privat në Europën Lindore. Sipas këtij modeli, pritet të ketë edhe projekte të tjera të këtij lloji që do të financohen nga shteti kinez, por edhe sipërmarrja private kineze.

Rruga fillon në dalje të qytetit Tiranës, rrëzë malit të Dajtit, pasi kalon segmentet e projektuara, tenderuara dhe në proces ndërtimi nga ARSH me fondet e buxhetit të shtetit. Segment i pafilluar ka një gjatësi prej 26.8 km, me gjerësi 10.5 m, me dy korsi të asfaltuara me gjerësi nga 3.75 m dhe me shpejtësi të projektuar 60 km/orë (për segmente të veçanta 50 km/orë). Në këtë segment parashikohet ndërtimi i 15 urave të mesme dhe të mëdha, me gjatësi totale rreth 1 500 m, ndërtimi i dy tuneleve, me gjatësi respektive prej 2 600 dhe 560 m.

Ky Parlament dhe kjo mazhorancë po korrigjon sot gabimet që u bënë me zvarritjen e ndërtimit të Rrugës së Arbrit dhe pa u zgjatur në detajet e projektligjit do ti ftoja edhe deputetët e opozitës që të bëhen pjesë e diskutimeve dhe e miratimit të kësaj pakete ligjore me rëndësi të dorës së parë për përshpejtimin e fillimit të punimeve në këtë segment të fundit të rrugës.

Unë dua t'iu them sot të gjithë mbështetësve të projektit se Rruga e Arbrit do të ndërtohet me të gjitha standardet bashkëkohore dhe do të ketë të gjithë transparencën në mbikëqyrjen e financimit dhe realizimin e punimeve nga kompania ndërtuese sepse paketën ligjore që do të votojmë sot, ne nuk e kemi sjellë nën sqetull dhe as nuk po e firmosim në mes të natës por ditën për diell në parlamentin legjitim të shqiptarëve.

(*vijon në faqen 16)*

Rruga e Arbrit sot është me afër së kurrë të bërit realitet



Nga
RAKIP SULI *

Sot ne kemi për shqyrtim dhe miratim projektligjin "Për caktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës koncesionare, me objekt: ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e rrugës së Arbrit.

Unë e konsideroj si një ndër projektligjet më të rëndësishëm që ka miratuar ky kuvend në historinë e tij pluraliste, për faktin se do mundësojë, ndërtimin e Rrugës së Arbrit, rrugën me të vjetër në historinë e vendit, që daton që në kohën e pushtimit romak të trojeve Shqiptare.

Të flasësh për Rrugën e Arbrit, është sikurse të flasësh për historinë e kombit, jo vetëm për shkak të emrit, që me të drejtë mbart, por dhe për shkak të simbolikës që përfaqëson kjo rrugë.

Rruga e Arbrit, e cila do të transformojë pozitivisht perspektivën dhe kushtet social ekonomike të qytetarëve të Peshkopisë, Dibrës, Matit dhe të zonave përreth, sot është me afër së kurrë të bërit realitet, ndërkohë që prej 22 vitesh ishte një mashtrim i mirëfilltë elektoral.

Ndërtimi me procedure të veçantë i Rrugës së Arbrit është i domosdoshëm, për vetë rëndësinë që ka kjo vepër infrastrukturore dhe të mirat që ju sjell qytetarëve, në afrimin e Shqiptarëve në të dy anët e kufirit, Dibrës dhe Dibrës së Madhe me Tiranën, nga 180 km që është sot, në rreth 80-90 km; shkurtimin e distancës që lidhin Tiranën dhe Portin e Durrësit me Peshkopinë, Dibrën, Matin dhe Shkupin; kursimin e kohës së udhëtimit dhe kostove operacionale të mjeteve; uljen e numrit të aksidenteve; rritjen e volumit tregtar të shkëmbimit të mallrave midis Republikës së Shqipërisë dhe Maqedonisë.

Ndërtimi i kësaj rruge si një premtim i kësaj mazhorance, sjell një perspektivë të re për zhvillimin e këtyre zonave, të cilat kthehen në zona me shumë mundësi investimi, për shkak të pasurive minerale nëntokësore, për të cilat shquhen, do të mund të tërheqin investitorë të huaj, duke u bërë kështu burim punësimi e të ardhurash të konsiderueshme. Kjo rrugë, gjithashtu, do të stimuloje ë kultivimin dhe prodhimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në këto zona. Ashtu sikurse çon në kthimin e vëmendjes të vizitoreve ndaj resurseve me potencial turistik, të shumta në këto zona.

Arritja në këtë fazë për negocimin dhe lidhjen e kontratës koncesionare, me objekt ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e rrugës së Arbrit, vetëm 2 vite pas dhënies së këtij premtimi elektoral nga kryeministri Rama, është për tu duartrokitur, është një premtim tjetër i mbajtur, pas legalizimeve falas dhe reformave madhore të ndërmarra nga kjo qeveri. Ajo që e shqetëson opozitën, nuk janë procedurat e veçanta për negocimin dhe lidhjen e kontratës, si një përjashtim nga ligji për "koncensionet dhe partneritetin publik-privat". Por duan që kjo rruge të mos bëhet, që të vazhdojnë të mbajnë peng ëndrrën dibrane për rrugën që u kthen integrimin, zhvillimin, mirëqenien. Plot 22 vjet ua premtuan e u morën votat! Por me 23 qershor 2013, besën e dha Edi Rama dhe Edi Rama do e mbyll këtë projekt madhor.

Lidhur me këtë projekt parashikohet ndërtimi i rreth 26.8 km segment rrugor i pafilluar, me gjerësi 10.5 m dhe 2 korsi, ndërtimi i 15 urave të mesme dhe të mëdha me gjatësi totale 1500 m/l, hapja e dy tuneleve me gjatësi respektive 2600 dhe 560 m/l.

Me ndërtimin e kësaj rruge, përmbushet një prioritet madhor kombëtar, në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, por dhe të nxitjes së punësimit e zhvillimit ekonomik të vendit.

Duke qenë i bindur në nevojën, ligjshmërinë dhe drejtësinë e miratimit të këtij projektligji, deklaroj votën time "Pro" dhe ju ftoj të gjithëve ju kolege të nderuar, të votojmë këtë projektligj, për ti hapur rrugë ndërtimit të kësaj rruge historike.

** Deputet i Tiranës (PS)*

opinion

Keta: Qeveria ka 2 vjet që nuk ka shprehur asnjë vullnet për të investuar në rrugët e Dibrës. Vetëm Bulqiza i ka dhënë buxhetit të shtetit miliona dollarë dhe, po të bëjmë një analizë ekonomike, vetëm nga të ardhurat e aktivitetit minerar, do të ishte ndërtuar Rruga e Arbrit

Politika e ka **detyrim** dhe duhej ta kishte përfunduar **Rrugën e Arbrit**



Nga **ROLAND KETA***

Sot diskutohet projektligji për vazhdimin e rrugës së Arbrit dhe çdo qytetar i Dibrës, Matit e Bulqizës po na ndjek. Ata presin sa më shpejt përfundimin e kësaj vepre me rëndësi jetike për jetën e këtyre qytetarëve dhe çdokush prej tyre argumenton sepse duhet rruga e Arbrit:

1. Është një rrugë me origjinë antike. Dokumentet e tregojnë që ka funksionuar që në Shek. I-II dhe përmendet në dokumentet romake në Shek. XII, si një ndër akset kryesore që të çonin në brendësi të kontinentit. Këtë e tregojnë sot edhe urat e vjetra si dhe vendbanimet e lashta përgjatë vendeve ku kalon aksi i rrugës.

2. Është lidhja më e shkurtër mes Shkupit dhe Tiranës, duke e shkurtuar rrugën aktuale me 100 km. Aktualisht njihet si Korridori C, një degë e Korridorit 8.

3. Krijon një dalje në Detin Mesdhe brenda ditës për Maqedoninë dhe Bullgarinë.

4. Lidh në mënyrë të drejtpërdrejtë dy kryeqytete (Tiranën me Shkupin), dy aeroporte (Rinasin - Shkupin) dhe krijon dalje në Mesdhe për Maqedoninë.

5. Rruga përshkon rajone me shumë pasuri natyrore me rëndësi strategjike për ekonominë kombëtare.

6. Afron qytetin e Bulqizës, një nga vendet mineralmbajtëse më të mëdhaja në Europë me Tiranën me vetëm 40 km. Bulqiza është rajoni më i pasur me mineralin e kromit por vuan nga vëmendja e Qeverise.

7. Është një mundësi e mirë për investime nga bizneset shqiptare dhe të huaja, pasi rajoni nga kalon aksi i rrugës vuan nga mungesa e investimeve në ekonomi, industri, turizëm etj.

8. Hap një mundësi të madhe për investime në të gjitha llojet e industrisë që nga kromi, gjipsi, mermeri e deri te industritë agropërpunuese e turistike.

9. Krijon hapësira të mëdhaja për turizmin malor dhe zhvillimin e sporteve dimërore.

10. Frenon migracionin e popullsisë së rajoneve lindore me prirje për të gjetur kushte jetese më të mira në Ultësirën Perëndimore (Tiranë, Durrës etj.)

11. Do të ndihmojë në zhvillimin e zonave të varfëra në Shqipërinë lindore dhe Maqedoninë Perëndimore.

12. Ofron produkte bujqësore bio për tregun shqiptar dhe rajonal.

13. Rruga do të sjellë efekte të ndërsjella dhe shumë të rëndësishme për kryeqytetin, Tiranën, e cila aktualisht është tërësisht e mbyllur nga Lindja dhe e privuar nga mundësitë e hapjes dhe të shfrytëzimit të resurseve të rajonit.

14. Do të ndihmojë në rritjen e komunikimit dhe bashkëpunimit mes Maqedonisë dhe Shqipërisë, duke ndihmuar në zbutjen e konflikteve etnike dhe rritjen e bashkëjetesës dhe ruajtjen e stabilitetit në Ballkanin Perëndimor.

15. Efektet pozitive të rrugës, në fushë ekonomike dhe sociale, shkojnë në shërbim të proceseve integruese të Shqipërisë dhe Maqedonisë drejt BE-së.

Çdo qytetar i Dibrës por edhe i shqiptarëve të Maqedonisë ndjekin prej vitesh premtimet elektorale për rrugën e Arbrit dhe besoj janë të gëzuar për çdo segment të investuar gjatë viteve 2007-2013, dhe konkretisht segmenti Bulqizë-Çerenec 18 km me vlerë 1.7 miliardë lekë të reja dhe Bulqizë-Ura e Vashës me tre lote bashkë me tunelin e Qafës së Buallit rreth 18 km me vlerë financimi 3 Miliardë lekë dhe segmenti Tiranë-Ura e Barit 6 km me vlerë 2.6 miliardë lekë.

Por, ishte fushata e 2013 ku Qeveria e Rilindjes në Qytetin e Peshkopisë dhe Bulqizës premtoi tri prioritete për vitet 2013-2017: Rruga e Arbrit, Rruga e Arbrit, Rruga e Arbrit.

Por çfarë ndodhi? Kemi 2 vite qeverisje, 2 buxhete të miratuara dhe asnjë fond për të vazhduar Rrugën e Arbrit. Edhe tuneli i Qafës së Buallit ishte prokuruar dhe lidhur kontrata që në mandatin e Qeverisë Berisha.

Vetëm fillimi i këtij investimi historik rriti besueshmërinë e qytetarëve dibranë, por edhe investitorëve në këto zona duke nxitur zhvillimin e bizneseve sidomos atë të bujqësisë apo të ndërtimit, shumë banorë të larguar nga Dibra e Bulqiza janë kthyer për të jetuar në Bulqizë, Klos dhe Dibër.

Politika i ka detyrime dhe duhej ta kishte përfunduar Rrugën e Arbrit, qytetarët e kanë kërkuar prej vitesh, dekadash për ndërtimin e Rrugës së Arbrit.

Ishte nisma e 4 Janarit 1996 e një grupi Intelektualësh në shoqatën 'Nisma Dibrane' ku i drejtoheshin të gjithë institucioneve, të gjithë forcave politike. Ishin kërkesat e vazhdueshme të intelektualëve, deputetëve të gjithë forcat politike të gjithë qytetarëve të këtij Qarku, ku në vitin 2003 e bindën Qeverinë për nevojat e kësaj vepre dhe filloi studimi dhe fizibiliteti i kësaj rruge.

Por atyre u kujtohet mashtrimi i Qeverisë Socialiste ku katër ditë para zgjedhjeve të

3 korrikut 2005, ish kryeministri Fatos Nano preu shiritin e fillimit të hapjes së kësaj rruge në dalje të qytetit të Bulqizës, në vendin e quajtur Gurët e Skënderbeut, duke u tallur dhe mashtruar komunitetin dibran dhe shqiptarët brenda e jashtë vendit.

Të gjithë qytetarët vlerësojnë se fillimi i kësaj Rruge filloi në Qeverinë e Partisë Demokratike, por sigurisht që duhej bërë më shumë, edhe sot qytetarët dibranë janë mosbesues, sepse marrëveshja me Kinezët kishte filluar para 2 vjetësh nga Ish-Kryeministri Berisha dhe ishte koha e mjaftueshme të përfundonte.

Por çfarë ndodh sot, ju e sillni në Parlament, premtoni se do ta filloni në 2016 dhe përfundon në 2019. Kjo është politikë dhe jo transparente.

Të gjithë dibranët me të drejtë bëjnë pyetjet: përse e sillni në Parlament 2 muaj para zgjedhjeve lokale? Çfarë bëtë për 2 vjet Qeverisje? Përse nuk mbani premtimin se do ta përfundonit në 2017?

Të gjithë shqiptarët e dinë se rrugët jepen me koncesion kur e ndërton privati dhe jo shteti. Ky koncesion a nuk do të ndikojë direkt në ekonominë e çdo qytetari Dibran? A është ndjekur ndonjëherë në Shqipëri kjo procedurë? Sigurisht që JO.

Duke vlerësuar rrugën si veprën më të madhe për Qarkun e Dibrës jemi mosbesues se nuk do ta realizoni atë, sepse keni 2 vjet që nuk keni shprehur vullnet për të investuar në Rrugët e Dibrës apo të Bulqizës. I keni lënë të gjitha investimet e filluara në vite më parë përgjysmë, ku sot ato po dëmtohen edhe investimet e kryera.

As nuk bëhet fjalë nga 2 vjet për të përfunduar investimin e ujësjellësit të Shupenzës, zero Lekë nga 2 vjet. Rrugës Shupenzë-Librazhd, zero lekë nga 2 vjet, Ujësjellësin e Gjoricës, zero Lekë. Rrugën Ura Çerenecit – Kufi me Trebishtin, zero Lekë, asnjë investim për rrugët rurale, në Fushë-Bulqizë, Zerqan e Martanesh.

Ju Dibrës i cënuat të drejtën për Reformën Administrative, duke lënë vetëm 4 njësi vendore.

Çdo njësi vendore në Qarkun e Dibrës i keni ulur buxhetet nga 15-29%. Zero lekë investime në Spitalin e Bulqizës, asnjë investim në Qendrat Shëndetësore. Zero fonde për rrugën Ura e Serbinit – Zoqe – Bllac (Komuna Shupenzë). Zero fonde për rrugën Dragu – Kocaj – Dushaj (Komuna fushë- Bulqizë). Zero fonde për rrugët Vajkal, Bulqizë, asnjë fond për rrugët Sopot –Strikqan – Zall Strikqan (komuna Zerqan).

Nuk merret renta minerare në bashkinë Bulqizë, Komunat Zerqan e Martanesh. Asnjë fond për dy vjet për vaditjen në 7 – komuna të Bulqizës.

Sot diskutojmë rrugën e Arbrit dhe në komunën Ostren, fshati Ostren i vogël ka dy javë pa drita. Kjo është qeverisja e Rilindjes.

Vetëm Bulqiza i ka dhënë buxhetit të shtetit miliona dollarë dhe, po të bëjmë një analizë ekonomike, vetëm nga të ardhurat e aktivitetit minerar, do të ishte ndërtuar rruga e Arbrit.

U a keni detyrim Kushtetues dhe ligjor ndërtimin e kësaj vepre. Pse nuk jepen me koncesion Rrugët e Vlorës dhe Gjirokastrës? Pse Rrugën e Kombit e ndërtoi shteti dhe më pas u pa mundësia e dhënies me koncesion për mirëmbajtjen e saj?

Të gjitha këto pikëpyetje e bëjnë mosbesues projektin tuaj. Të gjithë qytetarët dibranë nuk besojnë se do të përfundojë kjo vepër nga qeveria e Rilindjes. Qytetarët dibranë do t'iu besonin n.q.s. kjo vepër do të përfundojë para vitit 2017, sepse ky që premtimi juaj, ata e kuptojnë se ju e sillni 2 muaj para zgjedhjeve lokale, por ata janë të mençur, janë të zgjuar dhe të jeni të sigurtë se do t'ju ndëshkojnë më 21 – Qershor.

Qytetarë të Bulqizës dhe Dibrës! Edhe unë jam njeri si ju, dhe mbështes çdo investim, çdo zhvillim të ekonomisë suaj, çdo shërbim që do iu bëhet qytetarëve matjanë, bulqizakë e dibranë.

Koncesioni i rrugës së Arbrit ka prapaskenat e saj, paligjshmërinë, nuk ka transparencë, nuk ka konkurrencë, zgjidhet një kompani Kineze, pra një koncesionar i paramenduar, një prokurim i pabarabartë. Qeveria e ka detyrim ligjor të hapë një proces konkurrimi. A është bërë studimi i fizibilitetit nga investitori Kinez? Sigurisht që jo. A ka një marrëveshje me qeverinë Maqedonase, pasi është e detyruar të harmonizohet me palën maqedonase, sepse i shërben dhe e lidh me Maqedoninë.

Dhënia me koncesion e kësaj rruge shkon në një zonë, e cila është e varfër ekonomikisht dhe trafiku nuk do të ketë fluksin e pretenduar të qarkullimit të mjeteve dhe, sigurisht, do të jenë banorë të këtyre zonave që do të paguajnë nga taksa që do të vendoset nga qeveria.

Këto janë pikëpyetjet e mëdha dhe jo transparenca e këtij koncesioni.

Si deputet i këtij Qarku mbështes përfundimin sa më parë të kësaj rruge.

** Deputet i Dibrës (PD)*

Punimet *fillojnë* *në* **2016-ën**



Nga **PËRPARIM SPAHIU***

Ky projektligj do t'i hapë udhë realizimit të kësaj ëndrre të madhe të këtyre zonave që meritojnë gjithë vëmendjen e shoqërisë sonë e për të cilët ky Parlament dhe Qeveria e dalë prej tij duhet të bëjnë më shumë.

Projektligji i miratuar në Komisionin e Ekonomisë dhe që pritet të votohet sot në Kuvend, për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës koncesionare / PPP, ndërmjet shtetit shqiptar dhe kompanisë kineze "China State Construction Company", për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Rrugës së Arbrit, si përjashtim nga procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", është një shans i madh për një votë unanime nga të gjithë NE në këtë sallë. Kjo, sepse Rruga e Arbrit, e premtuar nga të gjitha mazhorancat qeverisëse, të paktën në dhjetëvjeçarin e fundit, u jep mundësi politikanëve të të gjithë krahëve t'u tregojnë zgjedhësve të tyre, se "ndodh" që premtimet edhe mbahen...

Si deputet i ri i Qarkut të Dibrës dhe i çliruar nga pesha e fajit të këtij premtimi shumë gjatë të pa mbajtur, vij në seancën e sotme të Kuvendit, duke menduar më tepër për hapat që do të pasojnë votimin e këtij projektligji. Sepse, e nisur që në vitin 2007, me aksin e përfunduar Bulqizë (Qafë Buall) – Ura e Çerenecit dhe e vazhduar me atë në ndërtim, Bulqizë (Qafë Buall) – Ura e Vashës dhe Ura e Brarit, Rruga e Arbrit kërkon edhe 27 kilometra, si dhe rreth 7 të tjera, ende pa projekt. Kështu, pavarësisht se projektligji i sotëm mundëson finalizimin në një kohë sa më të shpejtë të negociatave për lidhjen e kontratës me kompaninë kineze "China State Construction", fillimi i ndërtimit të këtij aksi jetësor, është menduar të nisë më 2016-ën, nëse gjithçka shkon sipas parashikimeve dhe, përfundon në vitin 2019, ose rreth dy vite pas zgjedhjeve të ardhshme parlamentare.

E bëra këtë llogari për t'i hequr të vetmin "merak" përfaqësuesve të opozitës, të cilët po kritikojnë pa asnjë argument projektligjin, duke fshehur "merakun" e vërtetë, atë të një suksesi elektoral në të mirë të kundërshtarëve të tyre politikë. Por nëse vërtet është kjo frikë, opozita e ka dhe argumentin për t'i marrë për vete këto "bonuse" elektorale. Mjafton t'i rikthehet deklaratës së ish-kryeministrit Berisha më 19 korrik 2013: Citoj: "Zgjidhet financimi dhe ndërtimi i plotë i Rrugës së Arbrit. Rrugës së dytë të Kombit!".

Pas mbi një vit traktativash me autoritetet kineze, kompania e ndërtimit nr.1 në Kinë, por përgjithësisht edhe në botë, "China State Construction", paraqiti një ofertë për ndërtimin e plotë të 27 kilometrave të Rrugës së Arbrit që kanë mbetur pa u ndërtuar...Kompania do të bëjë vetë financimin e plotë (koncension), ose të pjesshëm të ndërtimit të rrugës, me një kredi që qeveria kineze i akordon asaj për këtë vepër". Mjafton të shikoni vetëm relacionin që shoqëron këtë projektligj, për të kuptuar sa ndryshon ai nga premtimin i atëhershëm i ish-kryeministrit dhe "merakun" e sotëm.

Unë besoj se mbi çdo gjë, Rruga e Arbrit u duhet qindra-mijëra banorëve pothuajse të "ngujuar" të Shupalit, Murrizës, Xibrit, Gurit dhe Planit të Bardhë, Qafës së Buallit, Vajkalit, Zallit të Bulqizës, Zerqanit, Gjoricës, deri në Peshkopi, dhe se ky aks do t'i japë edhe një impuls të paparë ekonomisë së rajonit në veçanti dhe të gjithë vendit në përgjithësi. Duke dashur të mos përsëris se cila është kompania "China State Construction", e renditur si një ndër 3 kompanitë më të mëdha në botë dhe e para në sektorin e ndërtimit nga gazeta e mirënjohur "The Economist", më mbetet vetëm të uroj që Komisioni i Negocimit të Kontratës, kryesuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, të përmbyllë në kohë rekord kontratën dhe të nisë menjëherë punën për ndërtimin e Rrugës së Arbrit. Ftoj deputetët, të mazhorancës dhe të opozitës, sidomos ata të Qarkut të Dibrës, të votojnë njëzëri këtë projektligj, i cili më në fund do t'i japë udhë realizimit të kësaj ëndrre të madhe të këtyre zonave që meritojnë gjithë vëmendjen e shoqërisë sonë e për të cilët ky Parlament dhe Qeveria e dalë prej tij duhet të bëjnë më shumë.

Deputet i Dibrës (LSI)

Ahmetaj: Eshtë rruga më e shkurtër dhe rruga më vizibël që konkurron pamundësinë e "Korridori 8" sot. Nuk është më sekret që "Korridori 8" sot është kthyer në vështirësi, për një milion arsye gjeopolitike dhe jo financiare. Atëherë, i takon vendimmarrësve shqiptarë të gjejnë një damar të dytë komunikimi me trevat shqiptare apo për të lidhur Durrësin me Shkupin, me Sofjen, në aspektin ekonomik dhe në lëvizjen e lirë dhe të njerëzve.

Rruga e Arbrit me **kosto** më **të ulët** se në 2007



Nga
ARBEN AHMETAJ *

Diskutimi për projektin është qoftë financiar, qoftë teknik, qoftë politik. Dua t'i marr një nga një elementët, sepse besoj se është hera e parë në dy vite që opozita bie dakord me një projekt i cili ka patjetër rëndësi kombëtare, por edhe rajonale.

Aspekti financiar: Do të duhet të theksohet këtu se projekti që kompania kineze ka sjellë, është një projekt i cili do të negociohet. Ajo që ne sjellim këtu është kërkesa për të filluar një procedurë të veçantë, për shkak të natyrës së veçantë të financimit, në formën e partneriteti publik privat, për 27 kilometra patjetër super të vështirë nga ana teknike dhe gjeografike.

Sa do të jetë kostoja? Sa transparente do të jetë? Besoj se ky Parlament dhe institucionet e tjera kanë mundësi ta ndjekin gjatë procedurës së negociatës. Për të sqaruar, sot qeveria kërkon leje për të filluar një procedurë të veçantë për një vepër tejet të domosdoshme. Nga ana teknike, është një nga rrugët më të rëndësishme. Pse është një nga rrugë më të rëndësishme?

Do t'i numëroj arsyet. Patjetër që është Autostrada e Detit. Eshtë rruga më e shkurtër dhe rruga më vizibël që konkurron pamundësinë e "Korridori 8" sot. Nuk është më sekret që "Korridori 8" sot është kthyer në vështirësi, për një milion arsye gjeopolitike dhe jo financiare. Atëherë, i takon vendimmarrësve shqiptarë të gjejnë një damar të dytë komunikimi me trevat shqiptare apo për të lidhur Durrësin me Shkupin, me Sofjen, në aspektin ekonomik dhe në lëvizjen e lirë dhe të njerëzve. Pra, dua ta theksoj, është një alternativë e drejtpërdrejtë, më e mirë e Korridorit 8.

Nga ana e parimit të formulës, do të duhet të pranojmë se është një gjetje inovative. Patjetër që dikur, kur ju e nisët këtë procedurë në 2007-ën, kompania kineze dhe bankat kineze kanë kërkuar garanci sovrane. Po, kanë kërkuar garanci sovrane të drejtpërdrejtë, duhet pranojmë. Nuk ka ndonjë sekret dhe nuk ka asnjë gjë të keqe në fakt.

Formula inovative bën të mundur që shuma që do të investohet në këtë partneritet publik privat, në këtë vepër të madhe, të mos kërkojë garanci sovrane, por të provigjionohet në mënyrë konstante, vit pas viti, në 15 apo 17 vitet që vijnë, në varësi të negociatës që do të bëjmë. Interesat do të jenë shumë më të ulëta se ato që janë paraqitur fillimisht dhe patjetër që parimi kryesor në këto partneritete publike private në infrastrukturë, ajo që quhet risku i volumit të trafikut, apo trafiku i munguar, patjetër që do të kompensohet.

Pra, nga ana financiare dhe nga ana teknike është një projekt që patjetër jo vetëm duhet mbështetur dhe promovuar por, për mendimin tim, do të duhet të shtyhet më tej për të kapur patjetër kufirin me Maqedoninë, për të dalë karshi Tetovës dhe për të kapur unazën Sofje-Shkup-Ohër, në mënyrë që rruga Sofje-Shkup-Durrë të bëhet jo më siç bëhet sot për shtatë orë por të bëhet maksimumi për tre orë, dhe është në favor të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë dhe është në favor të kthimit të Shqipërisë në një qendër logjistike.

Përsa i përket anës politike. Nuk ka asnjë merak për ta thënë, ato treva të Dibrës sot fizikisht janë larg Tiranës dhe nëse ne flasim për ndërlidhjen, në kuadër rajonal me Bashkimin Evropian, është detyrë po e vendimmarrësve, qoftë majtas, qoftë djathtas, është detyrë e qeverisë së Shqipërisë që të mendojë për të afruar në radhë të parë trevat shqiptare brenda kufijve të Shqipërisë me njëra-tjetrën.

Dibra me Tiranën, Dibra me Durrësin, njësitë ekonomike në Dibër me njësitë ekonomike në Tiranë dhe në Durrës, me portin e Durrësit patjetër. Pastaj, po prapë e theksoj, është një projekt patriotik sepse trevat shqiptare në Maqedoni, në vite, pasi kjo rrugë të ndërtohet dhe të zgjatet, dhe ditën që do të kapë unazën Shkup-Ohër, i ka dhënë një mundësi të gjitha atyre trevave shqiptare, të gjithë atyre aktorëve ekonomikë, të kapin portin e Durrësit për dy orë e gjysmë, në favor të zhvillimit ekonomik të tyre dhe në favor të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë.

Pastaj, debati kush e filloi dhe kush do ta inaugurojë besoj që e them drejtpërsëdrejti që është debat infantil që merr ngjyrime politike të panevojshme. Mua më vjen mirë që do ta votoni. Është një përpjekje e drejtpërdrejtë e qeverisë shqiptare jo vetëm në kuadër të konektivitetit dhe jam i bindur që gjatë periudhës së transparencës së negociatës do ta mbështesni dhe më shumë dhe do të jeni të bindur që përpjekja do të jetë shumë më e suksesshme se çfarë ishte menduar para shtatë vitesh, por dhe kostoja do të jetë shumë më e ulët.

** Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit dhe Sipërmarrjes. Fjalë e mbajtur gjatë seancës plenare, më 16 prill 2015 në Kuvendin e Shqipërisë.*

Procesi për Rrugën e Arbrit **është** plotësisht **transparent**



Nga
EDMOND HAXHINASTO*

Miratimi i procedurës së veçantë të Rrugës e Arbrit, vepër e cila ka filluar në vitin 2007 dhe sot jemi në realizimin 50% të kësaj rruge, ndaj mbetet një angazhim i yni për ta realizuar këtë segment të rëndësishëm të rrjetit tonë rrugor.

Unë dëshiroj t'i rikthehem dhe një herë thirrjes që kam bërë që në fillim të këtij mandati, që veprat e rëndësishme të infrastrukturës kombëtare në asnjë mënyrë mos të politizohen dhe mos të shihen nga këndvështrime politike, por si vepra që i përkasin gjithë shqiptarëve, pra me një përqasje zhvillimore dhe kombëtare, e përsëris jo përqasje politike.

Dëshiroj të bëj disa komente përsa u tha nga deputetët e nderuar të opozitës.

Së pari, sa i përket çështjes së transparencës. Absolutisht do të jetë një proces plotësisht transparent, prandaj po sjellim këtë ligj në Parlament dhe po kështu do jetë dhe procesi i diskutimit të termave final të kontratës, të cilat do të sillen në parlament për tu miratuar. Por mund të them se transparenca në Shqipëri edhe duhet të konfirmohet dhe fakti është që e kemi nisur me transparencë të madhe, pasi planifikimi nga propozimi që na ka ardhur është si vlerë për kilometër shumë më e ulët se ajo që është aplikuar deri më sot, besoj nuk është e dhënë e pakët, transparenca nuk është një koncept abstrakt por përkthehet në kosto të veprës. E përsëris, se kosto është më e ulët se ajo që është realizuar deri më sot për këtë vepër konkrete.

Sa i përket garancisë sovrane, duhet të themi se heqja e kërkesës së garancisë sovrane për këtë vepër ka qenë fryt i një procesi negocimi intensiv në nivelin më të lartë të Qeverisë Kineze. Është kërkuar në takime bilaterale me Kryeministrin Kinez, si dhe në takime bilaterale me Drejtorin e Exim Bank, dhe ka qenë rasti i parë që ne nuk japim garanci sovrane.

Dhe dëshiroj të korrigjoj se ndryshe nga çfarë u shpreh këtu, se në këtë projekt nuk kemi dhënë garanci për trafikun, ndoshta mund të krahasohet me tjetër projekt, ndoshta me Rrugën e Kombit. Në rastin konkret e kemi parashikuar në buxhet paketën, të garantosh trafikun do të thotë ta taksosh, çfarë ne nuk e kemi bërë dhe parashikuar. Taksimi i kësaj rruge potencialisht do të vijë vetëm si rezultat i konkluzioneve të Strategjisë së Taksimit të Rrugëve kur të përfundojë studimi. Pra nuk është e vërtetë që ne kemi parashikuar një taksë për këtë rrugë, për ta ndërtuar këtë rrugë me taksat e qytetarëve.

Sa i përket çështjes së standardit, nëse ka dikush vërejtje për gjerësinë apo tiparet tekno-fizike të rrugës ky është projekti jemi të detyruar të vazhdojmë me këtë projekt. Ka filluar që në vitin 2007 është financuar në 9 vite vetëm 50%, dhe shumë mirë që është bërë, por do detyrohemi të ecim me këtë projekt, pasi e theksoj është realizuar rreth 50% e veprës. Sigurisht jemi të detyruar t'i bëjmë ndryshime për përmirësime teknike projektit të kësaj vepre, pasi përballemi me një fakt të përgjithshëm cilësia e projekteve lë shumë për të dëshiruar. Cilësia e projekteve na ka sjellë situata për rritje të madhe të kostove, jo vetëm për mirëmbajtjen por edhe të përfundimit të veprës, pasi gjithë veprat kanë problematika të jashtëzakonshme, veçanërisht me studimet gjeologjike ku ndodhin rrëshqitje masive, bllokohen punimet shtohen kostot dhe kjo vjen si rezultat i difekteve të mëdha në konceptimin e veprave dhe në projektimin e tyre.

Për sa i takon kësaj vepre, është vërtetë që mund të quhet një vepër e rëndësishme e rrjetit tonë rrugor do të kishim dashur gjithashtu që kjo vepër të ishte koordinuar me fqinjët tanë maqedonas, me qëllim që dhe në anën tjetër të kufirit të kishte pasur vendosjen në agjendën tyre, kjo vepër t'i shërbente atij objektivi për të lidhur dy prej qyteteve për të shkurtuar ndjeshëm kohën. Kjo gjë nuk është bërë, e kemi kërkuar në mënyrë të vazhdueshme, vazhdojmë ta kërkojmë, por akoma nuk kemi një angazhim të mirëfilltë nga pala maqedonase, që të paktën një standard i tillë rruge të ndërtohet edhe në anën tjetër të kufirit kështu që të realizojmë objektivin kryesor të veprës për të shkurtuar kohën e lidhjes midis Tiranës dhe Shkupit.

Gjithashtu, dëshiroj ta mbyll duke kërkuar të mos thoni se po vonohemi në këtë vepër, nuk është normale t'i thuhet kësaj qeverie kjo. Vepra është filluar në vitin 2007 e theksoj për herë të tretë që është filluar në 2007-ën, por planifikimi buxhetor i kësaj vepre është sot që flasim pas 9 vitesh me realizim vetëm 50%, kështu që është shumë më e ndershme të themi që na intereson të gjithëve. Duhet t'i planifikojmë veprat ndryshe në të ardhmen me qëllim që edhe ato miliona para që janë hedhur në veprat e infrastrukturës të mos amortizohen pa filluar të kthehet investimi apo benefitet e investimit, në sensin e impaktit të rrugëve. Një rrugë e parealizuar nuk e jep impaktin e saj as ekonomik dhe as shoqëror tërësisht. Një trase, siç është ajo në veprën aktuale dhe e pa përfunduar, nuk jep impakte pozitive, edhe pse sigurisht jep impakte në punësim apo të pjesshme ekonomike, por vepra ka si synim kryesor të realizojë impakt të në shumë drejtime dhe nuk e jep për sa kohë ajo është e papërfunduar.

Po e përfundoj duke e përsëritur edhe një herë se është e domosdoshme dhe i ftoj edhe kolegët e tjerë, që kur flasim për vepra kryesisht kombëtare të adaptojmë një qëndrim kombëtar dhe aspak partiak.

** Ministër i Transportit dhe Infrastrukturës. Fjalë e mbajtur gjatë seancës plenare, më 16 prill 2015 në Kuvendin e Shqipërisë.*

Dibranët të gëzojnë rrugën!
Kjo është e gjitha!



Nga
SHKËLQIM CANI*

Dibranët të mos kujtojnë se na kanë ndonjë borxh, se sikur çfarë bëmë, bëmë vetëm detyrën; atë detyrë që dikush tjetër e mendonte ta bënte për 30-50 vjet, ne e bëmë, mbajtëm fjalën.

Fillimisht dëshiroj të falënderoj një grup deputetësh, veçanërisht zotin Qefalia, që si përfaqësues i deputetëve të Tiranës, është flamurtar në mbrojtje të rrugës së Arbrit. Ne e kuptojmë që gjithnjë kemi shkuar mirë me tiranasit dhe kemi qenë miq të ngushtë me ta.

Por nuk mund të lë pa përmendur edhe deputetë të tjerë, veçanërisht do të përmendja se, - ndryshe nga ndonjë deputet tjetër,- fjalët e deputetit Suli m'u dukën shumë të bukura, se ishin fjalë zemre. Kurse ndonjë tjetrit do i thoja më mirë të heshtte se sa të fliste. Sepse mençuria dibrane është edhe tek heshtja. Por, sidoqoftë, secili zgjedh rrugën e vet.

Natyrshëm që edhe zoti Manja diti të flasë në emër të gjithë dibranëve shumë më bukur se çdo fliste secili nga ne, kështu që na përmblodhi të gjithëve bukur për atë që kemi ndjerë dhe kemi quajtur detyrë për t'ua bërë dibranëve, Rrugën e Arbrit.

Dhe erdhi çasti ku të gjithë gëzojmë për këtë rrugë që tashmë e mori rrugën e vet edhe mori drejtimin ku duhet. Dhe do realizohet.

Dy momente dua të sqaroj, për të hequr çdo turbullirë.

Ka risk gjithnjë ndërtimi i një rruge dhe, - ata që janë ekonomistë e kuptojnë shumë mirë, por edhe populli e kupton mirë, – që, kur ndërtohet një rrugë, bëhet një studim për të ardhurat që do të sjellë. Të ardhurat janë direkte, por edhe indirekte, sepse po u transportua kromi, domatja, molla, frutat, etj, në një distancë më të shkurtër, natyrisht që realizohen të ardhurat, zhvillohet tregtia, investimi, etj., dhe janë të ardhura që llogariten. Por, në qoftë se nuk kalon numri i kamionëve, kuptohet që ka një risk, risk i cili duhet kalkuluar.

Si ministër i Financave jam i detyruar të garantoj këdo, cilindo shqiptar, natyrshëm edhe deputetët, që në tavanet e buxhetit dhe të borxhit është përfshirë gjithçka për ndërtimin e kësaj rruge. Dhe nuk ka as më të voglin problem. Mbetet vetëm qartësimi i negociatave që është një pjesë e dytë e grupeve negociatore. Për transparencë, është vendosur që të vijmë edhe njëherë në Kuvend, në mënyrë që të japë mendimin, vlerësimin edhe Parlamenti për këtë çështje.

Në mbyllje dëshiroj të deklaroj se premtuam dhe e mbajtëm fjalën. Natyrshëm që jemi krenarë se e mbajtëm fjalën; jemi krenarë që bëmë detyrën. As dibranët të mos kujtojnë se na kanë ndonjë borxh, se sikur çfarë bëmë, bëmë vetëm detyrën; atë detyrë që dikush tjetër e mendonte ta bënte për 30-50 vjet, ne e bëmë, mbajtëm fjalën. Ajo që duhet thënë në fund është se rruga do të mbetet, ndërsa kërcënimet që lëshon ndonjë tek-tuk, do jenë pjesë e anektodave të rrugës, që do të tregohen edhe me të. Ajo që vlen për t'u thënë dhe për t'u mbajtur mend nga të gjithë është që "Dibranët të gëzojnë rrugën"! Kjo është e gjitha!

** Ministër i Financave dhe deputeti i Dibrës (PS). Fjalë e mbajtur gjatë seancës plenare, më 16 prill 2015 në Kuvendin e Shqipërisë.*

debat

Shoqata "Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunitetit - Dibër", duke shfrytëzuar udhëtimin e profesorit Gëzim Alpion, iniciatorin e peticionit për Rrugën e Arbrit, organizoi më 13 prill në Pallatin e Kulturës në Dibër një takim me intelektualë dibranë.

Radika, Rruga e Arbrit dhe roli i shoqërisë civile

Shoqata "Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunitetit - Dibër", duke shfrytëzuar udhëtimin e profesorit Gëzim Alpion, iniciatorin e peticionit për Rrugën e Arbrit, organizoi më 13 prill në Pallatin e Kulturës në Dibër një takim me intelektualë dibranë.

"Kjo është një tryezë e hapur, tha në fillim të takimit Shuip Marku, drejtues i qendrës. Rruga e Arbrit dhe devijimi i lumit Radika, janë dy çështje që e shqetësojnë sot komunitetin dibran në këtë pjesë të rajonit, ndaj është një mënyrë e mirë për t'i diskutuar këto tema.

Gëzim Alpion, në gjatë fjalës së tij e vuri theksin te nevoja e intelektualëve për të kontribuar për vendlindjen. "Para dy vitesh, tha ai, bashkë me disa kolegë dibranë, filluam të peticionin për rrugën e Arbrit. Ky peticion është shtresa e fundit e përpjekjeve të intelektualëve që kanë afro 20 vite që luftojnë për këtë rrugë. Përse na duhet kaq shumë kjo rrugë? Rruga e Arbrit i duhet një kombi e një rajoni që i ka dhënë aq shumë civilizimi evropian, por që është akoma i distancuar nga Evropa".

Duke vënë theksin në rëndësinë e integrimit europian të Maqedonisë dhe Shqipërisë, ai tha se "ne argumentojmë që duhet të kthehemi në Europë, por Europa është në Ballkan. Ne nuk po kërkojmë t'i ngjitemi Evropës, Evropa jemi ne, por ne akoma nuk kemi artikuluar në mënyrë bindëse se përse rrënjët e Evropës janë shqiptare, janë ballkanike. Rruga e Arbrit, për mendimin tonë, ka një rëndësi si ekonomike por edhe rëndësi spirituale, ka rëndësi për kombin, ka rëndësi për Ballkanin, ka rëndësi për të gjitha etnitë".

"Duke bërë Rrugën e Arbrit, theksoi Alpion, ne mendojmë se krijohet një shans i madh në këtë pjesë të Ballkanit që të ketë një ingranim të një shkalle që nuk ka ndodhur nëpërmjet Dibrës në Shqipëri, Dibrës në Maqedoni dhe Dibra jonë bëhet një nyje e pallogaritshme, në mënyrë që lidhur hapësirat shqiptare që nëpërmjet tregtisë, shkëmbimeve kulturore. Dibra riafrimohet në vlerat që ka".

Duke falënderuar shqiptarët e Maqedonisë për kontributin që kanë dhënë në nënshkrimin e peticionit, Alpion tha se "ne jemi të vendosur të vazhdojmë dialogun me politikanët edhe kur dyert të na mbyllen. Ne do vazhdojmë të trokasim paqësisht. Duke ndjekur këtë rrugë paqësore dialogu ne do të kontribuojmë që në Shqipëri dhe në Maqedoni, përmes Rrugës së Arbrit, përmes përmirësimit të infrastrukturës, të kuptojmë, se pavarësisht nga e kaluara, e ardhmja është e përbashkët".

Bardhyl Marku, njëri nga aktivistët kundër devijimit të Radikës mbajti një referat mbi historikun e kësaj çështje dhe nevojën e riorganizimit për ta ndalur këtë projekt fatkeq për Dibrën. Pasi solli në vëmendje disa nga veprimtaritë në mbrojtje të ekosistemit të Radikës, Marku theksoi edhe disa çështje të domosdoshme që duhen pasur parasysh në të ardhmen.

"Ministria e mbrojtjes së ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor, Ministria e ekonomisë, Sh.a. ELEM, tha ai, vazhdojnë në mënyrë të heshtur pa bërë zhurmë duke implementuar të gjitha procedurat teknike dhe përgatitje të parakushteve për realizim të këtyre projekteve".

Më pas, ai theksoi se "përderisa nuk bëhet abrogimi i ligjit ekzistues për ndërtim të projektit "Fusha e Llukovës" në parlamentin e Maqedonisë, rreziku i humbjes-tharjes së Radikës është potencial dhe real. Prandaj, në radhë të parë, Dibrës dhe dibranëve i duhet strategji për të shpëtuar Radikën.

Disa nga pikat më të rëndësishme të kësaj strategjie, theksoi Bardhyl Marku janë sigurimi i informatave zyrtare nga institucionet përkatëse në Maqedoni, planifikimi i mjeteve financiare në kuadër të buxhetit të Komunës së Dibrës, për qëllim të mbështetjes së aktiviteteve lidhur me mbrojtjen e Radikës, inicim i procesit gjyqësor kundër Qeverisë së RM me qëllim të hapjes së rrugës për të kërkuar drejtësinë në institucione ndërkombëtare, sensibilizim dhe kontakte me strukturat kompetente në Republikën e Shqipërisë si dhe aktivizim më i gjerë dhe permanent i sektorit joqeveritar në Dibër, Maqedoni, Shqipëri dhe më gjerë.



Rruga e Arbrit i duhet një kombi e një rajoni që i ka dhënë aq shumë civilizimi evropian, por që është akoma i distancuar nga Evropa

Ky debat është një element jashtëzakonisht pozitiv në mënyrën se si po reagohet, sidomos ngritja në nivelin e intelektualëve, diskutimi siç është kjo tryezë e sotme, ka efektin e jashtëzakonshëm për atë që bëjnë politikën.

Kur rendisim argumentet se pse duhet Rruga e Arbrit, njëra prej tyre është pasuritë turistike të Dibrës. Por në qoftë se këto pasuri i shkatërrojmë, atëherë për çfarë do na duhej rruga e Arbrit?

Bashkim Mashkulli, kryetar i këshillit komunal, gjatë fjalës së tij theksoi se "është për të ardhur keq që qeveria e Shqipërisë nuk e shikon aq sa duhet rrugën e Dibrës". Përsa i përket Radikës, ai tha se faktori kryesor për mbrojtjen e Radikës jemi ne, dibranët. Po të jemi ne dibranët së bashku, ata kurrë s'do ta bëjnë, se ne do ta mbrojmë".

Bujar Karoshi, redaktor i gazetës "Rruga e Arbërit", në fjalën e tij theksoi rolin që ka luajtur gazeta në krijimin e hapësirave për sensibilizim, përsa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me rrugën dhe ujërat. "Rrugët ose të afrojnë, ose të largojnë, por Rruga jonë është krijuar dhe vazhdon të jetojë me synimin që ti afrojë njerëzit, ti afrojë Dibrat. Rruga e Arbrit duhet të ndërtohet për ta afruar Dibrën me Tiranën dhe për tu kthyer Dibra në një qendër të rëndësishme të tregtisë, turizmit, ekonomisë dhe jetës".

"Ajo që është e nevojshme, tha ai, është që shoqëria civile duhet të flasë me një zë, sepse kështu do ti tregojnë atyre që bëjnë politikë, se nuk mund të gënjejnë dhe të mashtrojnë popullin, me të njëjtën gënjeshtër vit pas viti. Peticioni këtë synon, tu tregojë partive që qeverisin se nuk mund të gënjejnë më, për ta kuptuar se ka pas disa njerëz të cilët nuk do ta pranojnë më këtë gënjeshtër. Prandaj në qoftë se ju keni premtuar, ju duhet ta mbani fjalën".

Duke folur për Radikën, ai tha se është e frikshme situata edhe në Shqipëri. "Para se të ndërtohet rruga, po turren bizneset, shumë prej tyre të dyshimta nga origjina, për t'i rrëmbyer Dibrës pasuritë e saj: ujin, tokën, malin. Kur rendisim argumentet se pse duhet Rruga e Arbrit, njëra prej tyre është pasuritë turistike të Dibrës. Por në qoftë se këto pasuri i shkatërrojmë, atëherë për çfarë do na duhej rruga e Arbrit?", shtroi pyetjen ai.

Diskutantë që morën fjalën theksuan nevojën e shkëmbimeve të informacioneve, qoftë edhe në rrugë informale, për të qenë në korent të zhvillimeve e vendimeve politike, për t'i dalë të keqes përpara dhe për të mos lejuar që Dibra ta pësojë nga këto vendime kundër saj.

Argëtim Fida, ish kryetar i Komunës së Dibrës, tha se "roli i këtij forumi është shumë i rëndësishëm. Politikanët, vetëm kur ngjiten për muri u japin zgjidhje problemeve". Përsa i përket Radikës, ai kërkoi që partitë shqiptare në Dibër të kushtëzoheshin për votim, nga qëndrimi që do mbajnë për këtë çështje".

Abdyl Koleci, profesor i inxhinierisë, tha se lidhur me projektin e Radikës duhet të kyçen në bisedime të tre shtetet: Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Në qoftë se bëhet fjalë për një projekt ekonomik, atëherë ujërat e Radikës, duke u derdhur në detin Adriatik shfrytëzohen 5-6 herë më shumë. Ky projekt është politik, tha ai. Bota bën projekte që ti nxjerrë fitimet për 5 apo 10 vjet, ndërsa ky projekt i parashikuar nga Qeveria e Maqedonisë, nuk është i vlefshëm nga pikëpamja ekonomike edhe 100 vjet".

Prof. Zamir Dika, rektor i Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë, tha se "qëllimi i një diskutimi apo një argumentimi nuk duhet të jetë fitorja por progresi". Këtë, tha ai, dibranët e kanë arritur. Ky është një element jashtëzakonisht pozitiv në mënyrën se si po reagohet, sidomos ngritja në nivelin e intelektualëve, diskutimi siç është kjo tryezë e sotme, ka efektin e jashtëzakonshëm për atë që bëjnë politikën".

Nisur nga ky debat, ai tha se Universiteti që ai drejton, do të vërë në dispozicion kapacitetet shkencore për t'i studiuar rastet në mënyrë shkencore. Gjithashtu, ai shtroi nevojën e bashkërendimit të veprimtarive të shoqatave, të informojmë njëri-tjetrin për zhvillimet që ndodhin, në mënyrë që çështjet e shtruara për diskutim të marrin zgjidhje.

Në takimin e Dibrës së Madhe folën edhe mjaft intelektualë të tjerë, mes të cilëve Adelina Marku, diplomate në Ministrinë e Jashtmë të Maqedonisë, Ibrahim Kolari, biznesmen, Mërsim Marku, kryetar i gjykatës së Dibrës, gazetari Rexhep Qormemeti, etj.

Korresp. Rr.A.

Këshilli Komunal në Dibër të Madhe shprehet kundër projekteve për devijimin e Radikës

Këshilli Komunal në Dibër të Madhe, në bashkëpunim me Komisionin për ruajtjen e lumit të Radikës është kundër Projektligjit të përgatitur nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë që duhet të votohet në parlamentin e Maqedonisë në lidhje me Parkun Nacional të Mavrovës", tha për gazetën "Rruga e Arbërit" kryetari i Këshillit Komunal të Dibrës së Madhe, Bashkim Mashkulli.

Ai theksoi se komisioni në tërësi kundërshton këtë ligj duke u bazuar në faktet e më poshtme:

Dispozitat e ligjit të propozuar janë në kundërthënie mes vedi dhe me vetë qëllimet kryesore të ligjit.

Qëllimi kryesor i ligjit është ruajtja e gjendjes autoktone dhe burimore të natyrës në Parkun Nacional nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër në dispozitat për përcaktimin e hartës së zonimit të kategorive të zonave mbrojtëse parimet dhe kriteret bazë për kategorizim nuk respektohen.

Zona të veçanta dhe me vlera të posaçme si zona të pa prekura degradohen nga zona për mbrojtje rigoroze apo zona për menaxhim aktiv, në zona për menaxhim të qëndrueshëm. E gjithë kjo që më vonë do të mundësojë realizimin e projekteve hidroteknike që në masë të madhe do të degradonte pasuritë natyrore dhe zhdukjen e disa specieve të mbrojtura dhe do të prishte balancat e biodiversitetit në Parkun Nacional.

Në këtë ligj ndërmjet rreshtave lexohen shumë qartë qëllimet e realizimit të objekteve hidroenergjetike (Fusha e Llukovës, Ura e Boshkut), projekte që janë kundërshtuar me forcë nga Komuna,organizatat joqeveritare, ekspertë të ekologjisë etj.

Në hartën e përcaktimit të zonave mbrojtëse shihet shumë qartë parapërgatitje e terrenit për realizimin e projektit "Fusha e Llukovës"që parashikon ndërtim të hidrocentralit dhe devijim të ujrave të lumit të Radikës.

Në këtë hartë, vendet ku parashihen ndërtimi i objekteve infrastrukturore degradohen në zonat për menaxhim të qëndrueshëm në kundërshtim me kriteret për caktimin e zonave si dhe në kundërshtim me vlerat reale që kanë këto zona. Në këto zona nuk ka objekte infrastrukturore, nuk ka vendbanime, fshatra, nuk ka toka bujqësore por është një zonë ku natyra është e paprekur dhe me vlera të larta nga aspekti i biodiversitetit. Përmbytja e sipërfaqeve të mëdha nga liqenet artificiale si dhe devijimi i ujërave nga rrjedha natyrore ka një ndikim negativ si në aspektin e mbrojtjes së natyrës ashtu edhe në aspektin social dhe ekonomik të popullatës që jeton në afërsi të rrjedhjes së lumit Radikë dhe Drini i Zi. Këto projekte do të ndikojnë edhe në regjimin e ujërave nëntokësore si dhe në burimet e ujërave.

Me devijimin e ujërave të Radikës ekziston edhe mundësia që të shteren shumë burime të ujërave të pijshëm dhe mund të edhe te zvogëlimi i sasisë së ujrave të ftohtë që i furnizojnë burimet e ujërave termominerale të Banjave të Dibrës. Tashmë që nga marrja në fillim të ujërave të Radikës janë shpeshtuar edhe tërmetet në rrethin e Dibrës.

Me zvogëlimin e sasisë së ujit në lumin Radikë gjatë stinës së verës rritet ndotshmëria e ujit në plazhin e liqenit të Dibrës i cili ndotet nga ujërat që vijnë nga Struga dhe Ohri nëpërmjet Drinit të Zi. Kjo shihet se gjatë verës Liqeni i Glloboçicës dhe një pjesë bukur e madhe e liqenit të Dibrës mbulohen me alga jeshile." / **R.Torte**

Rruga e Arbërit nr. 108
bashkitë

Një profil i bashkive të qarkut të Dibrës. Shtrirja gjeografike, pasuritë natyrore, popullsia dhe punësimi, bujqësia dhe blegtoria. Sfidat dhe mundësitë e zhvillimit të rajonit

Mati, Klosi, Bulqiza dhe Dibra:
Ja sfidat me të cilat do përballen kryetarët e rinj

Nga HYSEN LIKDISHA



BASHKIA MAT:
SHTRIRJA GJEOGRAFIKE, POPULLSIA, KLIMA DHE PUNËSIMI

Mati kufizohet në veri me Mirditën, në perëndim me Kurbinin, në jug-perëndim më Krujën, në jug me Klosin dhe në lindje me Dibrën. Qendra e sa është qyteti i Burrelit dhe ka në përbërje tetë njësi administrative: Burrel, Baz, Derjan, Rukaj, Macukull, Komsi, Lis, Ulëz. Sipas censusit të vitit 2011 numëron një popullsi prej 27.260 banorësh, ndërkohë që sipas regjistrit civil kjo bashki numëron 38.615 banorë, në një sipërfaqe prej 493.5 km2 me një densitet prej 78.24 banorë/km2.

Pas viteve '90-'92, si kudo edhe këtu, ka patur lëvizje të lirë të popullatës, e cila ka ndikuar në zvogëlimin e popullatës në fshatra dhe rritjen në qytetin e Burrelit. Gjendja social-ekonomike e banorëve përgjithësisht është e varfër. Niveli i punësimit është relativisht i ulët. Shumica e të punësuarve janë në biznese të ndryshme private tregtare, me menaxhimin e një dyqani të vogël për tregti ose ambulantë. Në uljen e numrit të të punësuarve ka ndikuar edhe mbyllja për vite me radhë e Uzinës së Ferrokromit në qytetin e Burrelit.

Relievi dhe klima mesdhetare mjaft e favorshme, e cila karakterizohet nga vera e nxehtë dhe e thatë me shkëlqim të madh të diellit dhe nga dimri relativisht i butë në luginën e Matit dhe disi i ashpër në brezin malor. Temperatura mesatare vjetore në këtë luginë është afro 14 gradë celsius dhe në ditët më të nxehta të korrikut arrin 38 gradë. Kjo klimë krijon kushte mjaft të favorshme për zhvillimin e bujqësisë, frutikulturës dhe blegtorisë, të cilat janë edhe si burimet kryesore gjeneruese ekonomiko-financiare, por pa harruar edhe industrinë e pasurimit të kromit, nga rihapja e Uzinës së Ferrokromit Burrel. Një tjetër burim i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të këtij rajoni konsiderohet edhe turizmi historik, rikthimi në traditën matjane të hapjes së punishteve të përpunimit të drurit, baxhove të përpunimit të qumështit, zgjidhja e problemit të pronësisë së tokave, si dhe ngritja e pikave të grumbullimit të bimëve medicinale dhe eterovajore. Projekte të mëdha të ndërmarra në këtë rajon mund të përmendim rehabilitimin e Urës së Matit, ndërtimi i ujësjellësit Baz-Komsi me vlerë 1 milionë dollarë, sistemim-asfaltimi i rrugës Zenisht-Lis-Qafë Murrë, ujësjellësi në ish komunën e Ulzës, këndi lojërave Burrel, ndërhyrja për rehabilitimin e fasadave në lagjen "Pjetër Budi", etj.

SFIDAT KRYESORE:

Krijimi i mundësive për punësim i grave dhe vajzave në qytet e fshat. Strategji për mbështetjen sociale të grupeve vulnerable si ngritja e qendrave ditore, banesat sociale, strehëza për gratë e dhunuara etj. Ndërhyrja në përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës shkollore, kopshteve e çerdheve, qendrave shëndetësore e spitaleve. Shërbimi arsimor e shëndetësor edhe në zonat rurale, ku ka një përqendrim të madh të popullsisë, duhet përmirësuar dhe zhvilluar pasi lehtëson arsimimin, shmang braktisjen e shkollave sidomos nga vajzat për shkak të largësisë nga vendbanimi i shërbimeve, lehtëson nënat gjatë ditës së punës kur fëmijët trajtohen. Projekte për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe gjelbërimin e mjediseve publike, planifikimi i territorit, sistemim-asfaltimi i rrugëve drejt zonave turistike, subvencione e mbështetje me plehra kimike e herbicite për fermerët, vënia në eficencë e qendrës rinore, për gjallërimin e aktiviteteve kulturore-artistike.

BASHKIA BULQIZË
SHTRIRJA GJEOGRAFIKE, POPULLSIA, KLIMA DHE PUNËSIMI

Bulqiza kufizohet në veri me Dibrën, në perëndim me Klosin, në jug-perëndim me Tiranën, në jug me Librazhdin dhe në lindje me Republikën e Maqedonisë. Qendra e saj është qyteti Bulqizës. Ka përbërje ka 8 njësi administrative: Bulqizë, Martanesh, Fushë-Bulqizë, Zerqan, Shupenzë, Gjoricë, Ostren, Trebisht. Sipas censusit të vitit 2011 numëron një popullsi prej 32.210 banorësh, ndërkohë që sipas regjistrit civil ajo numëron 40.223 banorë, në një sipërfaqe prej 678.51 km2 me një densitet prej 59.28 banorë/km2.

Relievi kodrinor malor, përcakton si burime kryesore gjeneruese ekonomiko-financiare, bujqësinë dhe blegtorinë, por pa harruar edhe industrinë kromnxjerrëse dhe atë të pasurimit të mineralit të kromit. Një tjetër burim i rëndësishëm ekonomik konsiderohet turizmi malor, familjar, i objekteve të kultit etj., si dhe ngritja e qendrave për grumbullimin e bimëve medicinale, ku rajoni është mjaft i pasur.

Si kudo në vendin tonë pas viteve '90-92 mjaft banorë ju drejtuan emigracionit

Projekte të mëdha të ndërmarra në këtë rajon gjatë viteve të kaluara përmendim sistemim-asfaltimin e segmentit të rrugës nacionale "Qafa e Buallit- Shupenzë" pjesë e Rrugës së Arbrit, si dhe hapjen e tunelit të po kësaj rruge në Qafën e Buallit me gjatësi 460 metër dhe trasenë Qafa e Buallit-Ura e Vashës. Po kështu investime të rëndësishme mund të konsiderojmë edhe sistemim-asfaltimet e rrugëve rurale që lidhin qendrat e komunave Zerqan, Fushë-Bulqizë dhe Gjoricë, me rrugën nacionale.

Ndër problematikat e kësaj zone mbetet ajo e papunësisë që shkon në rreth 40 për qind të fuqisë punëtore të aftë për punë, po të kemi parasysh këtu edhe trendin e kohëve të fundit të kthimit të emigrantëve për shkak të krizës globale.

SFIDAT KRYESORE

Disa nga sfidat e kryetarit të ardhëm janë ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të zeza, menaxhimi i mbeturinave urbane, problemet në mbrojtjen e rigjenerimin e pyjeve, mbrojtja e trashëgimisë kulturore, turizmi malor dhe ndërtimi i rrugëve drejt tyre, vënia në eficencë e vjeljes së të ardhurave nga industria kromnxjerrëse dhe ajo e pasurimit të mineralit të kromit, vënien në shfrytëzim të stoqeve të kromit në rrugë ligjore, mbështetja me subvencione e fermerëve dhe blegtorëve potencial, sistemim-asfaltimi i rrugëve që lidhin qendrat e ish komunave me qendrën e bashkisë Bulqizë, hapja e një qendre sociale për të moshuarit dhe invalidët, ngritja e funksionimi i fushës së futbollit, si dhe e një aneksi sportive për grup-moshat, ruajtjen e kulturës dhe të promovimin e saj, veçanërisht për zonën e Gollobordës, etj.

BASHKIA KLOS

SHTRIRJA GJEOGRAFIKE, POPULLSIA, KLIMA DHE PUNËSIMI

Klosi kufizohet në veri me Matin, në perëndim me Krujën, në jug-perëndim Tiranën, në jug-lindje me Bulqizën. Qendra e saj është qyteti i Klosit. Kë përbërje ka 4 njësi administrative: Klos, Xibër, Suç, Gurrë.

Sipas censusit të vitit 2011 numëron një popullsi prej 16.618 banorësh. Ndërkohë që sipas regjistrit civil kjo bashki numëron 20.281 banorë në një sipërfaqe prej 357.48 km2 me një densitet prej 58.24 banorë/km2.

Një pjesë e mirë e sipërfaqes së kësaj bashkie është zonë fushore që përbëhet nga lugina e Matit me kuota nga 240-265-600 metra mbi nivelin e detit. Klosi është dhe mbetet një pikë nyje që lidh Dibrën me Tiranën. Lëvizjet demografike të popullsisë, karakteristike për rajonin e Dibrës, vihen re dhe në Klos. Kryesisht lëvizja ka patur tendencën drejt qendrës urbane të Burrelit dhe asaj metropolitane në Tirane e Durrës. Emigrimi është i dukshëm sidomos tek të rinjtë dhe burrat, të cilët janë baza kryesore e të ardhurave që vijnë për familjet. Greqia, Italia dhe Anglia janë vendet ku është përqendruar ky emigrim, ku statusi i tyre është si i gjithë emigrantëve të tjerë shqiptarë me dokumente dhe pa dokumente. Degët kryesore të ekonomisë janë bujqësia, ku klima e favorshme lejon kultivimin e të gjitha bimëve e drufrutorëve, blegtoria dhe shërbimet. Klosi është i pasur me burime të shumta natyrore, tokësore dhe nëntokësore. Pyjet dhe kullotat komunale zënë një sipërfaqe të konsiderueshme, ku përveç lëndës drusore, ka edhe mjaft bimë medicinale. Por edhe pse një nga resurset ekonomike më të rëndësishme për këtë zonë mbetet bujqësia, ajo e lënë në mënyrën e vet tradicionale të shfrytëzimit, nuk ka gjeneruar të ardhura ekonomike sa e si duhet për banorët. Një tjetër burim kryesor të ardhurash për banorët e këtij rajoni përbën edhe turizmi malor dhe historik, si dhe industria kromnxjerrëse në minierat private të Cërujës. Ndër investimet e dhëna në realizimin e projekte të mëdha në këtë zonë përmendim: Sistemim-asfaltim i bulevardit të qytetit, rrugës rurale që lidh fshatin Fshat me qendrën e bashkisë, si dhe sistemim-asfaltimi i rrugëve që lidhin fshatrat Fullqet, Cërujë, Benjë, Lis, Gurrë dhe Kurdari me rrugën nacionale. Po kështu investime në projekte të mëdha konsiderohet edhe ai i dhënë për ndërtimet e ujësjellësve në fshatrat Bershi dhe Cërujë.

SFIDAT KRYESORE

Ndër problematikat më kryesore që mbeten të zgjidhen nga bashkia e re e dalë pas zgjedhjeve të 21 qershorit renditen: mirmenaxhimi i pasurive minerare dhe i tokës bujqësore, ndërhyrje në infrastrukturën rrugore që lidhin qendrat turistike të zonës, hartimi i planit strategjik urbanistik, sistemim - asfaltim i rrugëve që lidhin komunat me qendrën e bashkisë, krijimi i hartës turistike të zonës, ndërtimi i ujësjellësave për fshatrat, ndërtimi i kanaleve vaditëse për secilin fshat , zhvillimi i bujqësisë dhe blektorisë sipas kushteve klimatike për zhvillimin e një kulture bujqësore apo blegtorale, ndërtimi i një pallati kulture në qytet, ndërtimi i unazës së qytetit dhe shndërrimi i bulevardit në pedonale, ndërtimi i dy urave mbi lumin Mat dhe kalimi i qytetit në pjesën Jug –Perëndim të tij, duke patur parasysh krijimin e një lulishtjeje që sot i mungon qytetit, menaxhim ndryshe të minierave etj.

BASHKIA DIBËR.
SHTRIRJA GJEOGRAFIKE, POPULLSIA, KLIMA DHE PUNËSIMI

Dibra kufizohet në veri me Kukësin, në veri-perëndim Mirditën, në perëndim me Matin, në jug-perëndim me Klosin, në jug me Bulqizën dhe në lindje me Republikën e Maqedonisë. Qendra e saj është qyteti i Peshkopisë. Ka në përbërje 15 njësi administrative: Peshkopi, Tomin, Melan, Kastriot, Lurë, Maqellarë, Muhurr, Luzni, Selishtë, Sllovë, Kala e Dodës, Zall-Dardhë, Zall-Reç, Fushë Çidhën, Arras. Sipas censusit të vitit 2011 numëron një popullsi prej 61.619 banorësh, ndërkohë që sipas regjistrit civil numëron 78.940 banorë, në një sipërfaqe prej 937.88 km2 me një densitet prej 84.16 banorë/km2.

Rajoni i Dibrës ka shërbyer si një urë lidhëse për trevat e vendit tonë nga perëndimi në brendësi të territoreve shqiptare. Që në antikitet ka funksionuar rruga Durrës - Fusha e Tiranës – Dibër, e cila lidhte bregdetin me vise të tjera lindore. Relievi përgjithësisht malor kodrinor, por nuk mungon edhe ai fushor në të dyja anët e rrjedhjes së lumit të Drinit të Zi, që favorizon kështu zhvillimin e bujqësisë dhe pemëtarisë. Veç kësaj prezenca e livadheve alpine (zona e Kalasë së Dodës, Radomira), bën mjaft atraktive zhvillimin e blegtorisë.

Ka një hidrografi të pasur me burime mbitokësore dhe nëntokësore ku dega kryesore është Drini i Zi. Të tjera burime të rëndësishme për ekonominë e Dibrës, janë ujërat termale (Llixhat). Përdorimi i tyre edhe për qëllime ngrohje si dhe mundësia e përdorimit të tyre edhe gjatë periudhës së dimrit apo edhe verës, duke vazhduar me gjipsin e vargmalit Deshat – Korab, mermeri në Muhurr, zhvillimi i pyjeve komunal, promovimi i Lurës turistike etj.

Edhe Dibra, si gjithë qarku, pas viteve '90-'92, njohu emigracionin, ku pati një emigrim të madh sidomos nga të rinjtë. Lëvizje demografike ka patur gjithashtu edhe nga zonat e thella malore drejt qytetit të Peshkopisë, veç atyre drejt zonave urbane të Tiranës dhe Durrësit kryesisht. Projekte të mëdha të ndërmarra në këtë rajon gjatë viteve të kaluara përmendim rehabilitimin e ujësjellësit të qytetit Kala e Dodës-Peshkopi me vlerë 900 mijë dollarë, sistemim-asfaltimin e segmentit të rrugës nacionale Peshkopi-Kukës, Peshkopi-Kastriot, Maqellarë-Herebel etj. Po kështu një investim i rëndësishëm ka nisur aktualisht edhe për rikonstruksionin e rrjetit të ujësjellësit të qytetit të Peshkopisë, me vlerë 4.2 milion euro.

SFIDAT KRYESORE

Ndër problematikat e kësaj zone mbetet ajo e papunësisë që shkon në rreth 45 për qind të fuqisë punëtore të aftë për punë, po të kemi parasysh këtu edhe trendin e kohëve të fundit të kthimit të emigrantëve. Ndër sfidat me të cilat do të përballet bashkia e re, të cilat do të ndikojnë edhe në zbutjen e shifrave të punësimit, veçojmë sistemim-asfaltimin e rrugëve rurale që lidhin komunat me qendrën e bashkisë, menaxhimin e mbetjeve urbane, sistemimin e kanaleve të ujrave të zeza, si dhe sistemin e furnizimit me ujë të fshatrave, ku mjaft prej tyre vuajnë ndër vite mungesën e ujit të pijshëm dhe menaxhimi i këtij sistemi. Fermerët si e vetmja mundësi punësimi, që gjeneron të ardhura, është lënë totalisht në harresë, fshatra të shumta me toka mjaft prodhuese dhe me sipërfaqe të mëdha u mungojnë kanalet vaditëse. Fusha e Maqellarës vuan mungesën totale të ujit vaditës. Ndërkohë, një tjetër problem për fermerët mbetet edhe ai i mbështetjes me investime për zhvillimin e frutikulturës, ku Dibra është e përmendur me mollën, kumbullën, dardhën etj, duke vënë kështu në funksion edhe zhvillimin e industrisë agro-ushqimore. Një tjetër problem që Dibrës i ka mungur prej dekadash është nxitja e promovimi i turizmit malor, me Lurën dhe Korabin, që mbartin resurse turistike të veçanta, që jo vetëm duhen nxitur e promovuar, por edhe vënë në eficencë shfrytëzimi, si burime të rëndësishme për rritjen ekonomike.

kandidatët

Zgjedhjet vendore 2015
Një profil i kandidatëve në qarkun e Dibrës

Ja kush janë **kandidatët për** katër **bashkitë**

DIBËR: GARË E FORTË PËR BASHKINË MË TË MADHE TË QARKUT



ILIR KROSI është kandidati i PD për bashkinë e Dibrës. Krosi, 47 vjeç, është nga Gjorica. Është diplomuar për inxhinieri ndërtimi dhe ka studiuar edhe për juridik. Ka qenë oficer i Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë Dibër si dhe inxhinier pranë disa organizatave të huaja deri në vitin 2001. Më pas ka punuar si përgjegjës i urbanistikës pranë këshillit të rrethit, deri ditën kur mori mandatin e parë si kryebashkiak i qytetit të Peshkopisë në tetor 2003. Prej atëherë ka drejtuar tre mandate rresht bashkinë e Peshkopisë dhe ky është mandati i katërt i tij, në qoftë se do të zgjidhet. Ka një përvojë shkëmbimesh dhe specializimesh në vende të ndryshme të Europës e SHBA, si Danimarkë, Holandë, Poloni, Angli, Spanjë, Itali, Bruksel, Hungari, Francë, Kroaci, etj.

Avantazhet: Ka një përvojë të gjatë në qeverisjen lokale. Njeh në imtësi hallet dhe shqetësimet e banorëve të këtij qyteti. Ashtu si lideri i kësaj partie premton se të parët do të jenë qytetarët, duke synuar kështu një pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në vendimmarrje. Ka një komunikim të mirë me qytetarët, pavarësisht se cilës forcë politike i përkasin. Vendimet e fundit të qeverisë për pagesat e faturave të prapambetura kanë penalizuar shumë qytetarë të zakonshëm, kështu që mund të ketë një rritje të votave për PD. Gjithashtu, nga zgjedhjet e kaluara, kjo parti ka një epërsi të dukshme të votave ndaj të majtës.

Disavantazhet: Bashkia e Peshkopisë ka pësuar një regres vitet e fundit, përsa i përket infrastukturës. Ndërtimet pa kriter dhe kaotike kanë sjellë një imazh jo të mirë të qytetit. Ky është konkurrimi për mandatin e katërt dhe mund të ketë pasoja në imazhin e tij në pjesën tjetër të Dibrës. Mbi të, Inspektoriati i Kontrollit të Pasurive ka ngritur një akuzë. Gjithashtu, PD pati një "luftë" të brendshme të fortë mes grupeve brenda partisë për të nxjerrë secili kandidatin e tij.



SHUKRI XHELILI, 54 vjeç, është kandidati i PS. Ai ka mbaruar studimet në Fakultetin Ekonomik të Tiranës dhe ka punuar në ofiçinën mekanike dhe Frigoriferin Peshkopi. Pas viteve 1993 ka qenë për tre vite si specialist pranë agjencisë Kombëtare të Privatizimit, Dega Dibër. Pas vitit 1996 është marrë me biznes privat dhe shumë njerëz tani e njohin si kandidat që vjen nga fusha e biznesit. Aktualisht është sekretar i Partisë Socialiste në Dibër.

Avantazhet: Njerëzit që e njohin thonë se zotëron aftësi të mira menaxheriale, organizuese dhe komunikuese. Ka përballë një kandidat që konsiderohet prej të matjes si i konsumuar në pushtetin lokal, por për sa kohë edhe këto zgjedhje janë politike, ky konstatim mund të jetë i gabuar. Gëzon mbështetjen e deputetit të PS, Ulsi Manja, dhe të tjerëve deputetë të PS në Tiranës, mes të cilëve edhe një ndër deputetët më të pasur të parlamentit, Sadri Abazi.

Disavantazhet: Strukturat e Partisë Socialiste janë "jashtë" funksionit për momentin. Disa prej organizatave janë të pakënaqura me mënyrën se si PS e ka administruar pushtetin në këto dy vjet qeverisje. Gjithashtu, shpesh herë, strukturat shtetërore janë treguar arrogante me njerëzit e zakonshëm, sidomos me familjet e varfra që nuk kanë pasur mundësi ta paguajnë energjinë.

BULQIZË: "LUFTA" PËR QYTETIN E KROMIT



MELAIM DAMZI, 47 vjeç, është kandidati i së majtës, i cili vjen nga radhët e LSI, që premton të "zbardhë" Bulqizën. Ai ka kryer shkollën e tetëvjeçare dhe të mesme në qytet. Është diplomuar për mjekësi të përgjithshme dhe në vitin 1991 ka filluar punë për herë të parë në Bulqizë. Më pas, pas specializimit për kirurgji të përgjithshme, ka qenë mjek në spitalin rajonal të Peshkopisë, deri drejtor i saj. Aktualisht është Prefekt i Qarkut të Dibrës. Ka qenë kryetar i Partisë Socialiste për Dibrën por u shkëput prej sa në vitin 2011, duke kaluar te LSI.

Avantazhet: Ka lidhje të veçanta me rrethin e Bulqizës që në rininë e tij të hershme. Ka qenë banor i këtij qyteti, ku prej kohësh punonin dhe banoni vëllezërit e tij më të mëdhenj. Njohjet dhe lidhjet e tij me banorët e qyteti të minatorëve janë të vjetra e të shumëllojta, me të gjitha zona dhe shtresat e sociale. Aty më vonë ka filluar edhe profesionin e mjekut ku ka lënë mbresa të veçanta dhe ka kultivuar ndjenjë të fortë mirësie e respekti ndër të gjithë qytetarët. Si kirurg në spitalin e Bulqizës ka shërbyer dhe ka punuar pareshtur, në përmirësimin e shërbimit të urgjencës së kirurgjisë. Gëzon mbështetjen e plotë të dy deputetëve të Dibrës, Canit dhe Spahiut, të cilët do ti japin nesër në krye të bashkisë një mbështetje të madhe. Një mbështetje te banorët e ka marrë që tani, me premtimet e qeverisë për vazhdimin e punimeve në Rrugën e Arbrit.

Disavantazhet: LSI do ta zgjidhte kandidatin e Bulqizës dhe disa eksponentë të saj transferuan gjendjen civile për të qenë e mundur që të ishin kandidatë, por Damzi ishte kandidatura surprizë e koalicionit të majtë. Disa struktura të PS tentuan të protestojnë kundër kandidatit, por ato u tërhoqën. "Për të arritur fitoren, ne do të kemi nevojë mbi të gjitha për mbështetje dhe bashkëpunim reciprok", shtriu ai dorën e bashkëpunimit për kundërshtarët brenda koalicionit.



DURIM BALLA është kandidati i PD. Ai vjen nga një shtresë e persekutuar në regjimin komunist. Ka qenë kryetar i komunës së Zerqanit dhe aktualisht ka qenë kryetar i Partisë Demokratike. Më parë ka kryer edhe detyrën e drejtorit rajonal të rrugëve në Dibër. Është zgjedhur në krye të PD me një mbështetje të madhe nga baza e partisë. Në qoftë se do të zgjidhjet kryetar i bashkisë, ai premton se do të jetë non stop në shërbim të qytetarëve dhe se telefoni i tij do të jetë gjithmonë i hapur.

Avantazhet: Balla gëzon një mbështetje të madhe në strukturat e partisë. Është zgjedhur në krye të PD me një diferencë të madhe votash me kundërshtarët. Është i komunikueshëm dhe bindës. Me zgjerimin e bashkisë ka mundësi të rrisë mbështetjen e votuesve.

Disavantazhet: Ishte kandidati i fundit i zgjedhur nga Partia Demokratike, dhe kjo për shkak të një gare të fortë brenda partisë. Kjo garë e gjatë mund t'i ketë sjellë një humbje votash nga e djathta, sidomos në Shupenzë.

Shënim i redaksisë: Për përgatitjen e profileve të kandidatëve ndihmuan bashkëpunëtorët e gazetës: Hysen Likdisha, Faik Xhani, Hasan Pasha si dhe u përdorën materiale të sjella nga menaxherët e faqeve në FB të kandidatëve.
Redaksia vendos në dispozicion të kandidatëve një faqe për numrin e ardhshëm, ku kandidatët mund të shpalosin platformat e tyre elektorale.

BASHKIA MAT: GARA ËSHTË E HAPUR



ADELINA FARRIÇI, 47 vjeç, është kandidatja e PS për Matin dhe kërkon mandatin e dytë të saj. Ka mbaruar Fakultetin e Shkencave të Natyrës, dega Fizikë dhe është master në menaxhim - profili lidership. Ka punuar si mësuese në disa shkolla në qytetin e Burrelit si dhe ka drejtuar disa kohë fakultetin e edukimit në Universitetin "Nëna Geraldinë", aktualisht i mbyllur. Që prej vitit 2011 është kryetare e bashkisë së Burrelit. Konsiderohet si favorite në zgjedhje, pasi mandatin e parë të saj ka pasur suksese. Pothuajse ambasadorët më të rëndësishëm në Tiranë, kanë kaluar njëherë nga zyra e saj.

Avantazhet: Është energjike, punon shumë dhe ka një komunikim të mirë me njerëzit. Në statuset e saj në FB ulet "gju më gju" me populin. Konsiderohet një nga kryetarët e bashkisë më të suksesshme. Dy vitet e fundit, Bashkia e Burrelit ka fituar disa projekte, kryesisht për të ndikuar në imazhin e ndryshimit të qytetit.

Disavantazhet: Bashkia e Matit tani bashkohet edhe me shtatë njësi të tjera të qeverisjes vendore dhe kështu që nga pikëpamja politike ndryshojnë raportet e votuesve. Gjithashtu, ajo do ta ketë të vështirë t'u mbushë mendjen për të votuar për të votuesve burra nga fshatrat në periferi të bashkisë së re.



NEZIR RIZVANI, 49 vjeç, është kandidati i PD për bashkinë e Matit. Ka studiuar në Fakultetin Ekonomik të Tiranës dhe ka punuar si ekonomist në industri në vitet 1984-1988. Më pas ka punuar në minierën e kromit në Batër dhe në uzinën e Ferrokromit në Burrel. Sot është kontabël i miratuar. Ka qenë aktivist i Partisë Demokratike që në themelimin saj dhe aktualisht ka qenë sekretar i PD në Burrel.

Avantazhet: Gëzon një reputacion të mirë mes qytetarëve. Ka arritur të marrë një konsensus brenda Partisë për kandidimin dhe shpreson shumë se Burreli do të kthehet djathtas me kandidimin e tij. Shumë mbështetës të tij mendojnë se për shkak të profesionit do të jetë një menaxher i mirë për bashkinë e Burrelit.

Disavantazhet: Bashkia e Matit tashmë ka një shtrirje të gjerë gjeografike. Kandidatja aktuale në Burrel gëzon një mbështetje të qeverisë qendrore, dhe njerëzit në zgjedhjet e para besojnë se ajo mund ta ruajë këtë mbështetje.

KLOS, BASHKIA QË DO KTHEHET NË NJË LAGJE TË TIRANËS



VALBONA KOLA, kandidatja e koalicionit të majtë, është mjeke në qendrën shëndetësore Klos. Ka mbaruar Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë dhe prej vitit 1990 ka punuar si mjeke pranë bashkisë Klos dhe Qendrës Shëndetësore. Gjatë viteve 2006-2010 ka drejtuar këtë qendër. Nuk ka qenë anëtare partie dhe ishte një nga kandidaturat surprizë të PS në këto zgjedhje.

Avantazhet: Si mjeke ka hyrë në shumë familje dhe mund të ketë ndikimin e saj pozitiv në zgjedhje. Premton hapje të bashkisë drejt shtresave në nevojë si dhe një komunikim dhe gjithpërfshirje të qytetarëve në vendimmarrje. Bashkia Klos, me ndërtimin e Rrugës së Arbrit do të identifikohet si një lagje e Tiranës, dhe jo si pjesë e Matit. Në këtë kuptim, në qoftë se qeveria do të bëjë hapa seriozë në drejtim të fillimit të punimeve të rrugës, mund të ketë edhe përfitime elektorale.

Disavantazhet: Duke qenë jashtë strukturave të partisë nuk njeh sa duhet bazën e partisë. Si mjeke, njerëzit mendojnë se do ta ketë të vështirë të administrojë Bashkinë e Klosit, pasi nuk do tu bëjë dot ballë presioneve partiake.



BASIR ÇUPA, 49, vjeç, synon që të marrë bashkinë e Klosit në emër të koalicionit të djathtë. Ka mbaruar Fakultetin Ekonomik dhe ka punuar në ndërmarrjen tregëtare Klos, nënkryetar i Bashkisë Klos, drejtor i rrugëve kombëtare Mat, drejtor i filialit të postës Mat, kryetar i Këshillit Bashkiak të Klosit.

Avantazhet: Duke punuar prej shumë kohësh në disa pozicione pune shtetërore ka krijuar një komunikim të mirë me qytetarët. Ka aftësi organizuese dhe menaxhuese dhe është i komunikueshëm. Përvoja si nënkryetar i bashkisë, mund ta ndihmojë të përgatisë një program elektoral të pëlqyeshëm për votuesit.

Disavantazhet: Kandidatja kundërshtare vjen nga shoqëria civile. Ajo, për shkak të lidhjeve familjare mund ti sigurojë një rrjedhjeje të votave nga PD. Fillimi i punimeve në rrugën e Arbrit mund ta dëmtojë, sidomos në fshatin e tij, nga ku kalon edhe rruga.

Përgatiti: **BUJAR KAROSHI**

Eja në Botën e Ngjyrave
"ZAYA STUDIO"
nën kujdesin e piktorit Zaim Elezi, me një eksperiencë të madhe në këtë fushë
ORGANIZON KURSE PËR TË GJITHA MOSHAT
Së bashku ne mund:
- Të mësojmë të vizatojmë
- Të mësojmë të pikturojmë
- Të mësojmë gjithçka rreth artit figurativ
Adresa: **Rr. "Zenel Baboçi", pall. Ferar.** ***Tel:*** **068 22 46 400**

Bulqiza, aty ku fëmijët punojnë krah të rriturve në galeritë e nëntokës

Në vend të librave nxjerrin **krom për bukën e gojës**



Nga **EVA GJURA**

Të gjithë kanë dëgjuar për qytetin verilindor të Bulqizës, apo të njohur ndryshe si "qyteti i thesarit". Qytet që prodhon mijëra ton krom dhe pasuron gjysmën e botës, por që në fakt vetë po shuhet dhe rrënohet çdo ditë dhe më shumë, po e mbyt pak nga pak varfëria ekstreme. Varfëri, e cila ndihet thellë sapo hyn në territorin e tij. Sa hyn në zonën e njohur si Qafa Buallit hasësh me një panoramë që për ndonjërin mund të duket e bukur, por në fakt është një "bukuri që vret". Qëllimi i udhëtimit ishte takimi me disa nga të rinj, jeta e të cilëve është e lidhur ngushtë me minierën.

Qyteti i Bulqizës prodhon mijëra ton krom dhe pasuron gjysmën e botës, por që në fakt vetë po shuhet dhe rrënohet çdo ditë dhe më shumë, po e mbyt pak nga pak varfëria ekstreme. Varfëri, e cila ndihet thellë sapo hyn në territorin e tij.

TAKIMI ME TË RINJTË

Hyjmë në Bulqizë rreth mesditës, në qytetin e ftohtë jo nga mikpritja e njerëzve, por nga moti dhe ajo pamje e zymtë që na rrethonte rreth e rrotull. Ashtu siç e kishim llogaritur, biseda e parë ishte me disa djem që sapo kishin mbaruar gjimnazin, dy prej tyre punonin në minierë. Takuam Blerimin, djalin që mbante një emër shqiptar, por edhe Klintonin, një 19 vjeçar, i cili mban emrin e një burri shteti në SHBA, ish-presidentit, i cili ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për luftën e Kosovës, dhe shqiptarët ndoshta ndaj e duan aq shumë, sa iu kanë vënë edhe emrat fëmijëve të tyre. Me dy të rinjtë nuk arritëm të rrinim gjatë, pasi ashtu siç na thanë, nxitonin për të shkuar në punë. Në orën 13:00 ata merrnin turnin e punës, do të hynin në minierë. Në atë gropë të zezë që ju merr atyre orë të tëra të jetës së tyre. Në ato pak minuta që qëndruam me ta, nxituam t'i pyesnim për të mësuar disa gjëra konkrete. Sa orë punonin, a ishin të siguruar, me sa turne e kishin punën, çfarë privilegjesh kishin, a i kishin të gjitha kushtet në punë, sidomos ato të sigurisë teknike, që janë më të rëndësishmet, pasi vihet në pikëpyetje jeta e tyre.

Ashtu siç na kishin thënë edhe të tjerë, djemtë hezitonin të përgjigjeshin për shumë pyetje. Kanë frikë se mos bie ndonjë fjalë në vesh të pronarit dhe i heqin nga puna. Për rrogën të dy njëzëri shprehen se, "është e mirë, nëse e llogarit me ata që s'kanë fare", ndërsa me sasinë e punës që bëjnë nuk shpërblehen as sa gjysma e minatorëve në Gjermani e vende të tjera, megjithëse si kohë pune punojnë më shume sesa ata. Paga që marrin është rreth 600 mijë lekë të vjetra, gjysmën e saj e marrin në bankë dhe për këtë ju paguhen edhe siguracionet, ndërsa gjysma tjetër merret në dorë, pasi kompania nuk iu paguan sigurime për rrogë të plotë.

"Nuk i leverdis pronarit të paguaje sigurime për rrogë të plotë", shprehen djemtë ndaj paguan vetëm për gjysmën e pagës, duke i paguar kështu shtetit vetëm një pjesë minimale të kontributeve, që këtu, shprehen ata, nis vjedhja e parë zyrtare. Sipas djemve, kjo për ta është gjë e mirë, pasi ka punonjës që nuk janë fare të siguruar, punojnë në të zezë dhe nëse ju ndodh diçka nuk ju njeh askush asgjë. Për shtetin, këta 'uritha', siç e thërrasin njëri-tjetrin me shaka, nuk ekzistojnë.

TURNET E PUNËS DHE GALERIA

Orari i punës është nga 8 orë dhe djemtë, të cilët punojnë në kompani private, e ndiejnë veten të privilegjuar, sepse punojnë vetëm dy turne, turni i parë që nis në 6 të mëngjesit dhe turni i dytë që nis në 2 të drekës dhe mbaron në 9 të mbrëmjes. Ata ndihen të lumtur se nuk kanë turne të treta, ashtu siç ndodh me minatorët që punojnë në galeritë shtetërore. Kur ju përmend galerinë e errët, ulin sytë në tokë dhe nuk ndihen fare mirë. "Nuk na pëlqen fare, po ç'të bëjmë.

Këtu përveç minierës dhe punës në fushë nuk ka asnjë mundësi tjetër pune. Puna në bujqësi është e kufizuar për shkak të tokës së pakët dhe në pjesën më të madhe të vitit ka borë dhe temperaturat e ulta s'të lënë të bësh ndonjë gjë të madhe, kështu që shpresa e vetme mbetet miniera, sytë andej i kemi", shprehen djemtë. Megjithëse të rinj fare ne moshë 19-20 vjeç flasin si burra të moçëm, me një mal hallesh në kurriz. Shkarazi, pasi nuk duan të ndalen shumë në atë pikë, të përmendin faktin se ata punojnë shumë bashkë me minatorët e tjerë, nxirret shumë krom, por vidhet shumë.

"Këtu tashme është ngritur një mafie, nuk merret vesh se çfarë ndodh, më mirë bëj punën tënde, merr ato lek dhe ik mos u ndiej, se nuk dihet se çfarë ndodh", të thonë me gjysmë zëri. Në të vërtetë ashtu është në "qytetin e arit" shumë gjëra kane ndodhur këto 23 vite, por asgjë nuk ka ndodhur për mirë dhe që t'ju shërbejë banorëve të këtyre zonave. I bindur në atë që thotë, Blerimi shprehet se, "nëse vetëm një kamion krom po të ishte shkarkuar në ditë për Bulqizën, vetëm një, kush e di si do ishte bërë sot ky vend, ndoshta Zvicër e dytë"', megjithëse ai vetë se ka parë kurrë këtë shtet, për të cilin thotë se është shumë i bukur, megjithëse i ftohtë dhe me borë shumë, ashtu si vendi i tyre.

"Miniera është një gropë e zezë, ha koka djemsh herë pas here sidomos të të rinjve, që nuk kanë shumë eksperiencë dhe bëjnë gabime fillestare, të cilat ju kushtojnë shumë rëndë deri edhe jetën e tyre", deklarojnë djemtë të shqetësuar. "Nuk do të punonim kurrë në miniere, por vete e kemi fajin, nuk mësuam shumë në shkollë, që të merrni ndonjë drejtim tjetër, tani mirë të na bëhet të shtyjmë jetën në ato puse të errëta', thonë ata, megjithë kurajën që ne ju japim duke ju thënë se jeni ende të rinj dhe e keni jetën para për të ndjekur shkollën apo ndonjë profesion tjetër. Kjo për ta tashmë duket një ëndërr e largët, nuk kanë shumë dëshirë të shkojnë në shkollë apo të ndjekin kurse për zanate të tjera.

TË BURRËROHESH PARA KOHE

Kjo shprehje mund t'ju duket paksa pa kuptim , por kuptimin e plotë e merr kur takon Endrin, një djalë 13 vjeçar, që mban një emër të bukur, por që emri e humbet krejtësisht kuptimin kur ti e shikon se çfarë pune po bën dhe sesa e rëndë është jeta e tij. Endrin e gjejmë tek pirgu i madh e gurëve të kromit, aty ku bashkë me të ndodhen edhe shumë fëmijë të tjerë të moshave të ndryshme, gra , vajza, pleq e plaka, të cilët nuk lejohen të hyjnë e të punojnë në galeritë e minierës, por ata ju bëjnë karshillëk tuneleve të errëta duke gërmuar në pirgjet e mëdha të gurëve të kromit, për të fituar një grusht me para.

Ndalemi të bisedojmë pak me Endrin, megjithëse duket se është fjalëpak, por kjo nuk e pengon aspak atë të na hedhë një vështrim të ftohtë nga koka tek këmbët, sikur donte të na lexonte çdo mendim tonin.

E pyesim sa vjeç është dhe pse nuk ka vajtur në shkollë, sepse në atë orë, rreth 12:30, ai duhet të ishte ende në mësim. Prerazi na e kthen se nuk ka shkuar në shkollë. E pyesim: Pse? Endri na hedh edhe një vështrim tjetër, por këtë herë therës, sikur donte të na thoshte se nëse doni të talleni shkoni diku tjetër. Pa dashur ta mërzisnim më shumë i kërkojmë të ulet dhe të pushojë pak me në. Nuk bën zë, ulet dhe na ndiqte me sytë mendueshëm çdo lëvizje që bënim.

Unë për të hyrë në bisedë i them se kam një djalë gati në moshë të tij. E pyes sa fëmijë janë në shtëpi dhe me kë jeton.

Ashtu i qetë me përgjigjet se janë tre fëmijë, dy vëllezër dhe një motër, të cilët janë më të vegjël se ai. Babai punonte në minierë, por konsumonte shumë alkool duke jua bërë edhe më të vështirë jetën, ndërsa nëna përpiqej të punonte ku të mundte për të siguruar edhe ajo ndonjë lek megjithëse ishte e sëmurë.

Endri na tha se nuk shkonte rregullisht në shkollë, sepse duhej të punonte për të siguruar ndonjë lek. Shtëpia e tyre është e varfër dhe ka nevojë për shumë gjëra, por më shumë kanë nevojë për bukë. Dua të ndihmoj mamin, e cila lodhet shumë, kur të rritem dua të iki që këtu, por mamin do ta marr me vete, thotë 13 vjeçari, duke lënë të kuptohej se për të atin nuk shqetësohej shumë...

Endri punonte në pirgun e gurëve të kromit gati 4-5 orë në ditë dhe kishte raste kur fitonte edhe 10 mijë lekë të vjetra në ditë. Ai na tha se jo gjithmonë arrin të gjesh krom aq sa duhet, ka shumë punëtore këtu dhe nuk ka shumë gurë kromi. Ai 13 vjeçar është bërë një mjeshtër në njohjen e gurit të kromit, e dallon më të parën dhe nuk lodhet kot duke mbledhur gurë që nuk i duhen.

"Në fillim nuk e njihja kromin dhe lodhesha duke mbushur kovat me gurë që nuk ishin krom, tani e kam më të thjeshtë e di cili është guri i çmuar dhe kush më bën punë mua', na thotë Endri.

Largohemi prej tij, pa ditur se çfarë t'i themi, por ai e di se shumë si ne do të shkojnë e do ta takojnë, do ikin të mbushur me dhimbje dhe dhembshuri prej tij dhe shokëve të tij, por asnjëri nuk do t'i japë fund dhimbjes së tij.

INSTITUCIONET SHTETËRORE

Pas bisedës me Endrin kërkojmë të takojmë ndonjë zyrtarë të lartë të qytetit. Trokasim në dyert e bashkisë, por kryetari i bashkisë, z. Myfit Duriçi, nuk ndodhej aty. Ai ishte me shërbim në kryeqytet dhe askush nga vartësit e tij nuk pranonte të bisedonte me ne. Kërkonim një informacion zyrtar, sesa fëmijë nuk e frekuentojnë rregullisht shkollën dhe a ka bashkia informacion për ata të rinj apo punëtorë që punojnë në galeritë e minierës dhe nuk janë të siguruar?

Çfarë masash merr shteti për të luftuar informalitetin në këtë qytet, por askush nuk na tha asgjë. Të gjithë largoheshin dhe mjaftoheshin më frazën "kryetari nuk është këtu. Hajdeni nesër kur ai të kthehet në zyrë".

Largohemi, por do të kthehemi sërish për të marrë informacionin që donim.

Njoftim

Në shkollën tuaj keni një talent që duhet promovuar, në lagjen tuaj keni një artist që duhet prezantuar, një artizan duarart, një mjek të aftë, një bujk punëtor, një qytetar shembullor... Pranë jush gjendet dikush që e meriton që shembulli dhe puna e tij të bëhet e njohur... Na shkruani në adresën e emailit ose na ndiqni përmes faqes në FB "Rruga e Arbërit" dhe një gazetar i yni do të vijë pranë jush... Mos ngurro! Gjithmonë ka gjëra të mira pranë jush që duhen vlerësuar! shkruaj email: <rrugaearberit@gmail.com>

cyan magenta yelloë black

intervistë

Intervista me Dhurata Thanasi Danerin është realizuar në kuadër të bashkëpunimit të gazetës "Rruga e Arbërit" me faqen sociale në FB "Peshkopi,Dibër,Albania". Ajo do botohet edhe në faqen në internet http: peshkopidiberalbania.wix.com. Bashkëpunimi synon të bëjë publike me anë të intervistave sukseset e dibranëve dhe miqve të Dibrës në fusha të ndryshme të jetës.

Nga gatimet **dibrane**

"nuk di kë të zësh e kë të lësh"

Nga **SASHENKA NDREKA**

Dhurata Thanasi Daneri punon si Manaxhere e Zhvillimit të Biznesit pranë Fondacionit Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale (ALCDF). Ka punuar për vite me radhë në shumë vende si Ballkan, Europe, Azi, Afrikë, SHBA. Eksperienca dhe dëshira e saj për artin kulinar janë të lidhur dhe me udhëtimet dhe kërkimet e shumta të saj në këtë drejtim. Vitet e fundit fotografia ka zënë një vend të rëndësishëm në ditën e saj. Si një fanse besnike e Dibrës nuk kishte si t'i mungonte rubrikës sonë të intervistave. Një rrëfim krejt i thjeshtë e origjinal i një "tironceje" që kurrsesi nuk do të dilte jashtë kornizave të miqësisë së hershme mes Dibrës dhe Tiranës.

-Si ka evoluar interesi juaj nga menaxhimi i biznesit pranë ALCDF në pasionin për gatim e deri tek fotografia?

Interesi im mbi ushqimin në përgjithësi dhe gatimin në veçanti, nuk ka ardhur rishtas. Ai lind që në vogëlinë time, atëherë kur shihja time gjyshe të "tëhollte" petët e yshmerit apo kur gatuante reçelin e luledredhëza në Llogara, kur shkonim me pushime. ALCDF-ja më mundësoi, si menaxhere biznesi, të lëviz dhe të njoh më shumë atë pjesë të atdheut tim, të cilën nuk e kisha njohur më parë. Për sa i përket fotografisë, unë vij natyrë kurioze, ndoshta më shumë seç duhet, edhe pse e fsheh mirë, dhe fotografët më të mirë pikësëpari duhet të shtyhen nga kurioziteti, më pas nga talenti dhe puna. Unë shkallën e parë e kam arritur. Për dy të tjerat më duhet ende shumë punë.

- Shpesh vihet në pikëpyetje, për gratë në veçanti, arritja e balancës mes karrierës, interesave personale dhe familjes. Si grua e suksesshme me shumë pasione dhe nënë, ç'qëndrim keni ndaj këtyre pikëpyetjeve?

Do ta nis përgjigjen nga fundi. Unë nuk jam aspak grua e suksesshme! Jam një femër që mundohet e përpiqet çdo ditë të realizojë ato dëshira e pasione, që i vë dita-ditës vetes. Nuk jam skllave e një pikësynimi "karriere të lartë". Jam dashëse e arritjeve të vogla të dita-ditës.

- Nga udhëtimet e shumta tuajat, cili ju ka lënë më shumë përshtypje respektivisht në menaxhim, gatim dhe në fotografi?

Fati im më i madh në jetën time, përveç familjes sime, janë udhëtimet, shumica e të cilave janë bërë kur më është dashur të punoj dhe njoh njerëzit dhe terrenin. Puna më ka ndihmuar të njoh vende dhe njerëzit, dhe me njerëzit më është dashur dhe të "ha e pi", siç themi ne. Kështu që trinomi: menaxhim, gatim dhe fotografi kanë ecur tok.

- Ju keni vizituar shpesh edhe Dibrën. Ç'vend zë ajo në librin tuaj të përshtypjeve?

Për herë të parë krahinën e Dibrës e kam vizituar në Nëntor të 2010-ës, e shoqëruar nga kolegu im i zyrës, dibran, z. Besnik Alku. Dhe sigurisht kur ke një "guidë turistike" si Besniku, që adhuron historinë e krahinës së tij, nuk ke si mos të mrekullohesh. Gjithsesi, sapo i jam afruar Dobrovës, dhe duke mos marrë parasysh ndërtimet pa kriter, Peshkopia më është dukur si ndonjë nga qytezat e Trentinos së Italisë së Veriut, aq përshtypje të fortë më ka lënë bukuria e zonës. Dibrën e dua shumë si krahinë e mbi të gjitha dibranët. Janë populli më punëtor që kam njohur, fjalëpakë, shumë reflektues e mbi të gjitha bujarë.



- Cila është fotografia më e bukur që keni shkrepur në Dibër? Ç'ka arritur të ngrijë ajo në një pamje?

Kur shkoj me shërbim punë, kudoqoftë, zgjohem herët dhe dal nëpër rrugët e qytetit atëherë kur ai është ende bosh. Më pëlqen ta shoh qytetin "ende në gjumë". Këtë bëj dhe në Peshkopi. Humbas kalldrëmeve të Dublecit (aty ku akoma janë) dhe fotografoj shtëpitë e vjetra e sidomos dyert e drunjta.

- Ju keni riprodhuar me shumë fantazi disa nga gatimet tipike dibrane, qoftë duke i qëndruar strikt recetës, por edhe duke e reformuar recetën në mënyrën siç ju e quani "recetat e gjyshërve me metodat e nipërve". Cila është pjata juaj e preferuar ndër to?

Nga pjatat dhe gatimet dibrane "nuk di kë të zësh e kë të lësh", që nga *Pula me jufka* apo *Qeshqeku*, *Kulloshtra e pjekur* apo *Pula në qull*. Unë kam shumë dëshirë jufkat tuaja të gatuara thjeshtë me djathë Mishavinë të Lepushës së Kelmendit dhe aromatizuar me pak lisna të luginës së Drinit. Im bir "vdes fare!"

-Si mund të klasifikohet kuzhina shqiptare në "hartën" e kulinarisë botërore. Po Dibra në atë të Shqipërisë?

Kuzhina shqiptare është një kuzhinë e ndikuar masivisht nga ajo turko-otomane, falë jetesës pesë shekullore nën perandori. Ajo mund të klasifikohet si një kuzhinë që sjell gatime nga tre zona kryesore ku Shqipëria shtrihet, kontinentale fushore, kontinentale malore dhe mesdhetare bregdetare. Unë kam bërë një studim timin, gati 5 vjeçar mbi kuzhinën shqiptare dhe atë ballkanase dhe Dibrën e kam futur në rajonin e Shqipërisë Lindore (së bashku me Klosin, Bulqizën, Matin, Maqellarën). Harta kulinare shqiptare është një ndarje e bazuar mbi gatimet, ushqimet dhe produktet territoriale, që shqiptarët kanë ngrënë dhe prodhuar ndër gjenerata duke sjellë një dëshmi kulinare, të cilën populli ynë e ka trashëguar deri ne ditët e sotme. Kjo hartë kulinare është bazuar në elementët historikë, gjeografikë dhe fetarë dhe grupimi i pjatave dhe gatimeve është mbështetur dhe në një aferi territoriale e krahinore, lidhur nga kodet zakonore, kostumet, veshjet, këngët, vallet, prodhimet e tokës dhe begatia e natyrës.

-Sa e rëndësishme është kulinaria në personalitetin e përgjithshëm të shqiptarëve? A dinë shqiptarët e bëjnë art me ushqimin apo janë thjesht konsumatorë?

Cila është receta, fotografia dhe kënga që do t'i shkonte kësaj interviste?
Një "cop Gilaç n'xhalp (gjylaç) e shoçrume me long thanash" e ulur në një prag porte të drunjtë të një shtëpie të gurtë në Rabdisht, nën zërin e Liri Rashës që këndon "Oh moj fusha e Korabit".



... që nga pula me jufka apo qeshqeku, kulloshtra e pjekur apo pula në qull. Unë kam shumë dëshirë jufkat tuaja të gatuara thjeshtë me djathë Mishavinë të Lepushës së Kelmendit dhe aromatizuar me pak lisna të luginës së Drinit. Im bir "vdes fare!"



Shprehja më e bukur dhe bazike e shqiptarëve është "*Bukë e kripë e zemër*". A ka diçka më të rëndësishme se buka dhe ushqimi për ne shqiptarët? A ka shprehje me sublime për mikpritjen e mikut? Për shqiptarët, sigurimi i ushqimit për mikun dhe fëmijët kanë qenë dhe mbeten meraku kryesor. Shqiptarët dinë të bëjnë art me mikpritjen e tyre të pashoqe dhe një shembull i vyer jeni ju, populli dibran, por ata e bëjnë artin jetëmot në sofrat e shtruara me byrekët, tavat e kosit, qengjin e pjekur ngadalë në lëkurë, sheqerpareve dhe shëndetlijave me mjaltë, pashaqofteve dhe fërgesës në tavë dheu apo hasudeve dhe rakisë së manaferrës "me nam".

-A e kanë dëmtuar menynë apo listën e gatimeve tona kuzhinat e tjera fqinje?

Unë jam e mendimit që, nëse nuk futen inatet, qejfprishjet apo shovinizmat nacionalistë, 'kojshijtë' apo 'gjitonët' të pasurojnë marrëdhënien, zgjerojnë "vajtje-ardhjen" e si pasojë, hapin njohuritë, pasurojnë shpirtërisht dhe financiarisht. Ju dibranët keni përvojë, pasi nga ju kalonin dhe kryqëzoheshin shumë rrugë. Dhe jeni tregtarë të mirë, punëtorë dhe largpamës. Vërtetë sheqerparja, thonë është ëmbëlsirë me prejardhje turke, por kush ma kundërshton faktin që dibranët që punonin nën Portën e Madhe të mund ta kenë çuar ata si delikatesë shqiptare. Mua në gjithë librat e historisë e sidomos të historisë së kuzhinës otomane nuk më rezulton ndonjë fakt që e kundërshton këtë tezë.

- Kompozimi i fotove të gatimeve tuaja si dhe teksti që shkon me to ka shumë fantazi dhe origjinalitet. Nga ju burojnë idetë?

Kur gatuaj një pjatë të traditës, p.sh *Tavën e Krapit të Shkodrës*, nuk ekzagjeroj kur ju them se në atë moment jam pranë një akshije Shkodre në një shtëpi tipike shkodrane me tavane druri të gdhendur, nga ato të pikturuara dhe projektuara nga legjendari Kol Hidromeno të ngrohura nga zëri " i amël" i Marije Krajës që këndon jaren "Turtullesh". Vetëm kështu mund të nxjerr nga duart e mia atë gatesë unike dhe vetëm e vetëm kështu më del "nga zemra" fotografia e pjatës. Imagjinoni ta hani *Harapashin* e *Labërisë* nën tingujt e Lady Gaga dhe nën një pjatë të zezë tip japoneze. "Të ngec në fyt" do thoshnin lebërit. Idetë lindin aty ku ka lerë "pjata" dhe rriten me historinë që ajo gatesë ka trashëguar në breza.

- "Revolucioni i ushqimit" quhet nisma ku jeni po ashtu shumë aktive. Ç'përfaqëson për ju ky aktivizim dhe sa i duhet Shqipërisë në veçanti një revolucion në të ushqyer?

Revolucioni i ushqimit është një lëvizje mbarëbotërorë e nisur nga Jamie Oliver, të cilës i jam bashkuar gati 3 vite më parë në mënyrë aktive. Së bashku me një grup miqsh e shokësh, të përbashkuar nga misioni për një jetë më të mirë falë një stili jete dhe të ushqyeri të shëndetshëm. Qëllimi ynë është edukimi mbi mirushqyerjen, sigurinë ushqimore dhe aftësimin në gatim të të gjithë grupmoshave e sidomos fëmijëve dhe të rinjve. Po ashtu jemi të përkushtuar në edukimin e fëmijëve me njohjen e produkteve të tokës, respektin për të, ruajtjen dhe bashkëjetesën në harmoni me natyrën dhe habitatin ku jetojmë. Duke marrë parasysh të gjitha këto, jo vetëm Shqipërisë, por gjithë botës i duhet të përballet me një *revolucion ushqimor*. Në fund të fundit çdo gjë ndodh sot në botë, që nga luftërat e deri tek fatkeqësitë mjedisore, është për shkak të ndarjes së mosbarabartë të pasurive, ku baza janë ushqimi dhe uji.

- Gatimi tradicional shqiptar ka në përgjithësi përmbajtje të lartë kalorish dhe yndyrnash, por është edhe shijeplotë. A mund ta revolucionojmë atë në më të shëndetshëm pa i humbur shijen?

Gjithë kuzhina tradicionale, edhe ajo botërore është fuqidhënëse e plot kalori. Një fshatar rus po mos ta niste ditën me një supë borscht me pak vodka apo një toskan me një panine me lardo (proshutë dhjam) të ngjyer në verë Chianti, nuk e përballonin dot ditën në arat apo kolkozët rusë. Sot nuk mund të hamë me porcionet e 100 viteve më parë dhe më pas të hipim në makinë edhe kur shkojmë për të blerë bukë. Çdo gjë ka ndryshuar! Njerëzit lodhen shumë më pak dhe harxhojnë e konsumojnë shumë e më shumë. Ju doni të thoni nëse sheqerparja "e vdes me" në gjalp të shijon më shumë sesa keku me miell integral dhe fara lini që unë i gatuaj tim biri për mëngjes? Sigurisht që po. Por nëse i jap një porcion të vogël dhe jo çdo ditë dhe pas bëjmë një ecje, tradita shijohet si mos më mirë.

- Cila është receta, fotografia dhe kënga që do t'i shkonte kësaj interviste?

Një "cop Gilaç n'xhalp (gjylaç) e shoçrume me long thanash" e ulur në një prag porte të drunjtë të një shtëpie të gurtë në Rabdisht, nën zërin e Liri Rashës që këndon "*Oh moj fusha e Korabit*".

Rruga e Arbërit nr. 108

aktualitet

Sipas një bisede me ing.Petrit Paçuku, përgjegjës i zyrës së urbanistikës në Dibër të Madhe

Të ndërtojmë të ardhmen duke ruajtur vlerat e së shkuarës

Nga **REXHEP TORTE**

Ing. Petrit Paçuku, përgjegjës i urbanistikës në Dibër, lidhur me të djeshmen dhe të sotmen e arkitekturës dhe të infrastrukturës së Dibrës, thotë se: "Dibra ka një të kaluar historike të bujshme. Pozita e saj gjeografike dhe strategjike i ka mundësuar që të ketë një zhvillim të fuqishëm. Dibra kulmin e këtij zhvillimi ekonomik e kulturor e ka arritur në shekullin e 19-të dhe në fillim të shekullit të 20-të, kur nga viti 1913-1920 u bë shkrumb e hi nga ushtria okupuese serbe.

Në lulëzimin ekonomik dhe kulturor, Dibra kishte një shtrirje administrative gjer në Mat, Strugë e Mavrovë. Në këtë kohë ajo u takonte qyteteve më të zhvilluara të rajonit".



© Foto: Atli Dema

E vetmja shtëpi karakteristike dibrane, e cila e ka ruajtur pamjen e vet është ajo e pronarit Ibrahim Erebara, i cili me mjete të veta dhe me këmbëngulësinë e tij, arriti që ta mirëmbajë dhe ta ruajë bukurinë e kësaj shtëpie, të cilën e vizitojnë edhe shumë turistë.

U HUMBËN SHTËPITË E BUKURA DHE U RUAJTËN ÇEZMAT

Vend me rëndësi zinte ndërtimi arkitektonik, infrastrukturor dhe rrugor, dalloheshin ndërtuesit dibranë të shtëpive karakteristike me kaskada, dritare dhe me një planimetri funksionale. Mjediset e brendshme dalloheshin me dhomat ditore, dhomat e miqve, dhomat e gjumit, çardakët, sergjenët dhe ambientet e gatimit dhe kuzhinës. Këto shtëpi dalloheshin edhe me zbukurimet e tavaneve me punime drugdhendje dhe me relieve të punuara me suvatim.

Infrastruktura rrugore nëpër qytet ka qenë e shtruar me kalldrëme me gurë të punuar dhe të gdhendur me mjeshtri. Ndërkaq, në pjesën periferike rrugët kanë qenë të shtruara me gurë të thyer-makadam. Bukurinë e qytetit e kanë shtuar edhe urat e bukura nëpër disa lagje të qytetit dhe në periferi.

Ndër urat më në zë e më të mëdha janë Ura e Spilës, e ngritur mbi vendin ku bashkoheshin lumenjtë Drini i Zi dhe Radika dhe Ura e Radikës e ngritur mbi lumin Radikë. Këto ura ishin edhe lidhja e Dibrës me botën dhe lidhja me Rrugën Via Egnatia.

Pamja e bukur dhe impozante e këtyre urave, mënyra e përkryer e ndërtimit arkitektonik dhe roli komunikues lokal, krahinor e ndërkombëtar. Asnjëra nga këto ura sot nuk ekziston.

Konfiguracioni i thyer i terrenit ku është ngritur qyteti i Dibrës dhe përrenjtë e furishëm që sillnin ujin nga malet sipër qytetit, kishin kushtëzuar ndërtimin edhe të shumë urave në qytet, më të vogla për nga dimensionet, por të bukura e funksionale, që lidhnin brënda për brënda qytetin dhe bënin më komod kalimin e njerëzve nga një lagje në lagjen tjetër.

Për të sistemuar ujin e përroit që vinte nga fshati Elevcë dhe Përroin e Vakofit, ishin ndërtuar Ura e Bejlerëve, Ura e Kuqe, Ura e Çezmës së Madhe, Ura e Selamit, Ura e Vakofit dhe Ura e Këllëçbabës.

Këto ura ishin të ndërtuara vetëm prej guri, por kishte edhe të atilla të ndërtuara prej guri, hekuri dhe druri.Këto ura për fat të keq sot nuk ekzistojnë, përveç një pjese të Urës së Çezmës së Madhe dhe të Urës së Këllëçbabës. Kjo ka ndodhur sepse rrugët janë rrafshuar dhe mbuluar me pllaka betoni, ndërsa urat në brendi të qytetit janë prishur.

Dibra gjithashtu është e përmendur edhe për çezmat e shumta. Sot maleve e në qytet zbulohen tubo qeramike dhe ujësjellës të vjetër të mbuluar me rasa guri që kanë sjellur ujin në lagjet e vjetra dibrane. Nga çezma më të dalluara që ekzistojnë edhe sot e kësaj dite janë çezma e Demçes, çezma e Shahvecit, çezma e Budulecit, çezma e Popit, çezma e Tikvarcës, çezma e Namazjarit dhe çezma e Madhe. Këto çezma ekzistojnë edhe sot e kësaj dite. Sot kur në disa lagje nuk ka ujë ujësjellësi, banorët furnizohen me ujë nga këto çezma dhe nga puset ekzistuese. Tani është ndërtuar ujësjellësi i cili me rrjetin e tij shpërndarës furnizon me ujë të pijshëm banorët e qytetit dhe të fshatrave përreth.

Dibra ka patur të ndërtuar edhe rrjetin e kanalizimeve për ujërat e zeza dhe që daton nga periudha Osmane dhe që janë ndërtuar nga pllakat me gurë, një pjesë e këtyre kanalizimeve funksionon edhe sot e kësaj dite. Për ti mbrojtur tokat bujqësore nga ndotja me ujërat e zeza aktualisht janë ndërtuar tre degëzime të kanalizimeve të cilat përfundojnë jashtë zonave të urbanizuara. Në një të ardhme nevojitet të ndërtohet edhe një kolektor për pastrimin e këtyre ujërave të zeza, por ky investim ka një kosto tepër të lartë të ndërtimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes që momentalisht komuna e Dibrës dhe qytetarët nuk mund ta përballojnë vetë dhe prandaj pritet ndonjë donacion nga jashtë".

I pyetur sa është ruajtur nga kjo arkitekturë monumentale e Dibrës, ing.Petrit Paçuku, shprehet se "Kjo arkitekturë monumentale dibrane gjatë periudhës së ofensivave serbe, në fillim të shekullit të 20-të, kur Dibra u dogj dhe u grabit u shkatërrua gati tërësisht. Me këtë rast u shkatërrua edhe xhamia e Dervish Pashës bashkë me Kullën e Sahatit dhe në vend të saj u ndërtua një kishë orthodokse. Në këtë kohë u shkatërrua edhe një xhami që ndodhej në vendin ku sot ndodhet posta e qytetit. Në vitet e 50-ta të shekullit të 20-të sistemi monist e dogji dhe e shkatërroi edhe Xhaminë e re dhe shkollën "Hoxhë Voka" që ndodhej në qendër të qytetit, në vendin e së cilës ndërtoi shtëpia banimi individuale me hapësira afariste. Falë angazhimit të Myftinisë së Dibrës sot në Dibër janë riparuar dhe ndërtuar shtatë xhami. Ky degradim i arkitekturës u bë edhe gjatë tërmetit të vitit 1967, i cili rrënoi totalisht ose dëmtoi shumë shtëpi dhe objekte karakteristike dibrane, por shteti nuk tregoi asfarë interesimi për rindërtimin ose meremetimin e këtyre objekteve të dëmtuara edhe pse ishin objekte që mbroheshin nga enti për trashëgimi kulturore-historike në Maqedoni. Shteti i pengonte edhe pronarët e shtëpive, të cilët me mjetet e tyre, deshën të bënin restaurimin e objekteve ku edhe jetonin këto objekte nga mos interesimi i institucioneve shtetërore për tu meremetuar dhe rikonstruktuar dhe nga dhëmbi i kohës një pjesë e tyre janë shkatërruar tërësisht ose janë në gjendje të mjerueshme.

E vetmja shtëpi karakteristike dibrane, e cila e ka ruajtur pamjen e vet është ajo e pronarit Ibrahim Erebara, i cili me mjete të veta dhe me këmbëngulësinë e tij, arriti që ta mirëmbajë dhe ta ruajë bukurinë e kësaj shtëpie, të cilën e vizitojnë edhe shumë turistë. Edhe në 25 vitet e demokracisë gjendja e objekteve të trashëgimisë historike, arkitektonike e kulturore është e njëjtë dhe me degradim të mëtejmë. Viteve të fundit janë realizuar disa projekte në drejtim të ruajtjes së këtyre objekteve, siç është rasti me sanimin e shtëpisë së Sakip Selës dhe sanimi i Hamamit-Banjës së re të qytetit, të cilat tani përdoren si pika turistike për tu vizituar nga turistët e interesuar. Para disa vitesh në Dibër arriti një komision republikan për sanimin e objektit të Hamamit të vjetër, por edhe pse u dhanë shumë premtime gjer më sot nuk ka as një investim lidhur me sanimin e këtij objekti të rëndësishëm, i cili gjithashtu është në mbrojtje nga enti për trashëgimi historike-kulturore të Maqedonisë".

JANË HARTUAR PLANI GJENERAL DHE PLANET DETALE URBANISTIKE

Pas vitit 1945 në Maqedoni janë bërë gjithsej katër ndarje territoriale, me çka Dibra e ndarë nga shteti amë në Konferencën e Londrës në vitin 1913-1914 dhe në Konferencën e Paqes në Paris në vitin 1919-1920 dhe e mbetur në Maqedoni, është tkurrur edhe më shumë nga aspekti territorial dhe i popullsisë.

Për planifikimin e zhvillimit të tanishëm të Komunës së Dibrës, inxh Petrit Paçuku, na informoi se: "Sipas nevojës për zhvillimin e qytetit në Komunën e Dibrës janë hartuar plani Gjeneral Urbanistik dhe planet detale urbanistike, të cilët propozohen nga vetë Komuna ose nga qytetarët e interesuar për ndërtimin e banesave ose për zhvillimin e bizneseve. Dibra me planet detale urbanistike ka përfshirë 80 përqind të territorit, ku parashihet ndërtimit të shtëpive individuale, të ndërtesave për banim kolektiv dhe të objekteve afariste. Plane detale urbanistike aktualisht kemi për kompleksin e banjave termominerale në Banisht dhe Kosovrast, ndërsa në fazën e përpunimit janë planet detale për fshatrat Mogorçë dhe Kosovrast i Poshtëm.

Plani detal urbanistik për bregun e liqenit të Dibrës është në fazën përfundimtare. Me këtë plan në tokën përreth liqenit parashihet ndërtimi i objekteve hotelierike-turistike me terrene për sport dhe rekreacion, ndërtimi i objekteve restorante dhe i shtëpive turistike, ndërsa kafe baret ekzistuese janë propozuar të mbesin si të tilla me gabarite aktuale pa të drejtë zgjerimi".

ASFALTOHEN DHE PLLAKËZOHEN RRUGË.

Me angazhimin e Komunës së Dibrës nga ana e Republikës u rikonstruktua ura mbi liqenin e Dibrës e ndërtuar në vitet e 50-ta e cila ishte amortizuar shumë dhe paraqiste rrezik për automjetet dhe udhëtarët. Kjo urë shërben si e vetmja lidhje e Dibrës në drejtim të Shkupit. Janë asfaltuar edhe disa rrugë në hyrje të qytetit dhe janë pllakëzuar shumë rrugë dhe trotuare në qytet, me synim që të mos mbetet pa u pllakëzuar asnjë rrugë.

NDËRTOHET GJIMNAZI RI DHE RRUGA KRYESORE E QYTETIT.

Udhëheqësia aktuale e Komunës së Dibrës, shton ing.Petrit Paçuku, "arriti të sigurojë investitorin e 1 milion e 300 mijë euro për ndërtimin e godinës së re të Gjimnazit, i cili ka filluar të ndërtohet me mjetet e veta, me çka do tu jepet fund kushteve të vështira në të cilat punojnë sot arsimtarët dhe nxënësit e kësaj shkolle.

Tani filloi me punë intensive edhe rregullimi i qendrës së qytetit ku është parashikuar që kjo rrugë të jetë për qarkullim njëdrejtimshe pa parkim automjetesh dhe për këmbësorë.

Në këtë rrugë është parashikuar ndërtimi i tërë infrastrukturës së nevojshme nëntokësore, si kanalizimi i ujërave të zeza dhe atmosferike, ndërtimi i ujësjellësit, linjës elektrike, linjës telefonike, ndriçimi publik dhe linjës kabllore dhe infrastruktura e nevojshme mbi tokësore. Kjo rrugë do të ndërtohet me gurë të punuar, do të ketë ndriçim publik, karrige pushuese dhe dru dekorativ.

Në të ardhmen është në proces e sipër edhe ndërtimi i planit gjeneral urbanistik për realizimin e ndërtimit edhe të një parkimi për vendosjen e automjeteve të qytetit. Kjo parkim që do të ndërtohet në zonën qendrore, do të ketë dy nivele dhe do ta lehtësojë dukshëm mundësinë e parkimit të automjeteve që sot paraqet problem të madh për qytetarët".

LIGJI PËR LEGALIZIM NË ZBATIM E SIPËR

Komuna e Dibrës, thotë inxh.Petrit Paçuku, se "është duke i realizuar në kohë të gjitha lëndët e kompletuara nga qytetarët mbi bazën e Ligjit për Legalizim, por na habit shumë mos interesimi i shumë qytetarëve, të cilët nuk janë të interesuar ta bëjnë kompletimin e dokumentacionit me dëshmi për pronësi dhe me vonesën e tyre lejojnë që lëndët e tyre më 31.12.2015 të mbyllen pa u realizuar në afatin për dorëzim të kërkesave nga viti 2011 palët kanë dorëzuar 2086 kërkesa, dhe deri në vitin 2014 janë zgjidhur gjithsej 828 lëndë, u shpreh ing.Petrit Paçuku".

Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit

<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

Ç'kemi asaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Iku dhe Prilli bashkë me plakat. Bora nuk harroi të bjerë, sa për të na kujtuar dimrin dhe fjalët e moçme të pleqve që "kërcurin e fundit duhet ta ruash për Shëngjergj"

Parlamenti me 89 vota i dha rrugë për zgjidhje çështjes së rrugës së Arbrit. Por që në rrugë të fillojnë punimet, ka edhe pak rrugë për të bërë. Në debat u fol për të gjitha: për politikë, për ca që e donin rrugën e ca që flisnin sa për sy e faqe, ca që akuzonin dhe ca që mbroheshin, ca flisnin për popullin e ca për atdheun, disa për ekonominë e disa për kombin, ca shprehnin pesimizëm e ca optimizëm të lartë, por debati i vërtetë për rrugën nuk u bë: si do jenë standardet dhe cilat janë ato? Sa do jetë gjerësia dhe sa shpejtësia...Por, në fund na thanë ta gëzojmë rrugën! Dhe sigurisht që do ta gëzojmë kur të fillojë e të përfundojë...

Këndej ka filluar fushata elektorale. Votojmë për zgjedhjet lokalet, fushatën e bëjmë si zgjedhje qendrore. Zyrtarisht akoma nuk ka filluar, por praktikisht kandidatët kanë dalë gju më gju me popullin dhe kanë filluar listën gënjeshtrave. Në fakt ata u thonë premtime.

Ndërsa në Facebook deri më tani, vëllezërit, xhaxhallarët, kushërinjtë, kunetërit, shokët, djemtë e miqtë e fshati i kandidatit po nguten t'i urojnë, majtas e djathtas, për fitoren e sigurtë! Dibra ka sot 8 kryetarë bashkish, por më 22 qershor do gdhihet me katër. Katër fituesit e dinin më kohë se do fitonin, ndërsa katër humbësit, kur ta shohin se u iku kryebashkiakllëku për një votë, do kthejnë kokën për të gjetur ndonjë mik që do t'i ngushëllojë, por do ta shohin se ata janë zhdukur... Madje do kujtohen të zhdukin edhe komentet...

Kandidatët premtojnë "Non Stop" shërbime për problemet e qytetarëve: ujin, dritat, pensionin, ndihmën sociale, plehrat për tokën, traktorin për arën... deri sa të mbarojnë zgjedhjet. Pastaj, të gjitha problemet kalojnë përpara dhe "No Stop" mbetet pas. D.m.th në shqip: Jo, ndalo!

Tani që çështjen e rrugës e zgjidhëm dhe kandidatët i caktuam, thamë t'u vendosim njëherë zjarrin pyjeve. Bie zjarri në gush, ta provojmë edhe në prill nëse digjet apo jo!

Këtë numër përgatita një reportazh për Peshkopinë. E shkrova, e korrigjova, e redaktova dhe vendosa të mos e botoj: gjithë reportazhi ishte mbushur me pluhur dhe duhan...

Në Peshkopi u përurua memoriali kushtuar viktimave të komunizmit. Meqë nuk kishte mbetur pëllëmbë vend për memorialin, thamë të heqim Iljazin - fundja bust është - dhe vendosim memorialin. A s'do ishte më mirë ti merrnim të gjitha bustet dhe ti fusnim në një muze. Do ta shpëtonim qytetin nga disa buste pa shije artistike. Dhe do bënim dy të mira: edhe heronjtë i ruanim, edhe lulishtet i pastronim...

Këndej ka plasur papunësia. Njerëzit u janë turrur kufijve. Është hapur biznesi i krijimit të konflikteve: aman me gjej një armik për një ditë, sa për një dokument. Se do iki në Gjermani dhe do deklaroj se kam hasmëri! Kështu që janë hapur mundësi të reja biznesi! Apo nuk shkon reklama para dyqanit: "Gjëjmë një vrasës për ju!"

Meqë jemi të puna, pashë një njoftim interesant për një vend punë administrator - pa pagesë, në një faqe sociale. Kandidati duhet të kishte disa kritere: të ishte ironik, të bënte humor, të dinte të shkruante dhe të ishte dibran! Kishin harruar edhe kriterin që ta mbante pushkën në votër!



Ndiqe gazetën Rruga e Arbërit në Facebook
në linkun e mëposhtëm:
https://www.facebook.com/pages/Rruga-e-Arbërit

OPINION

Duhet të bëjmë diçka që t'u rikthejmë optimizmin të rinjve

Nga **MAJLINDA HOXHA**

"Pesimizmi është një justifikim për të mos u përpjekur dhe një garanci për dështimin personal, ka thënë diku Bill Klinton.

Është kjo një thënie e ish presidentit të ShBA-së, mbi fenomenin të cilin e shoh si problematik në shoqërinë tonë postkomuniste: pesimizmin.

Duke qenë natyrë optimiste, i kam parë të kundërtit me mua si një pjesë e shoqërisë me diversitetin e saj. Jo për të mos analizuar apo vërejtur me çudi diçka që brenda teje "përplaset" nëse tenton të depërtojë, por me kohën qartësohet çdo gjë.

M'u desh një udhëtim tre ditor në vendlindjen time, për të kuptuar më shumë për regresin që kanë sjellë këta vite të stërgjatura tranzicioni. Aty ku energjia pozitive, vitaliteti, ishin me shumicë dikur.

Për fat të mirë, shpirti dibran i ka rrënjët e thella dhe nuk shkulet kollaj, por filizat e tyre të reja rrezikohen nga kalbëzimi që po sjell koha e tanishme. Biseda me disa të rinj gjimnazistë, më solli pranë dyshimin se mos të gjitha ato për të cilat gjyshja më foli që në vegjëli nuk ekzistonin! E rritur me idealet e dashurisë për vendlindjen, për virtytet dhe krenarinë e të qenit dibrane, e atij admirimi për relievin e mrekullueshëm që natyra na bekoi, gjithçka pashë dhe dëgjova më trishtoi.

Shprehur kështu, nuk kam parasysh se ata nuk e donin Dibrën, por në sytë e tyre lexohej pashpresa që shihnin rreth tyre. Komentit tim se një ditë dua të rikthehem këtu, dikush nga rreshti i tretë, pasi kishim krijuar një si gjysmë rrethi dhe bisedonim aq zellshëm se adoleshenca e ka pjesë të saj të pandashme euforinë, tha prerë: - Do bësh gabim!

Sigurisht, që u mundova t'ia argumentoj gjithçka, por një argument i imi ndeshej me dhjetë të tjerë, që si për çudinë e rastit ishin të njëjta në thelb!

Nuk e ndjeva veten të "sfiduar", se për fat optimizmi im vazhdon të ngrejë krye ndaj të kundërtës së tij, madje ndryshe nga ligji universal edhe ta shtyjë atë.

Kur e shoh qytetin tim me baltë, më shkon vetvetiu mendimi se çfarë duhet të bëjmë për t'u rikthyer besimin të rinjve? Që ata të mos rriten nën petkun e trishtë të pesimizmit, sepse Bota, e ardhmja u takon optimistëve.

Si për të vazhduar "testimin" tim, nëse do e quaja kështu, i cili lindi pa ndonjë paramendim të caktuar, dola nga universiteti, i cili dyert i rrinë gjysmë të hapura. Edhe aty situata nuk ishte ndryshe nga më parë, shtuar edhe faktin e sipërpërmendur: dyer të cilat presin t'u jepet shtytja përfundimtare për t'u mbyllur, sikur Dibra të mos ishte e denjë për mbajtjen e dijes, ashtu siç ka qenë dikur ...

Prekëm disa çështje të ndryshme si për të respektuar moshën dhe kahet e tyre të studimit. Të paktën, efekti pozitiv kur i afrohesh një dibrani dhe i flet kishte ngelur i pacenuar edhe nga koha. Gjestet e tyre, tipike dibrane, ku të ftojnë në një familjaritet të menjëhershëm, na e lehtësuan bisedën por jo thelbin për të cilën flisnim. Këtu madje, vura re ulje qerpikësh, kokash, pashpresë për nesër... U binda!

Pesimizmi, si farë e keqe, paska rrënjëshuar thellë mes tyre, asaj çfarë është forca jonë më e madhe, rinia, e ardhmja e vendit! Lidhur me atë çfarë citova ne fillim, kuptova se kjo s'ka të bëjë me dështimin personal, por kolektiv të një qyteti, rrethi.

Që nga ai çast, mendimeve kur e shoh qytetin tim me baltë, iu shtua edhe një tjetër: si t'ua rikthejmë besimin të rinjve dibranë? Që ata të mos rriten nën petkun e trishtë të pesimizmit, sepse Bota, e ardhmja u takon optimistëve.

Na takon neve, më të rriturve, më të diturve, më të mundshmëve të bëjmë diçka për vendlindjen tonë, që t'u kthehet besimi të rinjve, që të rriten dhe të jetojnë atje.

Është detyra e gjithkujt që është dhe ndihet dibran.

Fjalë arabe që qarkullojnë në të folurën e Dibrës

Nga **SULEJMAN TOMÇINI**

Ashtu si në mbarë gjuhën shqipe,edhe në të folurën e Dibrës përdoren shumë fjalë arabe,qe kane hyrë nëpërmjet turqishtes. Disa prej tyre ruajnë kuptimin dhe domethënien e tyre origjinale,ndërsa disa të tjera jane transformuar.Këte transformim mund ta kete bere gjuha turke,nga e cila erdhën tek ne,ose edhe vete gjuha shqipe gjate viteve.Unë nuk e njoh gjuhën turke,që të mund të japë ndonjë mendim të specializuar për përdorimin dhe kuptimin e këtyre fjalëve në këtë gjuhë.Por po mjaftohem duke i rënditur një pjesë të madhe të tyre,se mund të ketë edhe të tjera,duke dhënë kuptimin e tyre në gjuhën arabe.Ndërkohë mund të ketë edhe ndonjë fjalë shqipe që rastësisht ngjason me atë arabe,gjë që mund të sqarohet nga studime te mëtejshme nga specialistët e fushës.

Them se disa prej këtyre fjaleve mund të ishin zëvendësuar me kohë me fjalë të shqipes,disa të tjera tashmë jane rrënjosur dhe janë bërë pjesë e fondit të saj leksikor.Megjithate, me pakë përpjekje, shumica e tyre mund te zëvendësohen me fjalë shqipe.

* * *

(Vijon nga numri i kaluar)

Iftira - shpifje, trillim; insinuatë
Ihram – veshje speciale e muslimanëve gjatë haxhillëkut
Ikbal - fat i mirë; lumturi
Ila - pa, perveç
Ilaç – trajtim mjekësor, mjekim
Ilahi - hyjnor, qiellor
Ilaqim - por
Ilet – sëmundje; debulesë; e metë, defekt; cen
Ilham - frymëzim
Ilik - lidhje; rrip ku varet shpata etj.; *bot.* bisht gjetheje ose fruti
Ilvijar – besimtarë i mirë; i shyenjtë
Imam –administrator xhamie dhe drejtues i faljes në të
Iman – besim. Pa din e pa iman – pa fe e pa besim
Imsaq - agjërim
Imza - nënshkrim, firmë;
Inat - kokëfortësi;kundërvënie, kundërqëndrim
Insaf - gjykim i drejtë, i paanshëm; drejtësi
Insan - njeri
Irade – 1.dëshirë, vullnet; 2.urdhër, dekret
Ishalla – (in-shee-allah) nëse do Zoti
Isharet - shenjë, bërje me shenjë; gjest
Islam– islam, feja islame
Ispat - provë; pohim; dëshmi; çertifikatë
Istifa - kërkesë faljeje a ndjese.
Istikam – (istihkem) fortifikim
Itifak – (ittifak) marrëveshje, traktat
Izën a izëm - leje, lejim. Më jep izmin- më jep leje.
Izjet – dhimbje, lëndim; fatkeqësi. Në Dibër përdoret me kuptimin vuajtje, torturë.
Ja - (pjesëz thirore) o!
Jahu– o vëlla!. Prej këtu: mor jahu!- mor vëlla!
Jahudi - çifut
Jalla– o Zot, o Perendi
Jani - domethënë
Jani - mish i zier; ragu
Jarabi – (ja rabbii) o Zoti im
Jasemin - *bot.* jasemin
Jemin - perbetim, betim, Prej ketu jeminullah - betohem për Zotin
Jesir –rob lufte. Ne Dibër luhet një lojë me emrin "jesir", që bazohet në parimin e kapjes së robërve nga skuadra kundërshtare
Jetim – bonjak
Kaba - gjë e trashë a e ashpër; idiotizëm; gjë e lartë në formë kupole
Kabile - fis
Kabull – pranim, pëlqim
Kadaif - lloj ëmbëlsire, kadaif
Kade – enë për të pirë
Kader – fat
Kadi - gjykatës
Kadife – kadife(lloj tekstilesh me push)
Kafaz -1. furik; 2. shportë; 3. arkë, kuti mallrash; 4. *anat.* kafaz i kraharorit
Kahar - hidherim, mërzitje
Kail - folës, thënës, shprehës
Kajde – 1. melodi; 2. djallëzi, dhelpëri
Kajmekam – (kaimu-mekam) zëvendës, i ngarkuar
Kala– fortesë, kështjellë
Kalif– pasardhës, kalif
Kallaballëk – baza eshte fjala arabe galaba,që do të thotë epërsi a zhurmë plus prapashtesa turke llëk
Kallafat - punë e bërë shkel e shko, sa për të kaluar rradhën
Kallëp - pajisje për t'u dhënë formë metaleve, kepucëve, qelesheve etj; formë
Kallkan - i shqetësuar, i irrituar, i pagjumë
kallp - ndryshim, përmbysje
Kandar - peshë
Kanun - ligj
Kaps - tkurrje, hyrje në ujë, ngushtim
Karar – vendim
Karat – masë për vlerësimin e metaleve të çmuara
Kasaba – qytet i madh

(Vijon numrin e ardhshëm)

Rruga e Arbërit nr. 108

veprimtari

Këshilli bashkiak i qytetit të Peshkopisë
i jep Presidentit të Republikës titullin "Qytetar Nderi"

"Nderi i Kombit" për fshatin Blliçe

Presidenti i Republikës, Bujar Nishani, ishte më 30 prill në Peshkopi dhe Blliçe. Ai i dha fshatit Blliçe dekoratën "Nderi i Kombit" në shenjë vlerësimi të lartë dhe respekti të thellë për qëndresën e pamposhtur ndaj diktaturës mizore gati 50-vjeçare komuniste, si dhe në nderim të vullnetit, kurajës dhe këmbënguljes së paepur të treguar gjatë gjithë asaj periudhe të pashpirt shtypjeje dhe përndjekjeje të pabarabartë në emër të luftës shkatërrimtare dhe vëllavrasëse të klasave.

Banorët e fshatit e pritën Presidentin e Republikës me flamuj në duar, ndërsa grupi artistik e shoqëroi ardhjen e tij me këngë e valle. Në ceremoninë e mbajtur para shkollës 9-vjeçare të fshatit ishin personalitete të shquar të vendit, përfaqësues të pushtetit vendor dhe institucioneve të tjera shtetërore.

Kryetari i komunës Fushë-Çidhën, z. Arianit Skepi, gjatë fjalës së mirëseardhjes, falënderoi Presidentin dhe pjesëmarrësit për këtë ditë të shënuar për banorët e fshatit Blliçe. Kryetari i komunës e cilësoi sakrificën e banorëve të Fushë-Çidhnës, se i bën nder jo vetëm Dibrës, por gjithë Shqipërisë, për qëndresën e tyre të hershme, që nga koha e Skënderbeut duke derdhur gjak për mbrojtjen e Dibrës. Pavarësisht kujtimeve të dhimbshme, historive të tmerrshme, që ne blliçasit përjetuam përgjatë 50 vjetëve të regjimit diktatorial, ne nuk e humbëm shpresën, dëshirën, nuk e vramë ëndrrën për liri, tha Skepi.

Në fjalën e tij të rastit z. Agron Tufa, drejtor i Institutit të Studimeve të Krimeve të Komunizmit shprehi mirënjohje për të gjithë banorët e fshatit Blliçe, Dibrës dhe për të gjithë ata krahina që i rezistuan dhe i mbijetuan terrorit komunist dhe diktaturës.

"Sot i kthehet dinjiteti i mohuar gjatë gjysmë shekulli të pasluftës së dytë Botërore një prej fshatrave-simbol të renzistencës antikomuniste. Qëndresa juaj, hyn sot, me dekretin e Presidentit të Republikës, në krenarinë e ligjshme të ndërgjegjes së kombit, në panteonin e nderit, sepse gjyshërit dhe prindërit tuaj u pushkatuan, u burgosën, u internuan duke mbrojtur vlerat njerëzore dhe dinjitetin njerëzor përballë egërsisë dhe gjenocidit komunist. Ky është ndër për Blliçen, Dibrën dhe Shqipërinë. Vlerë për brezat e rinj, që do të krenohen me guximin, burrërinë dhe qëndresën e të parëve tuaj", tha Tufa.

Gjurmët e persekutimit janë akoma të qarta, tha Sakip Skepi, ish banor i fshatit Blliçe, i arratisur nga persekutimi që në moshën 5 vjeçare bashkë me 40 anëtarë të familjes. Ai flet i emocionuar dhe njëkohësisht krenar për vlerësimin që i bëri Presidenti bashkëvuajtësve të tij.

"Jemi mbledhur për të kujtuar dhe vlerësuar njërin prej fshatrave simbol të goditjes, dhunës çnjerëzore dhe përndjekjes së pashembullt të diktaturës komuniste – Fshatin martir Blliçe dhe banorët e tij të martirizuar. Kujtojmë dhe nderojmë sot mbarë popullin e Fshatit Blliçe të Komunës së Fushë-Çidhnës, ku numri i të burgosurve, të internuarve dhe të përndjekurve nga makineria e pashpirt diktatoriale arriti në dhjetëra e qindra, pa kursyer askënd, duke prekur pothuajse të 150 shtëpitë e fshatit tuaj", tha Presidenti Nishani gjatë fjalës së tij.

"Në mbarë Shqipërinë tonë të dashur, fshati



juaj përbën ndoshta shembullin më të trishtuar e më famëkeq se si shqiptari burgosi shqiptarin, se si ideologjia e rreme dhe e dështuar komuniste kreu kaq shumë krime ende të pandëshkuara, duke shkaktuar një kalvar kaq të rëndë e të pafund vuajtjesh që janë të tepërta e të padurueshme për çdo qenie njerëzore, sado e fuqishme që mund të jetë. Prandaj mund të pohojmë sot me plot gojë që ju jeni martirë të vërtetë – martirë të diktaturës së imponuar, në një tokë kaq të bukur e pjellore sa ç'janë viset tuaja atdhetare, mikpritëse e bujare", theksoi Presidenti.

Askush nuk ikën me dëshirë nga trualli i vet, por populli shqiptar, ju, banorët e këtyre trevave fisnike luftuat dhe bëtë rezistencë jo vetëm me durimin tuaj proverbial, me shtrëngimin e dhëmbëve nga urrejtja, pa bërë kompromis dhe duke mos u dorëzuar para së keqes, por edhe me ikjen, me largimin, me arratinë nga mëmëdheu. Kjo ishte fytyra e vërtetë dhe e pashpirt e diktaturës dhe veglave të saj. Për të gjitha ato krime askush nuk është dënuar, askush nuk është burgosur, askush nuk është përndjekur. Madje askush nuk ka kërkuar falje me dorën në zemër, akoma! Por ju me shpirtin tuaj fisnik keni vazhduar luftën, përpjekjet tuaja, me ballin lart krenar e të nderuar duke i dhënë forcë e dinjitet kësaj treve.

Asgjë nuk harrohet dhe nuk duhet të harrohet!" – theksoi Kryetari i Shtetit shqiptar.

"Është detyra dhe përgjegjësia jonë morale, etike, institucionale dhe historike për të mos harruar atë çka hoqët ju, çka pësoi e vuajti ky popull padrejtësisht. Përndryshe tragjeditë që ndodhën dikur, mund të përsëriten sërish nëse ne nuk jemi të vëmendshëm e me kujtesë të çeliktë duke ua mësuar, mëkuar dhe përcjellë brezave të rinj dhe atyre që do të vijnë pas nesh, të vërtetën e hidhur e tragjike. Ju dini të falni dhe mbase edhe i keni falur me gjithë shpirt përndjekësit dhe xhelatët tuaj të dikurshëm, pavarësisht se ata ende nuk ju kanë rënë në gjunjë me përunjësi. Mbi të gjitha dinit të kujtoni e të mbani mend gjatë, dini të mos harroni duke na bërë edhe ne akoma edhe më krenarë e më të nderuar që jemi sot mes jush." – u shpreh Presidenti Nishani.

"Sot, të mbledhur këtu ne kujtojmë me respekt vuajtjet, martirizimin dhe sakrificat tuaja, gjakun e derdhur dhe jetët e shkatërruara në emër të së ashtuajturës 'luftë klasash" që nisi fatkeqësisht në vitin e largët dhe tragjik 1944 e duke përfunduar fatmirësisht në vitin 1991. Nderim, mirënjohje, kujtim i përjetshëm për të gjitha ata heronj të heshtur e të panënshtruar, sepse institucionet shtetërore kanë detyrimin dhe përgjegjësinë jo vetëm të mos harrojnë të kaluarën tonë të hidhur, por edhe të ofrojnë mirënjohje dhe respekt me përunjësi", tha Presidenti i Republikës.

PESHKOPI, PËRUROHET MEMORIALI KUSHTUAR KRIMEVE TË KOMUNIZMIT

Më pas, Presidenti i Republikës ishte i pranishëm në qytetin e Peshkopisë, ku mori pjesë në përurimin e memorialit kushtuar "Krimeve të komunizmit dhe përndjekjeve për liri dhe demokraci".

Në fjalën që mbajti z.Besim Ndregjoni, Presidenti i Unionit mbarëkombëtar të Integrimit të të Burgosurve, u kërkoi dibranëve të mos harrojnë, sepse harresa është vdekja jonë e dytë.

Kryetari i bashkisë se Peshkopisë, z. Ilir Krosi, tha se sipas Institutit të të Përndjekurve politikë, rreth 478 dibranë janë pushkatuar dhe 2243 të burgosur, duke përjashtuar këtu të ashtuquajturat "lista të zeza" gjatë viteve 1944-1948. Ndër personalitetet të cilët u pushkatuan përmend intelektualin Edip Tershana, Shaban e Hasan Stojku, etj.

Këshilli bashkiak në mënyrë unanime vendosi t'i japë Presidentit të Republikës titullin "Qytetar Nderi" me motivacionin: "Për kontribut të shquar në mbrojtje të demokracisë, si intelektual e garant i konsolidimit të shtetit të së drejtës dhe në shenjë mirënjohjeje për vlerësimin e kontributit të dibranëve e të Dibrës në mbrojtje të lirisë dhe vlerave të saj".

"Kujtesa është një nga elementët kryesorë që tregon vitalitetin e një populli. Një populli që fatkeqësisht historia e shkruar nga institucionet shtetërore nuk i ka rezervuar vendin që i takon! Sepse historia ka nevojë ta thotë fort zërin e saj përmes kujtesës, të dëshmive të gjalla dhe ato të atyre që sot nuk jetojnë më!" – vuri në dukje Presidenti gjatë përshëndetjes së tij.

"Fatmirësisht, – theksoi Kreu i Shtetit – sot ka ende dëshmitarë të gjallë, shumë janë këtu mes nesh, në këtë qytet, ata gjenden në Blliçe, Dibër dhe mbarë Shqipërinë!

Duke vlerësuar këtë Memorial si një dëshmi të gjallë, një vlerë dhe kontribut i veçantë që meriton respekt, meriton mirënjohjen tonë dhe kjo shkon ndaj Kryetarit të Bashkisë, Bashkisë Peshkopi dhe atyre njerëzve që kanë punuar për konceptimin dhe zbatimin e këtij projekti, Kreu i Shtetit tha se: "përfaqëson gjithashtu kujtesën ndaj atyre qindra dhe mijëra burrave dhe grave, të rinjve dhe të rejave, pleqve dhe plakave, shpesh dhe fëmijëve që jeta i rezervoi një fat të hidhur.

Ndaj, edhe në këtë ditë, përpara këtij monumenti, dëshiroj të bëj një thirrje, një lutje dhe një kërkesë për të gjithë ju, familjet tuaja, të vijojmë të punojmë bashkërisht me dedikim dhe ndershmëri për të ardhmen tonë dhe fëmijëve tanë, në këtë vend ku balta është më e ëmbël se mjalta."

Miran TAFA

Nga Mentor HOXHA

FSHATLINDJES BLLIÇE

Brodha shumë nëpër botë
Pashë vende të magjishme
Por askush s'më ngrohu dot
Si vendlindja - fshati Blliçe.

Molla, kumbulla dhe rrushi
Si gjerdan fshatit i rrinë
Vajzat faqet kuq si prushi
Djemtë porsi yje ndrijnë.

Armiqtë porsi kuçedra
Shumë herë Blliçen e dogjën
Por lirinë ndezur përbrenda
Dot blliçjanit s'ia morën.

Shumë rrebeshe edhe dallgë
E përgjakën fshatin tim
Por Blliçja u ngrit mbi valë
Si zgalemi mbi stuhinë.

Historinë e fshatit Blliçe
S'ka njeri që nuk e di
Ndaj është kaq e magjishme
Ndjenja që më vlon në gji.

Madhështinë e fshatit tim
Qindra vargje nuk e nxënë
...Aty kombi im rilind
Demokracia ka rrënjë.

RRUGA E SHPRESËS SË MADHE

(vijon nga faqja 6)

Këtë koncesion nuk po e miratojmë në dëm të interesave të shtetit apo të qytetarëve shqiptarë siç bëtë ju dje me rrugën Durrës-Kukës, por përmes praktikës me negocim, me partnerë të fuqishëm ne synojmë të realizojmë me cilësi dhe në kohë këtë rrugë.

Kjo është përgjigja më e mirë që qeveria dhe kryeministri Edi Rama iu ka dhënë të gjithë banorëve dhe intelektualëve dibranë, përfshirë edhe disa prej tyre që kanë përcjellë me skeptizicëm përpjekjet që ka bërë kjo mazhorancë. Reforma administrativo – territoriale që kemi realizuar, si dhe ky projekt që po miratohet sot në Kuvend do t'i japin shpërblimin e merituar Dibrës dhe dibranëve për kontributin që kanë dhënë në histori. Me këtë rrugë krijohen mundësi të reja edhe në rajon. Të gjithë bashkë duhet të punojmë për rritjen e bashkëpunimit real edhe me autoritetet maqedonase të cilat qeveria Rama i ka filluar, ku fokus të veçantë duhet të ketë edhe bashkëpunimi ndërkufitar dhe ku Bashkia e Peshkopisë me atë të Dibrës së Madhe duhet ti paraprijnë me projekte konkrete.

Prandaj sot unë pres që kjo paketë ligjore të votohet unanimisht nga të gjithë deputetët, ku me siguri ne, 13 të zgjedhurit dibranë në Dibër e Tiranë, besoj se do të jemi në unison. Këtë duhet ta bëjmë për hirë të historisë së Dibrës, dhe detyrimeve që kemi secili prej nesh ndaj të parëve tanë.

Ata që do të votojnë kundër apo do të bojkotojnë këtë projekt do ta kenë të humbur përgjithnjë betejën me Dibrën dhe dibranët, duke filluar që më datën 22 qershor 2015.

Unë e ftoj të gjithë komunitetin dibran që ta mbështesin fuqimisht këtë hap që po hedhim sot, që bashkarisht ta kthejmë të gjithë aksin Tiranë – Dibër në një prej zonave më të zhvilluara të Ballkanit.

Rruga e Arbrit ka shumë miq dhe mbështetës në këtë parlament në të gjitha krahët e politikës pa dallim dhe në emrin tuaj do të desha ti falënderoj të gjithë me radhë, por disa fjalë zemre vetvetiu më shkojnë te kolegët e mi të mazhorancës, sepse si thonë fjalës "haka shkon përherë tek i zoti" dhe ne socialistët sot në këtë parlament por jo vetëm, ndjehemi mirë sepse ishim ne që ngulëm kazmat e para në ndërtimin e Rrugës së Arbrit dhe na takon po ne ta përfundojmë atë.

Ju sot me votën tuaj pro këtij projektligji do ti ktheni trevës së Dibrës shkëlqimin e historisë së saj të lavdishme dhe zhvillimin e progresit të saj ekonomik dhe dibranët fisnikë, punëtorë e të ndershëm do të dinë t'ja kthejnë nderën Shqipërisë dhe mikut jo vetëm me votë por edhe me shpirt siç kanë bërë përherë përgjatë historisë së këtij kombi fisnik.

** Deputet i Dibrës (PS)*

dëshmi

Mbi fshatin Blliçe, sikundër në gjithë zonën dhe krahinën, sikundër në mbarë Dibrën u zbatua me egërsi të pashoqe lufta e klasave, privimet nga punët, nga e drejta për shkollë, nga e drejta për pronë, nga e drejta për lëvizje, nga e drejta për të ruajtur besën, bujarinë, mikpritjen si cilësi e virtyte që e kanë karakterizuar shqiptarin.

Një gjest **fisnik**, bujar e **largpamës**

Nga **AGRON TUFA***

Sot është një ditë e shënuar, një ditë e gëzuar për banorët e fshatit Blliçe, për gjithë komunën e Çidhnës, për krejt Dibrën, për të gjitha ato krahina që i rezistuan dhe i mbijetuan terrorit komunist të diktaturës.

Sot i kthehet dinjiteti i mohuar gjatë gjysë shekulli të pasluftës së dytë Botërore një prej fshatrave-simbol të renzistencës antikomuniste. Qëndresa juaj, hyn sot, me dekretin e Presidentit të Republikës, në krenarinë e ligjshme të ndërgjegjes së kombit, në panteonin e nderit, sepse gjyshërit dhe prindërit tuaj u pushkatuan, u burgosën, u internuan duke mbrojtur vlerat njerëzore dhe dinjitetin njerëzor përballë egërsisë dhe gjenocidit komunist. Ky është ndër për Blliçen, Dibrën dhe Shqipërinë. Vlerë për brezat e rinj, që do të krenohen me guximin, burrërinë dhe qëndresën e të parëve tuaj.

Gjesti i Presidentit të Republikës sot, me dhënien e titullit më të lartë "Nderi i Kombit" për fshatit tuaj të martirizuar do të thotë: "Asgjë nuk është harruar, asgjë nuk duhet të harrohet, sepse sakrificat në emër të dinjitetit njerëzor duhet të shndërrohen në mësim të historisë".

Komunizmi e goditi ashpër fshatin tuaj, duke mos lënë asnjë familje pa plagë. E goditi që në kohë të luftës dhe vazhdoi ta thellojë persekutimin deri në ditën e rënies së tij.

Sipas udhëheqësve komunistë të luftës, Dibra duhej shtypur e nënshtruar.

Një muaj pas Konferencës së Labinotit, me anë të një dokumenti të datës 20 tetor 1943, Enver Hoxha shkruan në një letër drejtuar Haxhi Lleshit: "Në asnjë mënyrë të mos lejoni që përfundimet e luftës të mbarojnë me një biçim kompromisi si ky rregullim që u bë në Peshkopi në mes Parisë dhe neve. Brigada e III ka ardhur atje, që të bëjë spastrime në shkallë të gjerë në radhët e reaksionarëve. Po të paralajmërojmë, që brigada që do të kryejë këto spastrime, duhet të veprojë indipendente nga bataljonet e Dibrës. Këtë e kemi bërë për dy arsye: e para që populli të mos thotë gjë dhe të mos armiqësohet me batalionin tuej... dhe e dyta pse batalionet e vendit nuk mund të jenë aq të ashpra sa Brigada e cila përbëhet prej elementash që s'janë vendas" (dosja 53, viti 1943).

Nga një tjetër burim, po për këtë datë të 20 tetorit 1943, pikërisht në ditarin partizan të Haki Stërmillit shkruhet:



"U shpartalluen reakcionarët në Peshkopi... Ata patën 74 të vrarë përveç numrit të shituemve, kurse na patëm 13 dëshmorë e të plagosun... mes tyne Vladani nga Mali i Zi. Dëshmia e Vladanit në vendin tonë më mallëngjeu... Lufta e përbashkët kundër robnisë fashiste nuk kishte me pasë sigurim fitorjeje dhe baza të shëndosha në zemrat e popujve tanë po të mos jepeshin dëshmorë nga të dyja palët, për të njëjtën çashtje dhe në vendet e njeni-tjetrit... Edhe sot bie dëshmor nji malazes në tokën shqiptare po për atë ideal që luftojnë e bien shokët e tij shqiptarë në malet tona dhe ata të Jugosllavisë" (Fq 97, "Shtigjet e lirisë", NF 1967).

Në këto pak rreshta si minimum kuptojmë, se nuk bëhet fjalë për një luftë midis okupatorit, por për një luftë civile midis një strukture të armatosur nën udhëheqjen e komunistëve dhe popullsisë vendase. Një ushtri kundër popullit të vet.

Madje një ushtri shqiptare e përbërë qëllimshëm me "elementë që s'janë vendas", siç thuhet në letrën e Enver Hoxhës për Haxhi Lleshin, pra, prej elementësh që s'duhet të kishin mëshirë, niset sipas urdhërit të drejtuesve të luftës, të cilët, siç e dimë kanë qenë serbë, për të bërë "spastrime në shkallë të gjerë". Ky spastrim duket se ka ndodhur në të njëjtën datë me letrën e Enver Hoxhës. Haki Stërmilli numëron 73 të vrarë (reaksionarë) dhe midis 13 të vrarëve në atë betejë vëllavrasëse, i dhimbset pa masë Vladani nga Mali i Zi. Nuk e di nëse hashashi ideologjik e botëkuptimor ia ka mbajtur të mpirë trurin aq gjatë, sa edhe pas luftës të mos e dallonte këtë ndjenjë aq të panatyrshme.

Komunistët me aspektet terroriste të luftës civile në Dibër (dhe gjithkund gjetkë) hapën një çarje të madhe në historinë tonë kombëtare. Dihet se me çfarë egërsie u kthye terrori nëpër zonat e Dibrës, e në mënyrë të veçantë në fshatrat e Çidhnës fill pas instalimit të diktaturës. Ekspeditat ndëshkimore të Sigurimit të shtetit, pushkatimet në mesnatë sipas listave të zeza, burgimet, internimet, kërcënimet dhe shantazhi vazhduan me dekada, duke e deklasuar gjithë Çidhnën dhe Dibrën mbarë. Jo më kot si qark operativ i veprimtarisë së Sigurimit të shtetit, Dibra vinte fill pas Shkodrës dhe është një ndër tre rrethet me numrin më të lartë të pushkatimeve.

Mbi fshatin Blliçe, sikundër në gjithë zonën dhe krahinën, sikundër në mbarë Dibrën u zbatua me egërsi të pashoqe lufta e klasave, privimet nga punët, nga e drejta për shkollë, nga e drejta për pronë, nga e drejta për lëvizje, nga e drejta për të ruajtur besën, bujarinë, mikpritjen si cilësi e virtyte që e kanë karakterizuar shqiptarin. Komunizmi kishte programuar një gjenocid eksperimental, deri në tjetërsimin e vendit nga dhuna.

Gjesti fisnik, bujar e largpamës i Presidentit të Republikës, z. Bujar Nishani, duke e nderuar në piedestalin më të lartë të nderit fshatin Blliçe, për rezistencën në mbrojtjen e fizionomisë dhe vlerave njerëzore shqiptare, është një kurajë e madhe e njohjes dhe pohimit të të vërtetave të pathëna për diktaturën. Ky gjest sjell paqen dhe rrugën e pajtimit. Sepse vetëm nëpërmjet njohjes dhe respektimit të vuajtjes, vetëm duke vlerësuar qëndresën e asaj pjese të popullit shqiptar, të martirizuar nga gjenocidi komunist, ne mund të gjejmë mirëkuptim të përbashkët shoqëror për të ardhmen për ndërtimin e një shoqërie të lirë e demokratike europiane.

Ky gjest i presidentit, z. Nishani, duhet përshëndetur për t'u shtrirë në të gjitha ato vende ku topografia e terrorit komunist kullon gjak shqiptarësh të pafajshëm.

Ndaj, si titullar, në emër të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, por edhe si bashkëpatriot i juaj, e përshëndes këtë gjest fisnik të presidentit Nishani, i cili e drejton vemendjen dhe ndjeshmërinë e shtetit shqiptar tek këto kështjella të durimit, sakrificës dhe martirizimit kolektiv përnallë diktaturës, siç është fshati Blliçe i Krahinës së Çidhnës.

Zoti e bekoftë Blliçen u vuajtur, nderin e kombit shqiptar!

I paharrueshëm kujtimi i atyre burrave e grave të këtij fshati që mbetën viktima të diktaturës komuniste!

** Fjalë në ceremoninë e dekorimit të fshatit Blliçe me titullin "Nderi i Kombit"*

opinion

Nga fshat '**reaksionar**' në '**Nderi i Kombit**'

Nga **HYSEN REPA**

Vlerësimi që iu bë fshatit Blliçe nga z. Bujar Nishani, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me titullin e larte "Nderi i Kombit' është një borxh që shoqëria shqiptare i ka këtij fshati dhe krahinës së Çidhnës, për kalvarin e gjatë të krimeve të komunizmit.

Kam shkruar dhe më parë për Blliçen dhe kalvarin e gjenocidit komunist për 50 vjet të këtij fshati. Titulli 'fshat reaksionar" ishte titulli që i dha regjimi komunist këtij fshati, titull që e mbajti deri në vitet '90.

Ky qëndrim i regjimit për të gjithë krahinën e Çidhnës erdhi si rezultat i qëndrimit antikomunist të kësaj krahine, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Kjo krahinë pësoi dy ndëshkime dhe urrejtje të paparë si pasojë e luftës civile e vëllavrasje në korrik të vitit 1944. Pushteti komunist në vend që t'i kërkojë falje kësaj krahine për masakrën e kryer të shoqëruar me vrasje masive dhe dëme materiale të pallogaritshme, kreu hakmarrjen e dytë, duke e persekutuar nëpërmjet një terrori permanent.

Pas instalimit të shtetit komunist, në vitin 1945 u morën masa për nënshtrimin dhe fyerjen kolektive të krahinës, duke e cilësuar 'reaksionare', 'vatër e reaksionit', 'bashkëpunëtorë të fashizmit', 'bashibuzukët e Halil Alisë' etj..

Krahinën e pllakosi fukarallëku dhe zija e bukës. Djegia e shtëpive, bereqetit, ushqimit të bagëtisë dhe vrasjet e shumë burrave, qëndrimi i familjeve refugjate në zonat e tjera të Malësisë së Dibrës gjatë dimrit të acartë të vitit 1944, i kishin katandisur këto fshatra në rrënoja. Nuk bëhej fjalë për një fshat. Të tillë ishin fshatrat Blliçe, Fushë Alie, Laçes, Rrencë, Mustafej e Sinjë.

Ekipet e qeverisë komuniste, në përbërje të të cilëve ishin kryesisht ish partizanë që kishin djegur këtë krahinë, filluan reprezaljet duke arrestuar dhe pushkatuar pa gjyq, heqjen e "triskës së frontit' dhe cilësimin ' armik i popullit ' dhe burgosjet pa gjyq të atyre që, sipas tyre, 'kishin kundërshtuar me armë'. Fyerjet kolektive ishin duke ju vendosur emrat shkollave të atyre që luftuan në vëllavrasjen e kryer në verën e vitit 1944 si 'Nimete Progonati" , 'Demir Gashi' , Myslym Shyri ' etj. U sajua nga komunistët dhe një këngë fyese për gjithë Dibrën.

Populli mblidhej 'burrë për shpi' gati çdo ditë. Aty bëhej propaganda komuniste, demaskoheshin burra, ofendoheshin, merreshin nën arrest pa shkak në sytë e fëmijëve etj. Asnjë ndihmë ekonomike e materiale nuk ju dha kësaj krahine. Taksat dhe konfiskimet ishin të larta dhe tendencioze për t'ju marrë dhe ato që u kishin ngelë nga djegia e shkretimi i luftës. Për t'i turpëruar dhe ulur moralisht, burrat, kur i arrestonin, i lidhnin me litar para mbledhjes ose i lenin të lidhur gjithë natën tek qendra e fshatit. Operativët e Sigurimit dhe 'pushkatarët', bridhnin natë e ditë skutave e nën dritaret e shtëpive për të kontrolluar dhe vëzhguar çdo lëvizje. Nën këtë presion permanent, rruga e vetme ishte largimi jashtë kufijve, pavarësisht se e dinin se dhe në Jugosllavi i priste një kalvar tjetër i pyetjeve, provokimeve dhe burgosjeve. Serbët nuk ua falnin burrave të kësaj krahine luftërat që kishin bërë në Çidhën dhe humbjet që patën për tre luftëra rresht (1913, 1918 dhe 1920-21). Deri në fund të viteve '48 kishte marrëveshje midis shteteve për kthimin e të ikurve. Pas vitit 1948, kur u prishën marrëdhëniet me Jugosllavinë, ikjet në kufi u bënë masive. Fise të tëra me gra, fëmijë, burra e pleq u larguan duke lënë shumë të vrarë e të plagosur në kufi. Grama dhe Shkalla e Desheve , Sketeci etj., u lanë me gjak.

Një fushatë tjetër përndjekjesh filloi gjatë kolektivizimit, ose më mirë me thënë, të shtetëzimit të tokës. Kolektivizimi u përjetua shumë keq nga banorët e Çidhnës. Për atë tokë që kishin luftuar e derdhë gjak, tani po e dorëzonin me një firmë. U dyndën dhe njëherë ekipe të Partisë, duke bërë presion, e duke ju heq triskën e frontit, duke i deklaruar 'kulak dhe armik i klasës'. Shumica e të rinjve që mbaronin shkollën 7 vjeçare nuk ju jepej e drejtë studimi për 'arsye biografie" apo se nuk kishin triskën e frontit. Por djemtë dhe vajzat e Blliçes dhe Çidhnës, vazhduan të shkollohen si të jashtëm në gjimnazet e Peshkopisë, duke bërë në këmbë me nga 4-5 orë në ditë. Po formohej një brez intelektualësh të zotë.

Pas vitit 1967, me thellimin e luftës së klasave dhe shfaqjeve të huaja, Blliçja, Laçesa dhe Fushë Alie u përfshinë në një tjetër persekutim. Filloi gjuetia e shtrigave, kishte hyrë në fuqi ligji për "agjitacion dhe propagandë".

Periudha 1970-1975 ka qenë kulmi i ashpërsimit të luftës së klasave. Gati çdo ditë Gazi me targë 01 (vetura e Degës së Punëve të Brendshme) 'shëtiste' nëpër rrugët e Blliçes, Laçes e Fushë Alie, duke marrë me vete të dyshuar. Kinemaja e Peshkopisë u kthye në një sallë gjyqi inkuizicioni. Thirreshin dhe dëshmonin 'dëshmitarë" të sajuar, mundësisht brenda familjes dhe farefisit, për të thelluar përçarjen midis fshatarëve dhe fisit. Ishte krijuar një gjendje ankthi dhe frike. Arrestimet e bujshme u shoqëruan dhe me ikje të bujshme në kufi, ku pati dhe përpjekje me armë dhe ku mbetën të vrarë disa fshatarë.

Krahina e Çidhnës dhe Blliçja nuk e pushuan për 50 vjet rezistencën antikomuniste, duke u rreshtuar në pararojën e qëndresës antikomuniste në Shqipëri.

Brezat e rinj do të jenë krenarë për të parët e tyre për këtë rezistencë dhe kalvar të gjatë të regjimit komunist.

E gëzofshi medaljen e lartë "NDERI I KOMBIT"!

Rruga e Arbërit nr. 108

Të mbrojmë dhe të ruajmë monumentet natyrore dhe kulturore të mbrojtura me ligj.

Çidhën, **monumentet** e natyrës **në rrezik**

Nga **ISLAM CANI**

Çidhna, djepi i qytetërimit, strehë e Dibrës që në lashtësi, qyteti princave dhe mbretërve ilirë, vendlindja e Heroit Kombëtar Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, vendi me pozicionin strategjik në mbrojtje, vendi i bukurisë, i perlave të natyrës e sot ndodhet në rrezik të humbasë identitetin saj historik. Çidhna e Dibrës me burimet ujore, natyrore e kulturore, historike e arkeologjike si kudo në Shqipëri janë nga më të rrallat në Europë.

Malet dhe pyjet zënë pjesën më të madhe të territorit dhe janë ato me lartësinë dhe bukurinë e tyre perfekte për zhvillimin e turizmit, sidomos pjesa dhe lugina e Setës; me ujërat e shumta, me ajrin e pastër, ujëra me gurra e kroje si dhe një biodiversitet tepër të zhvilluar.

Çidhna e monumenteve të shumta natyrore, me vendbanimet dhe vendstrehimet shekullore, shpella e kala, fortifikime, e pika mbrojtëse, me objekte ose pjesë veprash ndërtimore (me mure, kalldrëme, punime zejtare, artistike) me gjurmë arkeologjike, të cilat vërtetojnë se i përkasin kohërave të ndryshme të historisë duke filluar nga prehistoria, antikiteti e deri në mesjetë.

Ç'PO NDODH NË TERRITORIN TOKËSOR E LUMOR TË ÇIDHNËS?

Monumente natyrore ujore, historike po rënkojnë, në mënyrë të veçantë Seta bujare, e ngrohtë, strehuese e qindra dibranëve në kohëra të ndryshme, që sot po e thajnë po e bëjnë skelet e po i marrin shpirtin! Seta (Artatusi), një vendburimor, por edhe një vendstrehim i sigurtë në kohëra lufte e banorëve të Çidhnës dhe Dibrës. Seta me burimet e Çidhnës janë dhe do të jenë domosdoshmëri për të siguruar ujin e pijshëm, por dhe për zhvillimin e turizmit në këtë zonë me bukuri mahnitëse.

Çidhnës turistike i janë vërsulur kasapët e zhdukjes së monumenteve natyrore, të identitetit të historisë dhe arkeologjisë, me ndërtimin e Hec-ve, duke mbuluar të vërtetat historike. Çdo ditë po grumbullohen dhe largohen ujërat, po rrënohen monumentet, po dëmtohen sipërfaqe të shumta toke, të cilat janë miniera të arkeologjisë, historike, po humbet emri, puna, lufta, qytetërimi i Oenës qytet i lashtësisë, po humbet autonomia e Çidhnës edhe e Dibrës së Ilirisë.



Nëse nuk i pritet rruga kasapëve që presin, therin dhe të gatuajnë gjellën e preferuar me monumentet e Çidhnës atëherë dëmtohet Seta, thahen ujërat, dëmtohet e gjithë Çidhna; i pritet rruga zhvillimit turistik, i pritet rruga mirëqenies së vetë çidhnakëve, humbasin gjurmët arkeologjisë zhduken e bashkë me to humbet identiteti ynë historik.

Do të ishte më mirë që këto investime të investitorëve private për të ndërtuar Hec-et, që prishin dhe shkatërrojnë burimet ujore të Çidhnës të bëheshin për investimin e zhvillimit e turizmit malor në grykën e Setës në interes të zhvillimit ekonomik-kulturor.

Nëse nuk zbatohen ligjet për mbrojtjen e këtyre zonave të shpalluar monumente natyrore dhe ju lihet rrugë e lirë këtyre kasapëve të Hec-eve, do përjetojmë rrënimin e tokës dhe të tharjes së ujërave. Me apo pa dashje po i heqin identitetin e saj, e cila është e lidhur ngushtë me Çidhnën, Dibrën dhe historinë tonë kombëtare.

Në të tilla situate: çdo heshtje zyrtare të organeve përkatëse, e pushtetit lokal, apo të peronave të mashtruar nga firma private shkatërruese s'do bëjë gjë tjetër, por Çidhnës së shqiponjave do i priten krahët, i groposin identitetin e saj turistik, historik, gjeografik, kulturor e arkeologjik.

Organet dhe personat përgjegjës në bazë dhe në qendër kudo që janë duhet të zgjohen nga letargjia për të mënjanuar këtë rrezik që po i kanoset Çidhnës me dëmtime të rënda të sipërfaqes së tokës dhe të monumenteve të saj deri në humbjen e identitetit Dibran.

Sot, populli i Çidhnës kërkon me forcën e shpirtit dhe të ndjenjës kombëtare që një herë e përgjithmonë të marrë fund livadhisja e zaptueseve të ujërave, vendeve burimore, shpellave e varreve, vendeve arkeologjike. Këtë e tregon qartë me peticionet e tyre të shprehura me emra dhe numrat e identifikimit sipas kartës së identitetin personal.

Nuk është e tepërt të citoj ligjin "Për Zonat e Mbrojtura" nr. 8906. datë, 6.6.2002 I azhornuar me ligjin nr. 9868. dt, 4.2.2008 si dhe VKM: Nr. 676, dt. 20.02.2002 "Për Shpalljen Zonë e Mbrojtur të monumenteve të natyrës".

Në Çidhën kemi këto monumente të natyrës që mbrohen me ligj: Gryka e Setës (pjesa më e ngushtë dhe më e thellë); Shpella e Qytezës (qytetit); Burimi i Soponikës; Shpella e Soponikës dhe e Klloxhneshës. Ka dhe shumë vende e shpella të tjera që burimet e tyre shkojnë në Setë si shpella e Qaf Lerës, Sh. Akullit, Sh. Rusit në Grykë Nokë dhe shumë burime të tjera që shkatërrohen nga tharja e Setës.

Ç'janë këto persona kundër ligjeve dhe VKM –ve, po nga ana tjetër përse heshtin organet drejtuese zbatuese të ligjit?

Çidhna ka patur shqetësime të vazhdueshme nga këto kasapë, por kohët e fundit është tronditur rëndë. Nga ky fshat i vogël i Çidhnës, ku përfshihet dhe Arrasi e Sina, Kodër Leshe si grykë e Setës janë njëkohësisht të shqetësuar dhe të alarmuar e gjithë krahina, por në listat e peticionit unë kam në dorë emrat e 210 çidhnakëve që kërkojnë mbrojtje ligjore të Setës.

Për këto shqetësime e dhimbje populli i drejtohet me të gjitha format dhe mënyrat e komunikimit këtyre institucioneve shtetërore e akademike që mbrojnë monumentet natyrore e kulturore të shpallura me ligj. Çidhnakët i kanë drejtuar peticione kundër dëmtimit të këtyre monumenteve nga firmat private dhe kërkojnë mbështetje ligjore nga ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë, Qarku Dibër, Komuna Arras, Agjencitë mjedisore, Akademia e Shkencave, Instituti i Monumenteve, ai i Arkeologjisë, Instituti i Kulturës Popullore, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

Çidhnakët i janë drejtuar organeve të pushtetit lokal, jo vetëm të Peshkopisë, por dhe fqinjëve Bulqizë, Burrel, që të reagojnë me forcë dhe të larguar duart dhe veprimin e këtyre kasapëve që po cënojnë ujërat e Setës, dhe njëherazi dëmtojnë e zhdukin vlerat dhe pasuritë ujore.

Do shpresonim se shumë shpejt do të marrim përgjigje nga organet shtetërore kompetentë si dhe Komuna dhe Këshilli i komunës Arras të Çidhnës. Pse heshtin, apo ka ndonjë që pajtohet me të keqen e këtij vendi?

***

Për lexuesit mbarë do të doja të radhisja disa fakte të pamohueshme mbi vlerat e Çidhnës qytet në lashtësi, tani një fshat i vogël, por me histori me monumente të rralla natyrore, kulturore, arkeologjike që presin mbrojtje nga të gjithë:

Çidhna (Oena) qytet e ka nisur jetën e saj 2.500 para Krishtit, të dhëna këto të bazuara sipas gjetjeve arkeologjike që i takojnë epokës së bronxit. Historianë të huaj dhe vendas shkruajnë për Çidhnën si qytet i penestisë sikurse e radhit K. Frashëri kur shkruan për Historinë e Dibrës citon; në tre vendbanimet e mëdha peneste ishin; Uskana, Draudaku dhe Oena (Çidhna), së bashku me lumin Seta (Artatus).

Çidhna me 2 Kalatë e saj. Njëra kalaja që mbronte qytetin dhe tjetra që mbronte Oenën që përfshinte si hapësirë vrojtimi Dibrën, Matin, Lumën e më gjerë deri ne Prizren. Çidhna lidhej si rrjeti i merimangës në çdo kohë me kalatë dhe qytetet e qytezat e si brenda dhe jashtë saj.

Çidhna me 56 rrugë të brendshme me Dibrën, përfshirë këtu rrugët për në Shkodër e Durrësit, por dhe 6 rrugë që komunikonin me territore te tjera shqiptare Prizrenin, Shkupin etj.

Çidhna me monumente të shumta natyrore relativisht me mbi 175 të tilla. Çidhna me 41 monumente kulturore e fetare. Çidhna me 24 qendra e gjurmë arkeologjike duke përfshirë rrënojat e kalave, muret rrethuese, rrugët e kalldrëmet, varrezat monumentale, kishat e xhamiat, puset, etj. Çidhna me toponime që ruajnë në kujtesën e tyre historinë që nga lashtësia por në kujtesën radhis mbi 145 toponime me vlera historike të trashëguara në shekuj.

Ky vend nuk duhet prishur me hec-e, por të kontribuojmë për zhvillimin e turizmit dhe të gjallërohet ekonomia dhe mirëqenia e çdo familje, të tërheqim turistët vendas e të huaj me mrekullinë natyrore që na ka falë Zoti.

Jemi vendi me natyrë e histori të gjallë, me kulturë, arkeologji, me monumente kulturore e artistike që na kanë zili fqinjët dhe turistët, kanë ç'të shohin dhe të flasin për Çidhnën turistike.

"Ora e tokës" në Bulqizë



Shoqata Ekspertët e Rinj Mjedisor (SHERM) në kuadër të veprimtarisë "Ora e Tokës 2015" është bërë pjesë e kësaj nisme, në bashkëpunimin me ANEP-Shoqata për Politika të Reja të Mjedisit, e cila në 28 Mars organizoi disa veprimtari në Tiranë, Shkodër, Vlorë, Pogradec, Korçë, Bulqizë, Lezhë, etj, gjatë paradites dhe në orët e mbrëmjes.

Për herë të parë "Ora e Tokës" në Bulqizë u organizua nga Danjel Bica, koordinator i Earth Hour 2015 dhe Drejtor Ekzekutiv i SHERM.

Më 28 Mars, në orën 20:30 deri në 21:30 i gjithë planeti "u fik" për 1 orë, sipas fashave orare, duke filluar nga Australia e deri në Kaliforni. Ky është cilësuar si "aksioni më i madh dhe më masiv mjedisor që historia ka njohur ndonjëherë". Secili prej nesh, si çdo qytetar i botës, ka rolin e vet aktiv në përpjekjen globale kundër ndryshimeve klimatike, edhe me veprime të thjeshta si ky i nxitur nga "Ora e Tokës".

"Ora e Tokës" ka lindur si një iniciativë në vitin 2007 në Sidnej dhe çdo vit e ka zgjeruar përkrahjen e saj në botë. Ky është një event global dhe aktiviteti mjedisor me pjesëmarrje më masive në botë. Çdo 1 ndër 3 banorë të Tokës do të fikin dritat dhe gjithë aparaturat e tepërta elektronike nëpër shtëpitë apo bizneset e tyre. Kjo është "Ora e Tokes - Earth Hour", ora të cilën ne njerëzit ia kushtojmë shtëpisë sonë të përbashkët, Tokës, në një veprim sa simbolik, sensibilizues, aq edhe efikas e të fortë kundër ndryshimeve klimatike, qe po ia marrin frymën asaj. Në "Earth Hour 2014" morën pjesë 7000 qytete nga e gjithë bota, në mbi 152 vende, dhe me mbi 2 miliardë përkrahës apo pjesëmarrës vullnetarë.

"Ora e Tokes 2015" është viti i shtatë i pjesëmarrjes për Shqipërinë dhe i pari për Bulqizën. Shoqata Ekspertet e Rinje Mjedisor organizoj disa aktivitete si: realizimin e disa takimeve në Shkollat e Mesme dhe 9-Vjeçare të Bulqizës, prezantimin e Ndryshimeve klimaterike për nxënësit.

Më 28 Mars, në orën 10, vazhdimin e aktivitetit tek Qendra Kulturore Bulqizë për Fushatën e firmosjes publike të Ambasadorëve të Orës së Tokës dhe me personalitetete të Bulqizes "Edhe Unë Për Orën e Tokës", që është shprehja personale e çdo qytetari për pjesëmarrje.

Dhe në orën 20:30 deri në 21:30 u realizua fikja e dritave në të gjithë qytetin, ku u realizuan me pamje filmike.

Kjo iniciative në Shqipëri koordinohet nga "ANEP - Shoqata për Politika të Reja të Mjedisit" me vullnetarët e saj, dhe me mbështetjen morale të "Ambasadorëve" të Orës së Tokës në Shqipëri.

Logjika qëndron në lidhjen e drejtpërdrejtë që ekziston midis energjisë që ne përdorim dhe ndryshimeve klimatike që po ndodhin: konsumi i energjisë është përgjegjës për mbi 60 % të shkarkimeve të CO2 në atmosferë, e rrjedhimisht kursimi i energjisë është veprim, që kontribuon drejtpërdrejt në reduktimin e shkarkimeve të gazrave serrë. Ndërtesat më të famshme në të gjithë Botën do të fikin dritat gjatë Orës së Tokës, ndërkohë që mbështetësit e Orës së Tokës do të promovojnë zgjodhjet për të ndryshuar Ndryshimin e Klimës.

Nga nisma "Kredia e Orës së Tokës", që mbështesin instalimet e paneleve për shfrytëzimin e energjisë diellore e deri tek nisma " Pyjet e Orës së Tokës që mbështesin luftën kundër shpyllëzimit.

Njerëzit japin kontributin modest për të kursyer: dioksidin e karbonit që emeton në atmosferë prodhimi i energjisë elektrike, si dhe për të treguar se ne duam qëndrime të menjëhershme kundër ndryshimeve klimatike.

Kjo, sepse protokolli i Kyotos e ka identifikuar rritjen e efiçencës së energjisë si njërën nga rrugët më të shkëlqyera për të ulur lëshimet e dioksidit të karbonit në atmosferë.

Korresp. Rr.A.

ese

Ajo ç'ka realisht na nevojitet në shekullin të cilin e jetojmë, është që të mos bëjmë heronj vetëm ata që me pushtet bënë gjithçka të keqe, përfshirë keqqeverisje, masakra mbi civilë, dënime me sistem taksash etj, por të vlerësojmë sidomos ata të cilët e luftuan me shpirt padrejtësinë.

Rrefimet e Mondit



Nga
EDMOND HASANI

Morgu

Është një lulishte e bukur kjo e morgut. Rrufis kafen, instinktivisht ndjej shikimin e Runjës plot borë dhe shalli i mjegullt i Drinit më thotë se lumi qenka me grip! Ndjej pas frymën e dikujt: është ajo gruaja që vari veten në litar dje e që qenka ngritur nga tavolina prej çimentoje e autopsisë! Me sy kërkon të ulet pranë meje por nuk ja kam ngenë!

Zakonisht nuk jam harbut, sidomos me femrat por shenja e litarit në qafe nuk më josh aspak. Nëse do kishte ndonjë plagë do isha tolerant me të ndjerën! Puna në morg me relakson, më tërheq e kur kam nge intervistoj morgistët shtrirë në sirtarë, por ka raste kur edhe debatoj me ta!

Një natë, një eskavatorist, m'u ankua se nuk ja kisha qepur sipas modës çarjen që i bëra në bark, dhe më e bukura ishte, se më tha se kisha nevojë për testim!

Një prostitutë që kish humbur jetën duke abortuar me një shtizë jo edhe aq të ndryshkur më doli në krah, duke akuzuar eskavatoristin si pijanec! Mbase akoma mbante mend se para shtatzanimit të saj me një roje nate pularie, ishte puthur gabimisht me mua në çastin e ndërrimit të viteve, në një party!...

Sot nga dreka morgu do jetë bosh e kjo më mërzit! Mezi pres banoret e rinj, tamam si qeraxhinjtë e dhomave të plazhit që pronarët i presin me padurim me ca kartona në duar në rrugë!

Kemi morg me qera!

USHTARI

Ishte ndryshe nga ushtarët e tjerë. Bjond, i qeshur, me një fije shkrepse në cep të buzës kur nuk kishte cigare dhe me zarfa e fotografi sexy bardhezi të yjeve italiane të kinemasë së viteve '50-'60, futur në xhepat e xhaketës ushtarake.

Isha fëmijë dhe pasioni kolektiv për të mbledhur pulla poste na çonte tek telat rrethues të repartit ushtarak, pranë fushës së futbollit. Vili, ushtari tiranas, me kapelen mbi sy, pak anash, ishte bujar me ne dhe shpesh na jepte pullat që hiqte nga zarfat e letrave të dashnoreve të tij të shumta, siç thoshte, se i kishte në çdo qytet të vendit. Vërshëllente gjithmonë Parla piu piano te Patricio Buanese që ato vite ishte hit botëror, këndonte nën zë Il rragazzo della via Gluck, të Çelentanos dhe unë që ndiqja San Remon me babin, magjepsesha nga zeri i ëmbël i ushtarit.

Vili ishte qejfli femrash dhe një ditë më dha një pusullë që t'ia çoja një konviktoreje të shkollës bujqësore. Mbaj mend se kur Dranja mori letrën më puthi e entuziazmuar në faqe e unë për herë të parë ndjeva aromën e femrës, aromë që s'do më ndahej tërë jetës!

Kaluan vite! Një ditë të nxehtë gushti të vitit 1997, teksa punoja te fabrika e reçelit mes një morie femrash, dëgjova Parla piu pianon e famshme! Nga kabina e makinës që ngarkohej me kavanoza reçeli vërshëllente ish ushtari Vil, duke parë i kënaqur ca kofshë të bardha punëtoreje që, si rastësisht, ishin zbuluar mbi ca arka të vjetra marmalate.

E njoha menjëherë kurvarin e këndshëm, por nuk i dhashë të njohur!

Jeta ecte e qete e ndonjëherë turbullirat rinore ma zbukuronin, ma trondisnin! Nga mesi i viteve '80, një ditë plot shi pranveror, në intervalin mes ca puthjesh me të dashurën studente, për t'u strehuar vajtëm te dera me strehë e morgut të vjetër të spitalit ku studionim. Po qeshnim, prekeshim, putheshim me zhurmë e nuk e kishim vënë re fare se dera ishte hapur. E tërhoqa vajzën brenda korridorit i kureshtuar nga dera harruar hapur, qetësia dhe misteri i natyrshëm i morgjeve! Kishim pirë ca konjak dhe ajo qeshte si histerike dhe ideja se mund të benim seks mbi një shtrat morgu m'u duk normale! Hapa një dere andej nga fundi i korridorit, pranë një ËC ku pikonte vazhdimisht, ritmikisht ujë! Hyra brenda dhomës gjysëm të errët! Një shtrat i madh çimentoje, betoni mbase, ishte në mes e mbi të format njerëzore mbuluar me çarçaf! Adrenalina ishte në kulm! Ajo ju afrua shtratit me sytë nga unë! Afrohem dhe instinktivisht zbuloj trupin! Klitha pa zë, pastaj me fort, mbylla gojën me dorë! Duke vrapuar në korridor pas vajzës së tromaksur dëgjoja zërin e ëmbël të ushtarit; Parla piu piano, Mondi!

Të nesërmen në leksion të reumatologjisë profesori plak na tregoi se bukëpjekësi i lagjes Vili ishte mbytur në det teksa varka me të cilën do arratisej kishte marrë ujë!



Koncert artistik në bulevard.
Foto: © E.Hasani

ESE

Kush jam une ?



Nga
ARJETA TAFÇIU

Më vrisnin zhurmat shurdhuese të fjalëve të pafund të njerëzve, të jetuarit e vrullshëm, gjithçka që më rrethonte... Në realitetin në të cilin gjendesha e konsideroja veten të humbur, delikate, të pambrojtur, gjë të thyeshme lehtësisht e padrejtësisht.

Kisha nevojë të njihesha me veten! Pasqyra nuk më reflektonte këtë njohje.

Kush jam unë? Ishte kjo pyetja triumfatore që më përballi me shtigje të panjohura të cilat gjendeshin brenda meje. Vazhdimisht e bëja këtë pyetje, por zëri i ndërgjegjes sime ishte akoma shumë i dobët. Nuk arrija ta dëgjoja! Fillova të lundroja ujëra të turbullta e të kristalta, që çdo kush i ka brenda vetes. Por, fatkeqësisht pjesa më e madhe e tyre qëndron e paeksploruar nga ne.

Sa pak e njohim veten, mendova! Njeriu është kaq universal dhe unik në të njëjtën kohë. Burim i pashterur pasurish! Kjo qenie e mrekullueshme, e krijuar në mënyrë kaq perfekte, po të merret pak më shumë me veten do mbetet i mahnitur me të! Por, çfarë e pengon vallë?! Rutina e përditshmërisë, këndvështrimi i gjërave nga syri i të tjerëve, apo mendja e tij e mbyllur?

Mendja! Pikërisht këtu ndalova për një moment. Kurrsesi nuk mund ta kuptoj funksionimin e saj, por mund të kujdesem për të, ta trajtoj atë me kujdes. Ajo është burimi më i madh i përcjelljes së emocioneve për në zemrën time, në shpirtin tim. Dhe nëse zemra është e qetë trupi ka shëndet! Mendja... vendbanimi i përhershëm i logjikes, i arsyetimit. Kjo duhet vënë në punë e shfrytëzuar për të jetuar të vërtetën, për të qëndruar larg abstraksioneve, iluzioneve apo intrigave të kota.

Ngre kokën lart në qiell e më duket aq i pafund... Hedh vështrimin tutje në horizont, gjithçka shtrihet në një rregullsi perfekte. Meditoj në vështrimin e bimëve, pemëve e gjithçka që më kap syri... secili në punën e vet duke zbatuar me përpikmëri qëllimin për të cilin janë krijuar. Çdo gjë në Tokë në shërbim të njeriut!

Po ti o njeri, vallë pse je krijuar? Mos ndoshta për të shfrytëzuar në mënyrë kryeneçe këto gjallesa që gjenden përreth teje, për të ndërvepruar si të duash me to apo dhe me qeniet e llojit tënd? Jo! Është e padrejtë!

Medito pak! Nga erdhi gjithë kjo rregullsi, nga erdhi gjithë ky univers, nga erdhe ti o njeri? Si ka mundësi të mos e kuptosh që ti nuk je një rastësi, por një qëllim në vetvete? A nuk duhet të falënderosh me përulësi për të gjithë këto mrekulli në mes të të cilave gjendesh? Dhe të gjitha janë për ty. Po, po TË GJITHA! Pse tregohesh kaq egoist me veten? Kuptoje, gjykoje dhe vlerësoje veten njeri i dashur, PARA SE TA BËJË KËTË DIKUSH TJETËR!!! Vetëm kështu do të jetosh i lumtur në Tokë, e përtej saj!

Balada e Drinit



Nga
DIONIS XHAFA

Ajo ç'ka bie në sy dhe vihet re në përgjithësi në historiografi, sidomos në atë të Ballkanit, është fakti se heronj të historisë na paraqiten vetëm të gjithëpushtetshmit, që jo në pak raste janë edhe tiranë, të cilët edhe mund t'ia kenë nxirë jetën popullit që e kanë drejtuar. Historia mësohet sipas këtij modeli jo pak në Shqipëri, por edhe më keqas mësohet në shtetet e banuara kryesisht nga sllavët, sidomos në Serbi, por edhe në Maqedoni, ku figurat politike apo historike më të gjithëpushtetshmit ngrihen lart.

Ajo ç'ka realisht na nevojitet në shekullin të cilin e jetojmë, është që të mos bëjmë heronj vetëm ata që me pushtet bënë gjithçka të keqe, përfshirë keqqeverisje, masakra mbi civilë, dënime me sistem taksash etj, por të vlerësojmë sidomos ata të cilët e luftuan me shpirt padrejtësinë.

Duke i hedhur një sy historisë së Dibrës, veç figurash të tjera kemi dhe një person, i cili e ka luftuar me shpirt ndër dhëmbë ç'njerëzoren, masakrat mbi civilët, barbaritë.

Ky ishte Ismail Strazimiri, i cili e kishte parë me sytë e vet masakrën e serbëve dhe për to do të linte edhe letra prekëse, sesi vriteshin e masakroheshin shqiptarët.

Ishte koha kur Serbia ishte mjaft agresive, kishte mobilizuar fuqinë ushtarake dhe se po dëshmonte vetëm dhunë, presion dhe represion të vazhdueshëm. Me politikën e vet diktuese dhe dhunuese, Serbia kishte hyrë thellë deri në zona të jugut të Shqipërisë, deri në fshatra të Myzeqesë. Ishin vendimet e marra në Konferencën e Londrës, ata që zmbrapsën Serbinë në veri të Shqipërisë dhe forcat e saj u përqendruan kryesisht në Dibër, Kosovë dhe troje të tjera të lëna jashtë territorit të shtetit të pavarur shqiptar, shkruan Fatos Baxhaku në një artikull të tij me titull "Pushtimi i Dibrës". Në shkrimin e gazetarit në fjalë thuhet se në testamentin e Ismail Strazimirit flitet për krime kundër qytetarëve të Dibrës, kundër tregtarëve dhe kundër parisë së vendit.

Ishin këto masakra të shtetit serb, por edhe taksimi tejet i rëndë, që detyruan shumë dibranë, të braktisin Dibrën dhe të jenë sot në Tiranë, ku dhe kanë krijuar një lagje të tyren. Dibra u vu nën thundrën serbe dhe pasojat e kësaj ishin të gjithanshme.

Përveç humbjes së qytetit, ishin edhe dëmet ekonomike tejet të rënda që iu shkaktuan dibranëve dhe Dibrës. Një artikull i BIRN me titull "Fanazma e Shqipërisë së Madhe nuk ikën sepse kufijtë e vitit 1913 janë të gabuar, theksonte se Dibra dhe Gjakova, të mbetura jashtë kufijve të shtetit shqiptar, pësuan dëme të mëdha edhe në ekonomi.

Kjo, për shkak se rrethinat e Dibrës, të lidhura në marrëdhënie tregtare të ngushta me qytetin, e ndërprenë aktivitetin tregtar. Ndërkohë që tregtarët e zhvillonin tregtinë në Dibër, u detyruan të ngrenë një tjetër qytet, Peshkopinë për të zhvilluar tregtinë, ç'ka pati pasoja katastrofale në ekonomi, pasi tregtia edhe u degëzua sipas fshatrave të krahinës.

Gjithsesi, për tu kthyer tek personazhi i Ismail Strazimirit. Mund të thuhet se Ismaili nuk është i vetëm. Ai është mishërimi i atyre dibranëve, që u përndoqën dhe u vranë e u masakruan nga regjimi serb. Ismaili është njeriu që e lufton padrejtësinë, mizorinë, barbarinë dhe diktatin e huaj deri në vetësakrifikim. Ismaili janë të gjithë dibranët e ndershëm e atdhetarë, ata që përpara pasurisë kanë vënë kombin, lirinë e përgjithshme dhe kanë rezistuar përballë padrejtësive

Më 22 prill 2015, në Gjoricë, u prezantua libri i autorëve Qemal Osmani dhe Shaqir Skarra "Gjorica, fshati midis ujërave".

LIBRI, PASAPORTA MË E MIRË E GJORICËS DHE NJERËZVE TË SAJ

Më 22 prill 2015, në një lokal në qendër qendër të Gjoricës, nën kujdesin e kryetarit të komunës, Vehbi Xheka, u prezantua libri i autorëve Qemal Osmani dhe Shaqir Skarra "Gjorica, fshati midis ujërave".

Në këtë veprimtari, përveç banorëve të zonës, merrnin pjesë edhe personalitete dhe bij të kësaj krahine, të cilët kontribuojnë në fusha të ndryshme të jetës publike. Mes të cilëve, ishte Shpëtim Cami, kryetar i njësisë bashkiake nr. 1 në Tiranë, Ligor Nikolla, pedagog, dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike, prefekti i Dibrës Melaim Damzi, njëkohësisht edhe kandidat për kryetar bashkie në Bulqizë, djali i kësaj zone, Ilir Krosi, aktualisht kryetar i bashkisë Peshkopi dhe kandidat për bashkinë e Dibrës, etj.

Vehbi Xheka, gjatë fjalës së tij hyrëse vlerësoi autorët për kontributin e tyre në përgatitjen dhe botimin e këtij libri si dhe bëri një panoramë të komunës së Gjoricës, duke evidentuar vlerat e banorëve të kësaj zone: mikpritjen dhe harmoninë.

Një vështrim të hollësishëm mbi librin e bëri Dr. Shpëtim Cami, i cili e vuri theksin në evidentimin që ky botim i bën vlerave historike, gjeografike, kulturore dhe shkencore të krahinës së Gjoricës.

Ligor Nikolla solli detaje nga fëmijëria mbi lidhjet e familjes së tij me këtë fshat. Gjergj Ndoj, një ish oficer në postën e Gjoricës në periudhën e regjimit komunist, solli kujtimet nga jeta e tij në këtë fshat, ndërsa Ardit Kaja, ish deputet i Bulqizës, falënderoi autorët mbi punën e tyre të shkëlqyer.

Të pranishmit e tjerë që morën fjalën, mes të cilëve edhe Krosi dhe Damzi, theksuan rëndësinë e këtij botimi për krahinën e Gjoricës si dhe hapësirat dhe mundësitë që krijon libri për një studim më të thelluar të kësaj zone me rëndësi të madhe historike dhe ekonomike për gjithë Dibrën.

Hasan Çela, banor i këtij fshati, një nga kontributorët gjatë fazës së shkrimit të librit, falënderoi autorët dhe vlerësoi librin, si një pasaportë e mirë e Gjoricës.

"Qemal Osmani, edhe me ndihmën e z. Skarra, ka bërë një punë të lavdërueshme që do t'u mbetet brezave: u ka bërë të ditur njerëzve se cila është Gjorica: një fshat mes ujërash, i hershëm prej mijëravjetësh, që ka luajtur një rol të rëndësishëm në historinë e vjetër dhe të re të Dibrës, që njihet për Kuvendet dhe betejat kundër pushtuesve, që ka pasur një unitet mes njerëzve, me anët të të cilit kanë ditur të gjejnë rrugë e mbijetesës në një luftë të ashpër klasash, që ka përjetuar njërën ndër padrejtësitë shekullore të shqiptarëve: ndarjen e kufijve...", tha në përshëndetjen e tij, përfaqësuesi i shtëpisë botuese "M&B", Bujar Karoshi. "Në këtë libër është edhe kontributi i gjoricasve për arsimin, kulturën, sportin, shëndetësinë, por edhe janë veçuar disa portrete njerëzish që janë rritur mes jush, por kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në jetën e kësaj krahine", theksoi botuesi i librit.

Në fund, pas përshëndetjes së autorëve Osmani dhe Skarra, gjatë një koktej të shtruar me këtë rast, autorët nënshkruan libra për lexuesit.

Korresp. Rr.A.



Gjorica, fshati midis ujërave

Nga **SHPËTIM CAMI**

Për të folur për një libër ka disa këndvështrime si për autorët ashtu edhe për përmbajtjen e tij, pasi shpesh përmbajtja ka lidhje me autorin ose anasjelltas. Njëri prej autorëve Dr. Qemal Osmani, financues i librit dhe bir i këtij fshati, ka ditur të gjejë një bashkëpunëtor me përvojë ne fushën e botimeve dhe të publicistikës siç është z. Shaqir Skarra, pjesë e stafit botues të gazetës " Rruga e Arbërit". Në kopertinën e librit gjejmë të dhëna të mjaftueshme për të dy autorët. Si bletë punëtore ata kanë arritur të sjellin në duart tona një informacion të konsiderueshëm për historinë, gjeografinë, kulturën dhe traditën tonë

Titulli i librit është një emërtim gjeografik referuar faktit që Gjorica ndodhet midis lumit Drin dhe Zallit duke i dhenë të kuptojë lexuesit që në titull pozitën tonë gjeografike. Libri fillon me pak histori të Dibrës, pjesë e të cilës është edhe komuna jonë për të vazhduar më tej me pozitën gjeografike, klimën dhe popullsinë e fshatit Gjoricë.

Me popullsinë e fshatit autorët merren gjatë duke përdorur shumë referenca që fillojnë në shekullin II-IV dhe XI-XII, me zbulimet e varreve shekullorë në "Maj –Meje" të Gjoricës së poshtme, me ndërtimin e Kishës nga Fatbardh Pali, në vitin 1380, për të vazhduar me shtatë referenca të tjera qe pasqyrojnë të dhëna dhe dokumente të vitit 1467 të defterëve të perandorisë turke ku Gjorica e poshtme na jepet si tokë e pabanuar, ndërsa Gjorica e sipërme kishte vetëm dy shtëpi. Referenca e dytë ka të dhëna për taksat e paguara në vitin 1583 nga banorët e fshatrave të komunës së sotme, pra 106 vjet më vonë, referenca e tretë daton 1653 po nga defterët e perandorisë turke, rreth 200 vjet më vonë me 45 shtëpi. Referenca e katërt është e vitit 1916, 260 vjet më vonë nga regjistrime të perandorisë austro-hungareze ku popullsia është në rritje duke kapur shifrën 191 shtëpi. Referenca e pestë i takon vitit 1980 ku dy Gjoricat së bashku kanë 870 familje, në vitin 1990 numërohen 810 familje dhe referenca e fundit konsideron vitin 2014, vit në të cilin fshati ka 720 familje.

Këto të dhëna librit I japin një karakter shkencor, por dhe të hapur për studiues të tjerë për ta pasuruar më referenca të reja të periudhave të panjohura si dhe të Mbretërisë shqiptare apo të luftës dytë botërore. Një debat të hapur lenë autorët për etimologjinë e emrit të fshatit Gjoricë duke cituar dokumente dhe kujtime banorësh pa dhënë një përcaktim të prerë. Libri është i hapur gjithashtu për të gjithë studiuesit se ku kanë shkuar fiset e viteve 1467, 1583 apo 1653 të cilët nuk ekzistojnë në shekullin e 20-të. Fiset aktuale sipas autorëve kanë filluar popullimin e këtij fshati pas shekullit të 17-të të ardhur nga fshatra shqiptare me më pak mundësi jetese, pa infrastrukturë dhe me mungesë uji apo toke, pasuri të cilat Gjorica t`i ofron me shumicë. Me durim dhe kompetencë profesionale autorët citojnë të gjitha fiset e këtij fshati duke evidentuar të ardhurit e parë dhe më pas fiset e mëvonshme.

Pozita gjeografike si kryqëzim rrugësh dhe luginash e ka vendosur Gjoricën, shpesh si fushë beteje, kulmi i të cilës është ajo me taborret e Hajredin Pashës, në vitin 1844, e përjetësuar edhe në këngë popullore.

Autorët na sjellin edhe dy fakte interesante. Librin " Shqypnia, njoftime gjeografike, shtetistike –administrore" të autorit Lorenzo Viezzoli S. J. botim i vitit 1923 si dhe vendimin nr 753 të Këshillit të Ministrave të Mbretërisë Shqiptare datë 6 korrik 1938 për ndryshimin dhe shqipërimin e emrave të fshatrave pasi shumica ishin dhe janë akoma emërtime sllave.



Pas Gjoricës autorët ndalen në Çerenec. Zëri i historisë na paraqitet nëpërmjet të moshuarit Xhemail Mjeshtri dhe mësuesit Bashkim Lila. Etimologjinë shkencore të emrit Çerenec, autorët ja delegojnë etimologëve. Më tej autorët ndalen në pozitën gjeografike, klimën, popullsinë, fiset dhe toponimet e disa vendeve në fshat. Për Çerenecin historia fillon me kryeplakun e parë nga fisi Xhepa në vitin 1850. Me kujdes përmenden të gjitha fiset dhe emrat që në vite kanë lënë gjurmë ne historinë e këtij fshati, të arsimuarit në vite dhe pozita e tyre në shoqëri. Pjesë e historisë së fshatit janë konsideruar edhe labidari i Tercilio Kardinalit, komandanti I batalionit Italian " Antonio Gramshi", tërmeti i vitit 1967 dhe reparti ushtarak i vendosur në Qafë të Çerenecit në të cilin kryenin stërvitjen ushtarake banorët e gjithë fshatrave të kësaj zone dhe kanë shërbyer ushtarakë nga e gjithë Shqipëria.

Udhëtimin e tyre autorët e vazhdojnë në Viçisht. I përbërë nga katër lagje dhe buzë Drinit të zi, theksohet fakti I lidhjeve të shumta të këtij fshati me Dibrën e Madhe me të cilën ka patur jo vetëm lidhje tregtare nëpërmjet Urës së Spiles por edhe lidhje miqësore dhe martesa. Pozita gjeografike si fshat kufitar ka lënë të njëjtat pasoja nga luftrat në vite që në fillim të shekullit 20 me dënime, arrestime dhe pushkatime masive nga serbët, bullgarët, italianët e deri tek dënimet dhe internimet e sistemit komunist. Ashtu si për Gjoricën dhe Çerenecin edhe për këtë fshat citohen të gjitha lagjet dhe fiset me emra konkret, duke u ndalur ne mënyrë të veçantë në zhvillimin e arsimit dhe figurat më të dëgjuara të këtij fshati.

Me të njejtën metodikë trajtohet edhe fshati Lubalesh si pjesë e komunës Gjoricë duke evidentuar një fakt që veshja e ketij fshati ka më shumë ngjashmëri me veshjen e Zerqanit pavarësisht se është pjesë e Grykës së Vogël apo në kufi me krahinën e Gollobordës si dhe evidentohet fakti që në raport me numrin e popullsisë, ky fshat ka numrin më të madh të vajzave dhe djemve të arsimuar me arsim të lartë. Ashtu si për fshatin Gjoricë edhe për fshatrat Çerenec, Viçisht dhe Lubalesh jepen të dhëna për popullsinë e hershme nga defteret e perandorisë turke që nga viti 1467.

Në gjithë materialin e paraqitur autorët përdorin 93 referenca, libra e dorëshkrime, numër i konsiderueshëm ky, për historiografinë e një komune apo një fshati.

Kuvendet e Gjoricës, Beteja e Drinit apo beteja me Hajredin Pashën, Lufta Nacional-Çlirimtare dhe masakrat serbe në Gjoricë janë pjesë përbërëse e librit dhe një muze i gjallë i historisë sonë.

Me guxim, kurajo dhe të paanshëm autorët na përshkruajnë edhe periudhën e regjimit komunist duke cituar ngjarje, institucione, drejtues dhe emra konkretë, pa fshehur zhvillimin por edhe qëndrimin ekstrem dhe dënimet në emër të luftës së klasave dhe unitetit të popullit.

Itifaku i Gjoricës zë një vend të posaçëm si për të treguar rregullin e fortë që mbizotëronte për të rritur sigurinë dhe detyrimin për të ndihmuar njëri-tjetrin në raste fatkeqësie.

Një vënd të veçantë, një nga autorët, dr. Qemal Osmani, i kushton familjes së tij, prindërve dhe të afërmëve. Sigurisht rrëfimi dhe ballafaqimi publik, pa komplekse, është filozofi demokratike që rrit vlerat jo vetëm të autorit por dhe të vendlindjes së tij.

Shëndetsia, Arsimi, kultura, sporti, intelektualët, ata që kontribuan në këto sektorë aq të rëndësishëm kanë një hapësirë të konsiderueshme në libër.

Studimi nuk mund të konsiderohej i plotë pa trajtuar edhe element të tjerë të jetës sonë si etnokultura, dasma, martesa, vajet, festat pagane si Dita e verës dhe Shëngjergji.

Periudha e demokracisë, pushteti vendor dhe drejtuesit e saj që nga Mehmet Leci, Mendu Xheka, Xhelal Mera e deri tek kryetari aktual, z. Vehbi Xheka janë pjesë e këtij botimi enciklopedi për Gjoricën pa dallim bindjesh politike.

Autorët kërkojnë ndjesë në libër disa herë për ndonjë harresë të rastësishme, për ndonjë emër apo ngjarje, për ndonjë institucion apo traditë.

"Ne sot nuk pretendojmë se përfunduam historinë e Gjoricës, - thotë autori Shaqir Skarra- Jemi të bindur se të tjerë përsëri do të shkruajnë, do ta thonë fjalën e tyre me përgjegjësi dhe profesionalizëm. Tashmë themelet janë hapur. Çdo gjë është më e lehtë, çdo gjë bëhet dhe më e bukur. Libri do të mbetet pasaporta e Gjoricës"

Faleminderit të dy autorëve për të këtë pasuri të madhe dokumentare, për këtë enciklopedi të historiografisë sonë të përbashkët e cila do të mbetet trashëgim brez pas brezi duke na nxitur për më shumë botime dhe të vërteta historike.



Pranverë botimesh në M&B



FAN NOLI KRYEMINISTËR
Botimet M&B / 256 faqe
ISBN: 978-9928-172-46-4
Çmimi: 700 lekë



HISTORIA E DIBRËS
Kristo FRASHËRI
Botimet M&B / ISBN: 978-9956-04-82-0
Çmimi: 1500 lekë/ 624 faqe



BIBOLLASIT
Ramiz GJINI
Botimet M&B / ISBN: 978-9956-04-55-4
Çmimi: 1000 lekë / 412 faqe



Sonetet e Shekspirit janë kryevepra botërore. Në to, ku më shumë e ku më pak, janë sintetizuar me mjeshtëri të jashtëzakonshme të gjitha dridhjet dhe ngashërimet që të shkaktojnë tragjeditë dhe komeditë e përbotshme të tij.
Sonetet e Shekspirit janë poezi të vërteta lirike. Herë-herë, në to ndihet një jehonë e largët epike e poezisë së lashtë si dhe e asaj mesjetare. Në sonetin 106, poeti thotë se bukurinë e asaj që dashuron e kanë parakënduar poetët e Antikitetit, që thurnin ditirambe për zonja të bukura dhe kalorës të hyrishëm. Për të kuptuar se sonetet nuk këndojnë vetëm dashurinë për mikun dhe zonjën zeshkane, lexoni, ju lutem, sonetin 31, te cilin mund ta gjeni ne librin e pare.
Lum si ata, që do t'i lexojnë këto sonete magjepsëse të lavdisë më të madhe letrare në botë, në të dyja gjuhët, si në gjuhën origjinale të autorit, ashtu dhe në shqipen tonë, e cila, gjithashtu, tingëllon po aq bukur dhe madhërishëm sikundër anglishtja shekspiriane.



ALEGORIA E DIBRËS
Nga Mevlud BUCI
Botimet M&B / ISBN: 978-9928-172-34-1
Çmimi: 1200 lekë / 288 faqe



NGA HIRI I TË VDEKURVE
Agron TUFA
Botimet M&B / ISBN: 978-9928-172-39-6
Çmimi: 700 lekë / 164 faqe



ÇIDHNAKË NË SHEKUJ
Zyber GJONI
Botimet M&B / ISBN: 978-9928-172-28-0
Çmimi: 1000 lekë / 200 faqe

Na gjeni në
Pallati i Kongreseve, 6-10 maj 2015

PANAIRIN E PRANVERËS

cyan magenta yellow black

Dibra me veçoritë unike të jetesës: arkitektura urbane dhe periferike, rrugëve e sokaqeve, stili i veçantë i banesave, artizanati, estetika, stolitë, orenditë e salltanetit, pastërtia, kultura familjare, ndërgjegjja fetare skalitën bukur personalitetin e Said Najdenit.

Said Najdeni, mësuesi i mësuesve të Dibrës

Nga **MIRAN TAFA**

JETA E SAID NAJDENIT, NJOHJA ME RILINDËSIT SHQIPTARË

Said Najdeni lindi në Dibër të Madhe në vitin 1864 në një familje që u sakrifikua për shkollimin e tij. I ati, Islami, dhe e ëma, Esma, rridhnin nga një familje zejtare. Arsimin fillor dhe atë plotor Saidi e kreu me sukses në vendlindje në vitin 1882.

Duhet të kemi parasysh që koncepti gjeografik për Dibrën e sotme nuk përputhet me atë të Didrës se kohës kur jetoi Saidi, pasi me vendim te Konferencës së Ambasadorëve në Londrës të vitit 1913, Dibra e Epërme (Dibra e Madhe) mbeti jashtë kufirit.

Dibra me veçoritë unike të jetesës: arkitektura urbane dhe periferike, rrugëve e sokaqeve, stili i veçantë i banesave, artizanati, estetika, stolitë, orenditë e salltanetit, pastërtia, kultura familjare, ndërgjegjja fetare skalitën bukur personalitetin e Said Najdenit. Një kontribut të jashtëzakonshëm në shkollimin e tij dha i ati, i cili në vjeshtën e vitit 1882 i dha mundësinë Saidit të shtegtojë në rrugën e dijes drejt Edrenesë, ku studioi për dy vjet. Prej aty u largua për në Stamboll në medresenë e lartë "Hajdar Pasha" të cilën e shikoi si çerdhen e shqiptarëve, dijes dhe lidhjes me figura të tjera shqiptare, e quajtur ndryshe "klubi i shqiptarëve" (Said Najdeni, monografi, Tiranë 1980). Këtu Saidi spikati si një patriot e atdhetar, aq sa edhe Naimi shpesh i bënte vizita, e muhabeti u shkonte mjaft. Të përqendruar në Stamboll aso kohë ishin Hasan Tahsini, Jani Vreto, Ismail Qemali, Pashko Vasa etj të cilët brumosën me ndjenjën e atdhetarisë Saidin. Dua të kujtoj se shtëpitë e këtyre patriotëve ishin shndërruar në mexhelise ku bisedohej vazhdimisht për fatet Shqipërisë, e Saidi diti t'i ndiqte ata e të mësonte prej tyre.

Në medresenë e Stambollit "Hajdar Pasha", Saidi i dha ndërgjegjes shpirt duke mësuar bazat e islamit (sheriatit) dhe drejtësisë. Të dyja së bashku, feja dhe filozofia e së drejtës të përziera me atdhedashurinë dhe patriotizmin ndërtuan njeriun e së vërtetës, e vërtetë e cila iu ishte mohuar qysh së moti shqiptarëve. Ai u diplomua me titullin "Hoxhë" e "Voka " si shkak i njeriut human.

VEPRIMTARIA SI MËSUES

Tashmë më vetëdije atdhetare dhe i brumëzuar me kulturën iluministe, i mjaftonte për të nisur punën për udhën e gjatë e të mundimshme për hapjen e një shkolle shqipe në Dibër. Hoxhë Voka në vitin 1888 kthehet për të hapur shkollën e parë shqipe në Dibër, një vit pas asaj të Korçës. Si ambiente për zhvillimin e mësimit u përdor një dyqan, shtëpi, ose ndonjë sokak i fshehtë. Nxënësit e parë të Saidit ishin Selim, Dalip, Imer dhe Riza Rusi, Shaban Pepa, Daut e Hajredin Varvarica, Vehbi Hatipi, Sherif Palikuqa, Mahmud Mullai, Tahir Trena, Sefedin, Qazim dhe Hysni Najdeni, Razie Pregja (Hysa, Mahmud, Said Najdeni-Hoxhë Voka, ITKSHSH, Shkup, 2013), të cilët më vonë u bënë luftëtarë të çështjes kombëtare, përhapës të librit shqiptar, mësues të shkollave shqipe, ithtarë të alfabetit shqip.

Ambientet ku mësonin nxënësit ishin tepër të vështira, mungonte drita, ajrosja e mjetet mësimore(Hysa, Mahmud, Said Najdeni-Hoxhë Voka, ITKSHSH, Shkup, 2013). Megjithatë, fëmijet me dashuri të madhe e mësuan gjuhën shqipe, e mësuan prej MËSUESIT. Në këtë shkollë te cilën e udhëhiqte Said Najdeni përveç elementëve të para të shkrimit dhe leximit ma alfabetin e Stambolli, mësohej diçka edhe nga matematika, nga shkencat natyrore, mësime fetare, bisedohej për tema nga historia e kultura kombëtare, bisedohej për veprimtarinë e Stambollit, për ngjarjet me aktuale etj. Asaj kohe shtypi për Dibrën shkruante: "Si në vende të tjera, edhe këtu ne Dibër zuri me hy dashuria e mëmëdheut bashkë me të gjuhës! Sot në Dibër kemi shumë zotëri pleq të ndershëm që përpiqen për pavarësinë e gjuhës shqipe...i madh e i vogël thërrasin: me gjuhë ruhet mëmëdheu, me shkollë mirësohet



kombi!"

Dëshira e madhe për të mësuar shkrim e këndim të gjuhës shqipe e përhapën lajmin anekënd, saqë jo vetëm shqiptarët e etur për dituri vajtën në dyert e asaj shkolle, por edhe armiqtë shpejtuan të ndalnin "helmimin" e rinisë dibrane prej gjuhës se Saidit.

Propaganda osmane për ta larguar nga ndikimi mbi rininë (të ardhmen) shqiptare e bëri të vetën. Ai u detyrua ta linte detyrën e shenjtë të mësuesit, për t'i shpëtuar burgut dhe i shpëtoi falë mbrojtjes që i dhanë nga Stambolli atdhetarët shqiptarë në rangjet e larta qeverisëse.

Ashtu siç thotë Sokrati: "Të mësosh nuk do të thotë të mbushësh një enë, por të ndezësh një flakë", edhe Saidi ia arriti që dëshirën e rinisë për dituri ta kthente në një zjarr që sa më shumë dituri t'i hedhësh, aq më shumë flakë do të marrë. E nuk kishte si të ndodhte ndryshe, nxënësit e Hoxhë Vokës ishin përhapur si valët e detit në fshatrat e Dibrës: Bllacë më Sheh Sulën, Maqëllarë, Zerqan, Dohoshisht, Brezhdan (Haki Stërmilli, Dibra në prag të historisë, Tiranë 1941, fq.53). Haki Stërmilli shprehet: "Në vitin 1894, një nga shokët e Said Najdenit, Shaqir Daci, njeri me influencë në Dibër, hapi në katundin Homesh një shkollë shqipe". Josif Bageri i Rekës së Epërme bëri një punë të jashtëzakonshme, duke sjellë libra e fletore për shkollat në Dibër, nëpërmjet Kadri Fishtës e Selim Rusit.

AS SËMUNDJA, AS BURGU NUK E NDALËN NË RRUGËN QË KISHTE NISUR...

Ishin vitet kur i " Sëmuri i Bosforit" ishte "tërbuar" dhe s'dinte ç'bënte për të mbajtur akoma nën zgjedhë dibranët, të cilët tashmë i kishte rilindur Hoxhë Voka. Arsyeja e Hoxhës kishte triumfuar mbi mosarsyen e pushtuesve të cilët më mish e me shpirt mundoheshin të "zinin diellin me shoshë". Idetë e mësues-rilindësit, që tashmë kishin depërtuar në çdo kapilar të ndërgjegjes dibrane, e mbuluan errësirën e pushtuesve. Megjithatë Saidi bashkë me mikun e tij, atdhetarin e njohur, Ibrahim Mitrovica u burgosën, 11 muaj as që i morën në pyetje. Pas 15 muaj burgimi Hoxhë Voka u lirua, me kusht që të mos merrej me veprimtari të cilat binin ndesh me interesat omsane.

Mirëpo idetë e mësuesit në rrugën e tij po konsolidoheshin çdo ditë e më shumë, ai vazhdonte të takohej me personalitete si Dervish Hima, Sotir Kolea, Dedë Karbunara etj. Tashmë synonte të formësonte një lëvizje mbarëkombëtare për çlirimin e vendit.

Mesa duket mësuesi e kishte futur për hulliri çështjen e pavarësimit te vendit. Stërmundimet fizike, lodhja duke vizituar trevat shqiptare e kolonitë e kishin bërë punën e vet. Shfaqen shenjat e para të tuberkulozit. I ati bëhet merak dhe e këshillon që të kujdeset njëherë të vetme për shëndetin e tij (Monografi,"Djelmëria dibrane). Saidi i përgjigjet: "Ta dini or babë, se këto sakrifica qi keni ba ju nuk më përkasin mue, por Shqipnisë e cila ka nevojë për sakrifica ma të se këto tona, ka nevojë për sakrificat e tanë kombit. Po shkon Shqipnia, babë, po shkon nderi i shqiptarit, shqiptari rrin në gjumë e se din s'e din se çështja qëndron deri në këtë shkallë". Ishte në ditët më të mira të jëtës së tij kur sulltani i ofroi një punë me pagë të majme, por nuk pranoi. "Unë nuk vuej për grada e për pare, por për Komb e Atdhe"- i shprehej të atit. "Unë due të fitoj lirinë për me i mësue këtij kombi gjuhën shqipe. Shqipnia or babë qi ti shpëtojë nga rreziku vetëm nji rrugë i ka mbetë: me u zgjue kombi, me mësue gjuhën e tij e me i dalë zot vetes". Ishte në ditët më të vështira të jetës së tij, por mendjen e kishte tek çështja kombëtare.

Ismail Qemali e fton Hoxhë Vokën në Stamboll. Ai ishte shtylla e mbështetjes së mësuesit. E them këtë sepse ai u kujdes vazhdimisht për të ndihmuar moralisht Hoxhën, iu gjend në momentet më të vështira kur Hoxha përballej me sëmundjen, presionin psikologjik, persekutimin e burgun.

Vizitat nëpër kolonitë shqiptare e ndihmuan Hoxhën të ndante vetëdijen kombëtare nga ajo fetare. Kthehet në Dibër me moralin lart, megjithëse i dërmuar nga sëmundja.

Said Najdeni e flijoi veten duke ndërmarrë veprime konkrete në përhapjen e gjuhës shqipe, duke shpërndarë libra anekënd.

Said Najdenin e shoqëruan tre cilësi, të cilat bënë që jeta dhe vepra e tij të mbetet në kufinjtë e të virtytshmes, të bukurës e të drejtës.

E virtytshmja, e drejta, e sakta dhe e bukura u qëndisën në një, Said Najdenin - mësuesi i mësuesve të Dibrës.

Saidi u brumos me bazat e islamit dhe mbi këto baza ai veproi për çështjen kombëtare. Sipas Sheriatit (ligji islamik): Çdo musliman duhet me e dashtë dhe me luftu për atdheun, e Hoxha nuk e harroi asnjëherë këtë. "Myslimanët e vërtet duhet të dinë se feja islame urdhëron me e dashur atdheun", dhe "Për mëmëdhenë duhet me qënë shërbëtorë, njeriu sa dashuri të ketë në mëmëdhenë, aq dashuri ka në fenë".

Perandoria Osmane ishte kalbëzuar e vetëm një "grusht" i duhej për t'u shembur, e falë Said Najdenit, Dibra ia dha këtë goditje. Ai u caktua delegat i Komitetit të Stambollit në Lidhjen e Pejës (?), por nuk mundi të shkonte për shkak të ndjekjes këmba-këmbës të turqve. Gjithashtu, Saidi dha një ndihmesë të madhe në mbajtjen e Kuvendit të Dibrës së vitit 1899.

Mësuesi kishte hyrë në zemrat e shqiptarëve të Kosovës, Shkupit, Dibrës e më gjërë si njeri që e donte mëmëdheun. Por në sytë e udhëheqësve osmanë ai paraqiste një person të rrezikshëm i cili kishte manipuluar turmat me fjalimet e tij, saqë kishin frikë ta arrestonin për të mos shkaktuar indinjatën e popullit e cila mund të precipitonte në kryengritje të armatosur.

Saidi mund të konsiderohet si dirigjent për çështjen kombëtare, veçanërisht në Dibër. Ai e flijoi veten duke ndërmarrë veprime konkrete në përhapjen e gjuhës shqipe, duke shpërndarë libra anekënd. Nga viti 1900 fillon punën krijuese duke botuar për çështjen fetare: "Ferrëfenjësja e muslimanëve"(Hoxhe Voka, Ferërfenjesja e muslimanëve, Sofje, 1909, fq.44) që ishte një udhëzues për ritet fetare dhe për çështjen arsimore: "Abetarja e gjuhës shqipe".

Në vitin 1901 Dibra u përfshi nën represionin turk e mësuesi u detyrua të largohej për në Stamboll. Megjithëse ai u largua, puna e tij kishte filluar të jepte frutat e saj: më 1902 u hapën shkolla në fshatrat Çidhnë, Muhurr, Luzni, Zogaj, Homesh, Lis (Çuka e Matit).

Said Najdeni – patrioti dibran që bluajti në mendje idenë e pavarësimit të vendit qysh në vitin 1903 bashkë me Ismail Qemalin. Mësuesi i kishte mbjellë farat e tij në ndërgjegjen popullore, e dinte se dita... do të vinte, por ai s'do të mund ta priste. "Në varrin tem të mos vini gurë derisa të lirohet Shqipëria dhe kur të fitohet liria m'i veni gurët tue m'i shkrue shqip. Në këto gurë të ngulni edhe "Flamurin e Kombit", të cilin unë për fat t'keq s'un po e shof për së gjalli, po munde bare ta kem afër. Ata syt e tu, or Qazim i dashtun kanë për ta pa këtë "Flamur". Afrohu t'i puth".

NDARJA NGA JETA. ÇFARË LA PAS?

Nuk zgjati shumë dhe fara e mbjellë lulëzoi në "pranverën" e vitit 1912. Frutet e punës së tij i shijuan të gjithë, ata që luftuan dha ata që nuk e bënë këtë gjë. Në pikëpamjen e tij të gjithë njerëzit lejnë dhe vdesin, se e kanë hak, njeriu len dhe vdes, por në ai nuk vdiq, ai jetoi, jetoi në ndërgjegjen kombëtare e në zemrat dibrane.

Mësuesi e deshti shumë mëmëdheun, e mëmëdheu e mori pranë vetes atë. Vdes më 21 nëntor 1903. Ai ishte rilindës e vizionar, e dinte se do të vinte ajo ditë kur mbi varrin e tij do të valëvitej një flamur lirie, ai për të cilin luftoi e punoi, atë të cilin edhe e punoi (gjatë kohës kur ishte në burg punoi një flamur që e mbante me vete e ua tregonte miqve e shokëve). E për këtë iku i paqtë nga kjo jetë, i bindur se një ditë Shqipëria së shpejti do të pavarësohej e në shkolla do mësohej gjuha shqipe.

Said Najdenin e shoqëruan tre cilësi, të cilat bënë që jeta dhe vepra e tij të mbetet në kufinjtë e të virtytshmes, të bukurës e të drejtës.

Ai ishte hoxhë, kishte mësuar të ishte i drejtë, e dinte se "Njeriu më i dashur tek Allahu pas profetëve dhe shehidëve (dëshmorëve) është dijetari, prandaj e kërkoi dijen.

Ishte patriot sepse dijet që kishte marrë i përhapi anë e kënd, e luftoi me çdo mënyrë e mjet për të rilindur Dibrën, ia arriti.

Jetoi si rilindës sepse jetën nuk e ruajti për vete por e sakrifikoi për të ngritur në nivelin e meritуar ndërgjegjen dhe identitetin kombëtar.

E virtytshmja, e drejta, e sakta dhe e bukura u qëndisën në një, Said Najdenin - mësuesi i mësuesve të Dibrës.

OFROJMË
redaktime - korrigjime
- ftesa - fletëpalosje
- fotokopje - kartvizita
- printime - lidhje libri duke
filluar nga 1 kopje e vetme!
Çmime të favorshme dhe
shpejtësi!
Telefono: 068 65 08 441

SHTËPIA E LIBRIT FLETA XXI PESHKOPI BOOK HOUSE
LIBRI PRANË JUSH
LIBRARIA FLETA XXI,
PRANË MUZEUT,
PESHKOPI

Këshilli i Komunës së Zall Dardhës vlerëson bijtë e vet

Rasim Shira nderohet me titullin **"Qytetar Nderi"**

Më 12 prill, në mjediset e Muzeut Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë, Këshilli i Komunës Zall-Dardhë organizoi një veprimtari për të nderuar disa nga personalitetet e kësaj krahine.

Të pranishëm në këtë veprimtari ishin përfaqësues të pushtetit lokal, deputetë, artistë të njohur, bij të Zall-Dardhës dhe Dibrës.

Pas fjalës së moderatorit, Defrim Methasani, foli kryetari i këshillit të komunës, z. Gëzim Kaca, i cili e vuri theksin te tradita dhe dashuria dhe njerëz punëtorë dërnjan. Zall-Dardha është një zonë e varfër, por me njerëz bujarë, një zonë pa asnjë gjakmarrje, asnjë të ngujuar apo në hasmëri, pa arsye konflikt pronësie.

Në fjalën e tij, kryetari i komunës, z. Njazi Cani përveç përshëndetjes foli dhe për Dardhën, për urën e re të ndërtuar dhe që shkurton me 16 km distancën me qytetin e Peshkopisë, për kontributin e dhënë nga deputeti i zonës, ish gjenerali z. Xhemal Gjunkshi, si dhe reparti ushtarak nr.7020, në montimin e kësaj vepre e rëndësishme për zonën Reç e Dardhë e më gjerë.

"Kjo ceremoni dhe praktikë e njohjes së meritave do të jetë në shërbim jo vetëm të individëve si një motiv më tepër dhe shpërblim për kontributin e dhënë, por edhe të institucioneve për të parë, njohur dhe udhëhequr drejtë ngritjes së kapacitete dhe zhvillimit profesional të kuadrove", theksoi Cani.

"Këshilli i komunës, tha Njazi Cani, duke marrë parasysh kontributet e lartëpërmendura vendosi të japë Mirënjohje për ish shefin e shtabit të përgjithshëm z. Xhemal Gjunkshi, komandës së repartit ushtarak nr. 7020 dhe kapiten Arben Rira kurse për z. Rasim Shira ka vendosur ta shpallë "Qytetar Nderi".

"Rasim Shira është krenaria e Dardhës, si njeri human, valltar i ansamblit të Kuvendit të Dardhës, Mjeshtër i sportit në mundje dhe kontribut me vlerë në proceset e para demokratike, në veçanti për kon-



Vlerësohen me certifikatën e mirënjohjes Xhemal Gjunkshi dhe Arben Rira

tributin e dhënë në rastin e Kosovës ku ka marrë 75 vetë që janë trajtuar në ambientet e tij", tha mes të tjerash kryetari i Komunës.

Arben Rira, ushtaraku nga Librazhdi, pas marrjes së certifikatës së mirënjohjes, tha se "unë me shokët e mi e kishim detyrë të ndërtonim urën, këtë vepër në shërbim të komunitetit, por falë bujarisë, mikpritjes dhe ndihmës të njerëzve të kësaj zone u bë më e lehtë kryerja e kësaj detyre."

Më emocione u shoqërua edhe dhënia e titullit "Qytetar Nderi" zotit Rasim Shira. Njeriu i mirë, biznesmeni dhe humanisti, artisti dhe sportisti, krenaria e Dardhës, e Dibrës dhe më gjerë.

Pjesëmarrësit e shumtë nuk arriti të mbante salla e madhe e Muzeut Historik Kombëtar shumë vetë në këmbë, por mbetën dhe jashtë sallës. Ishin të pranishëm miq e dashamirës të tij, të ardhur dhe nga Kosova e Maqedonia, familjarë të tij dhe bashkëfshatarë të ardhur jo vetëm nga Tirana por dhe nga Zall Dardha posaçërisht.

U fol shumë për Rasim Shirën dhe e meriton por fjala e Veli Dedës nga Lura ku mes të tjerave tha: "Falë zotit e Rasim Shirës që unë jetoj sot!"

Të bukur dhe të larmishme e bëjnë me këngët e tyre artisten dërnjane Tribune u mbush me lule u mbush me valltarë, nipa e mbesa të afërm të Rasim Shirës që shoqëruan potpurinë e këngëve kënduar nga Lirie Rasha.

Për të pranishmmit, nga familjarët u dha një koktej.

ILMI DERVISHI



Fatlind Tomini hap ekspozitën e parë me fotografi

Në Dibër të Madhe, për disa ditë me radhë qëndroi e hapur ekspozita me foografi e fotografit të ri, 19 vjeçarit Fatlind Tomini.

Ekspozita, e titulluar "Vizioni im" kishte në përbërje disa fotografi, portrete dhe peisazhe nga Dibra dhe arkitektura e disa vendeve europiane.

Në këtë ekspozutë Tomini kishte paraqitur 30 fotografi, disa prej të cilave edhe të punuara me shumë kujdes në drejtim të ngjyrave dhe kontrastit. Binin në sy disa fotografi të liqenit të Dibrës, të cilat ishin fotografuar në stinë të ndryshme dhe në kënde të njëjta.

Ekspozita e të riut Fatlind Tomini tregoi se Dibra ka nevojë për veprimtari të tilla kulturore dhe se vizitorët janë të etur për të parë më shumë të rinj të talentuar që ecin përpara në fusha të ndryshme të artit.

Dua të flas me jetën

Një libër me poezi nga Bajram Hasbajrami

Nga **ILMI DERVISHI**



Plagët e kombit tim më japin shumë dhimbje në poezinë time e ndërsa për krenarinë e kombit dhe historinë e tij shkruan plot ndjenjë e frymëzim poezitë më të bukura. Në 50 poezi të ciklit të parë "Atdheu, Nderi, Liria" në temën historike lexuesi befasohet me poezitë "300 duvakët e Lurës", "Dasma e Mamicës", "Liqeni i Plavës", "Kalaja e Çidhnës", "Djemtë e Dibrës", "Fjala e shqipes" etj., janë poezi të shkruara me dashuri e krenari për historinë e popullit tonë që nga koha e Skënderbeut që në letërsinë e sotme rrallë gjen të shkruhet për tema të tilla.

Unë e dua jetën, thotë Bajram Hasbajrami, por krahas poezive për dashurinë, për jetën, të bukurën ka dhe një cikël të titulluar "Plagë jete". Në këtë cikël gjen poezi si: "Stërringjallja e Adhamullit", "Një këngë e plagosur", "Ulurima e një qeni", "Trishtimi i pulëbardhës" apo poezinë "Zhgënjimi" ku poeti shkruan:

Po pres në hollin e madh të gjithësisë
Për të më marrë ashensori i madh i jetës

Dhe nga pritja e gjatë, fenomeni i një tranzicioni të gjatë herë herë lexuesit si i lënë në mes të katër rrugëve dhe i lind pyetja: Deri kur do presim dhe poeti e mbyll me një thënie të bukur: "Duke pritur diellin nën hijen e shpresës".

Në dy ciklet e tjerë të këtij vëllimi të titulluar "Natyrë" dhe "Për dashurinë" gjen shpirtin e butë të poetit, të mrekulluar nga bukuria e natyrës dhe asaj shpirtërore që shpërthen me vargje te poezitë "Natë vere në bjeshkë", "Bregu i lumit" apo te poezia "Mos ma mbyll dritaren", "Miti i bishtalecave", "Kur çelin sytë e bukur" etj.

Në të 172 faqet e librit me poezi "Dua të flas me jetën" shkruar nga Bajram Hasbajrami, botuar nga shtëpia botuese "Toena", gjen poezi të cilat kanë jo vetëm vlera edukative e patriotike, por dhe një nivel të lartë artistik.

Përkujdesja grafike dhe kopertina nga Lavdia Cenmurati dhe korrektorja letrare Elda Kelo, kanë punuar me shije e përkushtim për të bërë sa më dinjitoz këtë botim.

Poezi nga Bajram Hasbajrami



KARVANI I REVE

Ecën, bardhë e zi, karvani i reve.
Rrëmujë ecin dh mendimet e mia.
kjo rrëmujë resh në hedh për t'u tallur
Me ne, edhe copat e diejve.

Dhe, kështu, tromakset pa mëshirë
dhe Dashuria....
Askush nuk e di cili është fati im
Dhe i reve.
Askush nuk e di ku do ta çaojnë jetën time
Njeriu dhe Perëndia.

KALAJA E ÇIDHNËS

Idhnake janë Çidhna dhe Gryka e Vogël,
Dy motra fisnike janë ato të së madhes Shkodër.
Dhe janë mendja e zemra e Dibrës në dy buzët e Drinit.
Si gjyshja Teutë, e ngritën një kala mbi gojën e burimit.

Kala e bardhë, e veshur me lule e ahishtë,
Çerdhe e gdhendur mbi shkëmbin e bukur të jetës.
I mbledh aty zogjtë e saj, kur i hedhin zjarre stuhish,
Dh enë valët e Drinit mbytet uragani i Setës.

Dhe këngët e gjakut të saj përherë te shpirti i rrinë,
Se djemtë e cucat e saj kanë çuditur dhe botën,
Se gjaku i buron dhe shpirti i këndon për jetën dhe lirinë,
Se me Drinin bashkë rritën edhe Gjergjin, edhe Jovan Nokën.

U bënë si lisa Arbërie dy lulet Sinës,
Dhe bashkë me Moisiun, Dibrën nën e kanë.
Nënë e trimërisë në shpirtin e Mamicës,
Se dashurinë e parë lirisë seç ia dhanë.

SI E DUA JETËN

Jeta, vërtet është poezi.
S'ka fund jeta, s'ka as poezia.
Të dyja i do vetëm ai ose ajo që është
Njeri...
Sa mirë do ishte të mos jenë këtu
As balada,
As alergjia.



Edhe dy ndeshje me fitore dhe Korabi bëhet gati për kategorinë e parë. Kundër Partizanit të dielen, 3 maj dhe të mërkurën më 6 maj në Vorë, dhe Korabi e siguron matematikisht një kategori më lartë!
Kjo foto është nga deshja Teuta - Korabi, ku djemtë e ekipit shkëlqyen me dy gola në minutën e 52 dhe 93
#forcaKorabi

Pajtohu në gazetë - 1 vit vetëm 600 lekë



Pajtohu në gazetën RRUGA E ARBËRIT

Merr versionin PDF ose kopjen print duke filluar me 50 lekë/muaj
Pajtimet mund ti bëni pranë redaksisë duke komunikuar në numrat e mëposhtëm,
me transfertë bankare pranë Raiffeisen Bank - Tiranë,
ose me **PayPal** përmes emailit **<rrugaearberit@gmail.com>**
Një pajtim vjetor kushton: **Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD**.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Gazeta ofron faqet e saj për REKLAMA apo NJOFTIME të ndryshme për biznese dhe individë.
ÇMIME TË ARSYESHME për faqet me ngjyra dhe bardh e zi.

Për informacion:
E-mail: rrugaearberit@gmail.com
Tel: +355 69 20 68 603

Botimet M&B

Ju ftojnë të na vizitoni në Panairin e Librit që do të zhvillohet në Pallatin e Kongreseve nga data 6-11 maj 2015!
Libra të mirë, çmime të ulura

FTESË PËR BASHKËPUNIM

Gazeta "Rruga e Arbërit" në bashkëpunim me Botimet M&B ka në projekte për disa veprimtari dhe botime në fushën e kulturës, me vlera historike, kulturore dhe kombëtare për Dibrën dhe gjithë Shqipërinë.
Ftojmë individë, shoqata apo institucione vendore të bëhen bashkërealizuese të këtyre projekteve.
Për më shumë informacion mund të shkruani në email
mbbotime@gmail.com, rrugaearberit@gmail.com
ose mund të telefononi në numrin **069 20 68 603.**
Faleminderit!

Librat e botuar nga Botimet M&B mund ti gjeni në Tiranë pranë librarisë së Shtëpisë Botuese M&B, në rrjetin e librarive "Adrion", si dhe në disa librari kryesore në Tiranë.
Në Peshkopi: Libraria "Fleta XXI", pranë Muzeut.
Në Durrës: Libraria "Dyrrah". Tel. 0694053353
Për porosi: tel. (04) 22 33 283 / 069 20 68 603 068 65 08 441 / 067 30 73 265
E-mail: <mbbotime@gmail.com>